

Reviste
edukative-arsimore

ETIKA

Tremujore

Kur'ani dhe agjërimi

Ramazani nga goja e Profetit (a.s.)

Agjërimi dhe devotshmëria

Itikafi në muajin e Ramazanit

Mirësitë e Kurbanit

Rregullat etike

Thirrje lirisë



*Netët e
Dërshpirtshmërisë*

Boton

Progresi Sh.p.k:

Shkodër / Shqipëri

Përkthyes:

Adem Pizga

Aisa Kokiçi

Alban Kali

Albert Halili

Ali Bardhi

Artur Tagani

Ermal Nurja

Evans Drishti

Luan Ahmetaj

Naim Drijaj

Qani Nesimi

Zymer Ramadani

Redaktorë: gjuhësor-letrar:

Islam Dizdari

Dizenjo - Grafik:

Bledar Xama

Ngjyra: Progresi

Tel: +355 69 20 76 768

Adresa:

L: Vasil Shanto Rr: Çajupi

Shkodër

Tel: +355 69 20 76 768

Shtyp: ArbëriaDesign, Tetovë

Tel: +389 44 35 33 71

Fax: +389 44 35 33 72

Për artikuj:

e-mail: etika@revistaetika.com

editor@revistaetika.com

reklam@revistaetika.com

Çmimi: 1 Euro / 150 Lek / 60 DEN



Editorial

Të dashur lexues!

Këtë numër të revistës ia kemi dedikuar ditëve të agjërimit të Ramazanit, ditë kur në zemrat e besimtarëve reshon vesa e begatisë hyjnore.

Agjërimi është lufta me pengesat e egos pasi jemi veshur me petkun e koshiençës së një adhurimi të vazhdueshëm dhe në këtë mënyrë të minimalizojmë ndikimin e egos duke i vënë fre asaj.

Agjërimi e perfeksionon shkallën tonë të etikës dhe moralit duke na mësuar edukatën e atyre gjendjeve aq të domosdoshme për luftën e jetës, siç janë "durimi, vullneti, largimi prej dëshirave epshore". Po kështu ky adhurim është një barrierë për të mbrojtur nderin e njeriut përballë dëshirave që s'dinë të sosin të egos.

Është uria që përjetojmë gjatë agjërimit ajo e cila, edhe në mjekësinë bashkëkohore, konsiderohet ndër kushtet që këshillohen për të qenë të shëndetshëm, por me një emër tjetër, dieta. Është uria që përjetojmë gjatë agjërimit mos-pasja më e vështirë për t'u duruar.

Megjithëkëtë agjërimi duhet të ekzekutohet me ndjesinë e pastër të adhurimit, pasi që ai është një detyrim fetar. Në qoftë se anët pozitive të tij shndërrohen në qëllim, atëherë agjërimi nuk konsiderohet më si një adhurim fetar. Pra nuk duhet të nisemi me synimin të parandalojmë shëndoshjen nga ushqimi apo të dobësohemi, sepse atëherë as që mund të mendohet për ndonjë përfitim nga kënaqësia hyjnore. Të ngjashëm janë me këtë situatë edhe namazet që falen duke pasur si synim anët e mira të namazit për të vënë në lëvizje trupin apo namazet e falura me një zemër indiferente.

Ata që e cungojnë shpirtërisht agjërimit të tyre duke thënë gënjeshtër dhe marrë të tjerët nëpër gojë nuk e fitojnë pjesë të vlerave të larta që përbëjnë pjesën e dëshiruar nga mbajtja e agjërimit.

Kjo është arsyeja që me një rast peygamberi Muhamed (a.s.) u shpreh me këto fjalë rreth personave që namazet dhe agjërimet e tyre i përziejnë me qëllime të kësaj bote dhe i lerosin me dyfytirësi, prepotencë dhe diferencë shpirtërore:

Sa ka nga ata që agjërojnë që në fund të agjërimit nuk përfitojnë gjë nga agjërimet e tyre përveçse mbeten të uritur. Sa ka nga ata që netët i kalojnë me namaze (teravi dhe tehexhud), por nga namazet e tyre nuk përfitojnë asgjë përveçse mbesin pa vënë gjumë në sy.

Lexim të këndshëm!

Në këtë numër do të lexoni:

Kur'ani dhe agjërimi Elmallë Hamdi Jazër	3
Respekt për agjërimin dhe agjëruesin Prof. Dr. Mustafa Çagrëxhë	5
Ramazani nga goja e Profetit (s.a.v.s.) Prof. Dr. I. L. Çakan	6
Agjërimi dhe devotshmëria Prof. Dr. H. K. Jëllmaz	8
Disa vendime të fikhut në lidhje me agjërimin Prof. Dr. Abdulaziz Bajëndër	10
Komenti metafizik i festës së Bajramit Prof. Dr. Ethem Xhebexhiogllu	13
Jeta e zotëriut tonë në muajin e Ramazanit Prof. Dr. Jashar Kandemir	16
Muaji i bekuar i Ramazanit dhe agjërimi Osman Nuri Topbash	20
Itikafi në muajin e Ramazanit Ermal Nurja	26
Shi Nurullah Genç	28
Njohja dyanëshe e islamit dhe e krishtërit Prof. Dr. Reshid Hafizoviq	32
Mirësitë e Kurbanit Xhafer Durmush	37
Disa këshilla për ruajtjen e përmirësimin e kujtesës Dhurata Kazazi	39
Rregullat etike Enes Ufuk	42
Mashtrimi është vetmashtrim Zymer Ramadani	44
Thirrje e lirisë Idris Arpat	47
Koncepti islam për zgjidhjen e krizës ekologjike Nexhat S. Ibrahim	50
Pashai i fundit i Budapestit: Arnavut Abdurrahman Abdi Pasha Ali Bardhi	56
Shëndeti & Familja Hava Hoti	57
Arkitektura Islame: Samerra Naim Drijaj	59
Aktualitet Artur Tagani	61
Teknologji Ali Bardhi	63




8

Agjërimi
dhe
devotshmëria



16

Jeta e zotëriut
tonë në muajin e
Ramazanit




20

Muaji i bekuar i
Ramazanit dhe
agjërimi



47

Thirrje
e
lirisë



53

Samerra



KURANI DHE AGJERIMI

“Agjërimi është për mua. Dhe shpërblimin për të e jap vetëm Unë.” (Hadith kudsi)

“Muaji i Ramazanit në të cilin u zbrit Kur’ani udhëzim për njerëzimin, provë e qartë për udhëheqje dhe kriteri (dallues i qartë për të drejtën dhe të gabuarën). Kështu pra kushdo prej jush që dallon hënën të agjërojë.” (Sureja Bekare :185) Ka dy mendime

për kuptimin e fjalës **ramazan**.

Sipas mendimit të transmetuar nga Muxhahidi, Ramazan është një nga emrat e Allahut. Kur thuhet “muaji i Ramazanit” kuptohet “muaji i Allahut”. Kjo përshkruhet edhe në një hadith profetik:

“Mos thoni erdhi apo iku Ramazani por thoni erdhi ose iku muaji i Ramazanit. Sepse Ramazan është një nga emrat e Allahut.” Bejhaki e ka konsideruar të dobët këtë hadith.

Sipas mendimit të dytë, ramazan është emërtim muaji siç emërtohen dhe muajt e tjerë si Rexhep apo Shaban.

Duke marrë parasysh mendimin e parë sipas Imam Muhamedit quajta thjesht ramazan është fjalë e papëlqyeshme, por nuk përbën ndonjë problem edhe n.q.s. e përdorim vetëm ramazan.

Kuptimet e këtij emri:

1. Sipas Imam Halilit ramazan vjen në kuptimin e shiut i cili pastron tokën nga pluhurat dhe bie në fund të verës, fillim të vjeshtës. Ashtu si shiu pastron tokën nga pluhurat,

ashtu dhe në muajin e ramazanit pastrohen gjynahet dhe lahen zemrat e besimtarëve.

2. Sipas mendimit të shumicës, fjala ramazan rrjedh nga fjala “ramaz”. Ramaz do të thotë nxehtë e gurëve nën nxehtësinë e lartë të diellit. Sipas këtij kuptimi fjala ramazan do të thotë të digjesh duke ecur këmbëzbathur mbi vende të nxehta. Kjo për arsye se në këtë muaj ndihet nxehtësia e urisë dhe etjes dhe me nxehtësinë e agjërimit digjen gjynahet.

3. Të mprehësh majën e shpatës apo të shigjetës duke e futur mes dy gurëve.

4. Ramazan është një nga emrat e Zotit, ai është muaji i agjërimit është një muaj hyjnor.

Shkurtimisht fjala ramazan vjen në kuptimet pastërti, djegie, mprehje dhe qëllimi i tyre është djegie e gjynaheve dhe arritja tek Zoti.

Në një hadith profetik thuhet:

“Fillimi i tij është mëshirë, mesi falje dhe pendim ndërsa fundi është shpëtim nga zjarri i xhehenemit.” Në këtë

Fjala ramazan vjen

në kuptimet pastërti,

djegie, mprehje dhe

qëllimi i tyre është

djegia e gjynaheve

dhe arritja tek Zoti

fjala ramazan vjen

në kuptimet pastërti,

djegie, mprehje dhe

qëllimi i tyre është

djegia e gjynaheve dhe

arritja tek Zoti

hadith flitet për muajin e ramazanit dhe për rëndësinë e natës kur filloi të zbriste Kur'ani. Edhe në ajetin e mësipërm e pamë që muaji i ramazanit konsiderohet muaji i zbritjes së Kur'anit. Pra muaji i ramazanit... muaji kur filloi të zbriste Kur'ani....

Kur'ani është fjala e Allahut zbritur tek ne me anë të peygamberit tonë fisnik Muhammed Mustafasë(s.a.s).

Pavarësisht se Kur'ani iu zbrit profetit për njëzet e tre vjet, në këtë ajet Kur'anor shohim tre kuptimet e vërteta mbi rëndësinë e zbritjes në muajin e ramazanit:

1. Kur'ani është zbritur për njëherësh natën e Kadrit në muajin e Ramazanit në qiellin e botës (Bejti Mamura) dhe më vonë është zbritur pjesë pjesë tek ne gjatë njëzet e tre vjetëve.

2. Kur'an do të thotë të zbritet këtë muaj. Ajeti i parë i sures Ikra "Lexo me emrin e Zotit tënd" i ka zbritur profetit në shpellën Hira në natën e Kadrit të muajit ramazan.

Shpella Hira ishte bërë fillimi i zbulimeve hyjnore në natën e Kadrit në nxehtësinë e ramazanit. Dhe që atëherë kishte filluar dhe shpallja e shoqëruar me mrekulli e urtësi për peygamberin tonë Muhamed Mustafanë.

Shpallja hyjnore do përmbante ajete si: "O ju që besuat! Kërkoni ndihmë nga Allahu me durim dhe namaz. Pa dyshim Allahu është me

durimtarët."

Ky ishte një lajm i mirë për shpirtat që digjen për të gjetur qetësinë e vërtetë, një freskim për netët e mbuluara me vuajtje dhe me lot.

Ditët e lumtura, ditët me mirësi vijnë gjithmonë pas atyre netëve të kaluara duke qarë dhe përpjekur për më të mirën. Duke parë sesi qajnë ato që qeshin shumë, mund të them se ato që derdhin lot në rrugën e Allahut e meritojnë të qeshin.

Eshtë sakrifica që të bën të kuptosh kënaqësinë e jetës dhe rëndësinë e vullnetit njerëzor. Prandaj dhe Allahu ka bërë farz njëherësh namazin, zekatin dhe më pas agjërimin

3. Të thuash se "Kur'ani ka zbritur këtë muaj" do të thotë ta nderosh atë muaj me zbritjen e tij. Dhe me të vërtetë nuk ka muaj më të lartësuar nga Allahu (xh.sh) sesa muaji i Ramazanit.

Për këtë arsye u bë farz agjërimi i këtij muaji. "secili prej jush që e arrin këtë muaj le të agjërojë..."

Agjërimi është një nga shtyllat e fesë dhe një nga ligjet

më të forta të sheriatit. Nefsi emmare, nefsi që të çon tek e keqja edukohet mirë gjatë ramazanit. Qetësohen ndjenjat e këqija në zemrat e njerëzve.

Eshtë sakrifica që të bën të kuptosh kënaqësinë e jetës dhe rëndësinë e vullnetit njerëzor. Por njeriut i duket si nga urdhërat me të rrepta të Allahut. Prandaj dhe Allahu ka bërë farz njëherësh namazin, zekatin dhe më pas agjërimin. Për mësimin e shtyllave kryesore në fenë islame shkohet nga e lehta tek e vështira.

Këtë e shohim edhe në një hadith: "Islam do të thotë: të dëshmosh se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, të falesh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh dhe të vizitosh Qaben."

Vlera e vërtetë e të bërit farz e agjërimin qëndron në dorëzimin ndaj urdhërave hyjnore, në provën e vetvetes, në pastrimin e shpirtit nga papastërtitë, në forcimin e besimit dhe në luftën me nefsin tënd për të arritur kënaqësinë e Allahut.

Në një hadith kudsi Allahu shprehet kështu: "Agjërimi është për mua. Shpërblimin e tij e jap vetëm Unë.

Shkurtimisht themi se ramazani është muaji i Kur'anit dhe agjërimit. Ky muaj është një mundësi për t'u larë nga gjynahet dhe për të ndriçuar jetën tonë me dritën e Kur'anit.

Respekt për agjërimin dhe agjëruesin



Ne myslimanët besojmë se feja islame përmbledh rregullat e etikës më të lartë. Kjo gjë është e vërtetuar në gjithë historinë tonë. Burimi i kësaj rrjedh nga mësimet fetare dhe nga dashuria që kemi për njerëzit. Dëshirojmë që të gjithë ata që thonë “unë jam mysliman” të mundohen që t’i kryejnë dhe t’i zbatojnë urdhërat dhe detyrimet e Allahut xh.sh. Çdo njëri prej nesh mund t’i lërë pas dore detyrimet që ka ndaj Allahut xh.sh. Pra çdo njeri ka mangësi, por qëllimi ynë duhet të jetë dashamirësia dhe respekti ndaj njeri tjetrit.

Nëse një njeri nuk i kryen ritet fetare edhe nëse nuk është mysliman, ai person duhet të ketë respekt për adhurimin

dhe për adhuruesin. Respekti ndaj ibadetit për një mysliman është ibadet. Edhe nëse ne nuk i zbatojmë urdhërat me të cilët na ka ngarkuar Allahu xh.sh, ndaj atyre që i kyejnë këta urdhëra e kemi për detyrë të jemi të sjellshëm dhe të respektueshëm.

Sipas besimit tonë nëse një mysliman nuk agjëron as nuk bën ibadet ai njeri është vetëm gjynahqar. Ndërsa nëse një njeri ibadetin e atij tjetrit e nënvleftëson ose e sheh si të panevojshëm, atëherë kjo gjë nuk është vetëm gjynah, por ky veprim njeriun mund ta çojë deri në kufër (mohim).

Ramazani është një muaj i shenjtë dhe i bekuar, rëndësinë dhe vlerën këtij

muajit ia ka dhënë agjërimi. Pejgamberi a.s. në një hadith thotë: “Agjëroni që të jeni të shëndetshëm”. Duhet të kemi kujdes që afër agjëruesit mos të hamë dhe mos të pimë asgjë. Pra në një atmosferë të tillë si Ramazani, njeriu duhet të mendohet thellë për ato gjëra të cilat vepron. Asnjë njeri nuk është i përsosur. Qëllimi për të cilin na ka krijuar Allahu xh.sh. nuk është dënimi, por sprovimin që në fund tregon se cili prej nesh bën vepra më të mira. (Mulk,2) Prandaj duhet t’i shtojmë punët e mira, t’i paksojmë gabimet, të ndiejmë përgjegjësi për ato gjëra që veprojmë.

Përhapja e mos respektit ndaj agjëritit dhe agjëruesve në psikologjin e besimtarëve ka një ndikim negativ. Si mos të kemi respekt për ibadetin që kryejnë besimtarët kur stërgjyshërit, të parët tanë kanë pasur respekt dhe kanë qenë të kujdesshëm që pa ndonjë vështirësi fetë e tjera t’i kryejnë ritet e tyre fetare. Po ne pra që jemi gjeneza e tyre? E lus Allahun xh.sh. që ato të mira që bëjmë në këtë muaj, të vazhdojmë t’i bëjmë edhe pas këtij muaji.

RAMAZANI, NGA GOJA E PROFETIT (A.S.)

Pejgamberi (a.s) në hadithe të ndryshme ka folur për muajin e madhërueshëm të Ramazanit. Në lidhje me këtë gjinden transmetime të shumta në librat e hadithit. Është e pamundur që të përmbledhen të gjithë këto hadithe në një shkrim të vetëm. Prandaj ne zgjodhëm një hytbe të Profetit (a.s) në të cilën e përshkruan në detaje këtë muaj.

Dijetari i shquar, imami Shejh es-Saduk, ka shkruar në veprën e tij el-Amali, ff. 84-85 se: Muhammed ibn Ibrahim transmeton nga Ahmed ibn Muhammed el-Hamadani se 'Ali ibn el-Hasan ibn Fadali ka cituar babain e tij që përçjell nga i ati, Imam 'Ali ibn Musa el-Rida (r.a), i cili nga ana e vet citon të atin, Imam Musa ibn Xha'ferin (r.a), që transmeton nga Prijësi i Shehidëve, Imam Husein ibn 'Ali ibn Ebi Talibi, i cili ka treguar se i Dërguari i Allahut (s.a.v) mbajti një herë një hytbe në xhumanë e fundit të muajit Shaban, në të cilën tha:

"O njerëz! Po ju vjen një muaj plot begati, mëshirë dhe falje; një muaj të cilin Allahu e konsideron më të mirin e të gjithë muajve. Ditët e tij janë ditët më të mira; netët e tij janë netët më të mira; orët e tij janë orët më të mira. Ai është një muaj ku ftohe-

ni të jeni mysafirët e Allahut dhe konsideroheni të denjë për mirësinë e Tij. Frymëmarrja juaj në të e madhëron Allahun dhe gjumi juaj e adhuron Atë. Ibadetet tuaja vullnetare pranohen dhe lutjet tuaja dëgjohen. Kërkojini pra Allahut, Zotit tuaj, me nijet të sinqertë dhe zemër të pastër, që t'ju mundësojë në agjërimin dhe leximin e Librit të Tij, sepse vetëm një mjeran privohet nga mëshira e Allahut në këtë muaj të madh. Dhe le t'ju kujtojë uria dhe etja juaj gjatë tij, urinë dhe etjen e Ditës së Gjykimit. Jepuni lëmoshë të skamuroe dhe të pastrehëve mes jush; rrethojini të vjetrit me respekt dhe jini të butë ndaj të rinjve. Vizitojini të afërmit, ruajini gjuhët tuaja dhe mos e shikoni atë që Allahu ju ka ndaluar dhe mos dëgjoni asgjë të ndaluar për veshët tuaj. Jini të mirë ndaj jetimëve të të tjerëve që edhe jetimët tuaj të marrin mirësi. Pendojuni Allahut për mëkatet tuaja dhe ngrijini duart drejt Tij në përgjërime gjatë lutjeve tuaja, sepse ato janë kohët më të mira, në të cilat Allahu i shikon robërit e Vet me mëshirë dhe u përgjigjet duave të tyre kur ata i luten.

"O njerëz! Shpirtrat tuaj janë pengje të veprave tuaja; ndaj, lirojini ato duke kërkuar faljen e Allahut. Kurrizet tuaja janë rënduar me peshën e mëkateve tuaja; ndaj, lehtësojuani barrët duke i zgjatur sexhdet tuaja. Ta

dini se Allahu i Lartë dhe Fuqiplotë është betuar në Dinjitetin e Tij se nuk do t'i torturojë ata që e falin namazin dhe i përulen Atij, dhe se nuk do t'i tmerrojë ata me pamjen e Zjarrit kur të ringjallen për t'u gjykuar.

"O njerëz! Kushdo nga ju që i shtron iftar një besimtari në këtë muaj do të ketë shpërblimin e atij që liron një rob dhe të gjitha gjynahet e kaluara do t'i falen.

Pastaj, dikush i tha: "O i Dërguari i Allahut! Asnjë nga ne s'mund ta bëjë këtë!" Atëherë, ai (s.a.v) u përgjigj: "Largojeni zjarrin e xhehennemit edhe me një hurmë të vetme! Largojeni zjarrin e xhehennemit edhe me një gllënkë ujë!"

"O njerëz! Cilido nga ju që e përmirëson sjelljen e vet gjatë këtij muaji do të ketë kalim të sigurt mbi Sirat-i Mustakim, kur shumë këmbë do të rrëshqasin; dhe cilido nga ju që ia pakëson ngarkesën shërbëtorit (ose punëtorit) të vet do të shpërblehet nga Allahu me ulje në llogaridhënie. Kushdo nga ju që përmbahet nga të lënduarit e tjetrit do të kursehet nga zemërimi i Fuqiplotit kur të takohet me Atë. Cilido nga ju që i ofron bujari një jetimi do të shpërblehet me bujari të Allahut ndaj tij në Ditën e Gjykimit. Kushdo nga ju që i përmirëson lidhjet me të afërmit do të shpërblehet nga Alla-

hu duke e përfshirë atë në mëshirën e Tij; dhe cilido nga ju që i keqëson lidhjet farefisnore, Allahu do ta tërheqë mëshirën e Vet prej tij kur Ta takojë. Për këdo nga ju që fal namaze vullnetare, Allahu do të urdhërojë mbrojtje nga tmerri i zjarrit. Cilido nga ju që kryen një obligim, do të marrë shpërblimin e atij që ka kryer shtatëdhjetë obligime në muajt e tjerë. Kushdo nga ju që i shtron salavatet mbi mua, Allahu do bëjë që shigjeta e veprave të tij të mira të rëndojë shumë, kur peshoret të jenë të lehta. Cilido nga ju që reciton një varg Kur'anor do të marrë bekimet e atij që reciton krejt Kur'anin në një muaj tjetër.

"O njerëz! Portat e xhennetit në këtë muaj janë të hapura, ndaj lutjuni Allahut - Zotit tuaj të mos jua mbyllë ato; dhe portat e xhehenemit janë të kyçura, ndaj lutjuni Allahut - Zotit tuaj që të mos i hapë ato për ju; dhe djajtë (shejtanët) janë të prangosur, ndaj lutjuni Allahut të mos i lëshojë ata ndaj jush!"

Kjo ishte hytbeja e Profetit (a.s) nga e cila mund të nxirren shumë mësim.

Si përfundim themi: Tani jemi duke folur për afrimin e këtij muaji, ky muaj do të vij, varet prej nesh se si do ta shfrytëzojmë dhe së shpejti do të themi, kaloi ky muaj, edhe All-llahu e di se a do ta arrijmë edhe muajin e ardhshëm të Ramazanit, vallë si do ta kalojmë këtë muaj dhe si do ta shfrytëzojmë këtë muaj.



Duhet të mundohemi që të shfrytëzojmë maksimalisht dhuratat që na i jep Zoti (xh.sh), sepse nuk i dihet se a do të kemi jetë që t'i arrijmë edhe dhuratat tjera. Sa e sa shokë i kemi pasur vjet, kurse sivjet nuk janë në radhët tona. Duhet punuar para se të na vijë vdekja, sepse atëherë do të themi: **"E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: "O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që lëshova!" Kursesit, (Kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distancë periodike) deri në ditën kur ringjallen".** (El-Muminun: 99-100).

Tregohet se Harun Reshidi, kur është shtrirë në shtratin e vdekjes, ky njeri i cili ku ishte i fuqishëm dhe me pushtet thoshte: Oj ti re, shko ku të duash dhe lësho shiun sepse haraçi (taksa) i asaj toke do të vij tek unë. Kur i erdhi vdekja, kur u shtri në shtratin e vdekjes, kërkoi ta shohë varrin ku do të varrosej, kur e dërguan

atje, qau dhe tha: "Pasuria ime nuk më bëri fare dobi. U hoq prej meje çdo kompetencë e imja". E ngriti kokën nga qielli dhe qau gjatë, pastaj tha: O Ti që nuk largohet prej teje pushteti, mëshiro atë që i ka shkuar pushteti. Shpirti im, erdhi koha e udhëtimit, të është afruar momenti i rëndësishtëm, bëhu gati, mos të të mashtrojë shpresa e madhe sepse do të shkosh në një vend, ku miku mikun e harron, do të ngarkohesh me gjëra të rënda. Të gjithë ne do të vdesim, nuk mbetet as krenari e as i mposhturi".

E lusim All-llahu që të na mundësojë ta shfrytëzojmë këtë muaj maksimalisht me vepra që e kënaqin All-llahun (xh.sh), me agjërim, namaz, sadaka etj... , dhe të na bëjë prej atyre që përfitojnë sa më shumë nga kjo dhunti e madhe e Allahut (xh.sh). Amin

Agjërimi dhe devotshmëria

Tek adhurimet gjinden dy anë të ndryshme, ana e dukshme (ana materiale-trupore) dhe ana e brendëshme (ana shpirtërore). Nëse do të merrnim si shembull namazin si një prej llojeve të adhurimit, do të konstatojm se, nëse kushtet dhe farzet (detyrimet) e namazit i interesojnë anës trupore (materiale), nijeti, sinqeriteti dhe përqendrimi në kohën

kurbanin “Tek Allahu nuk arrin as mishi as gjaku i tyre, por tek Ai arrin devotshmëria (bindja) juaj”², edhe në ajetin për agjërimit thuhet “O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm”³.

Përqendrimi në namaz, devotshmëria tek agjërimi

Madje vlera e punëve të zemrës qëndron më lart se vlera e punëve të organeve tjera. I Dërguari i Allahut (s.a.s) ka thënë: “Allahu nuk shikon në fytyrat tuaja (në pamjen tuaj të jashtme), por shikon në punët dhe zemrat tuaja”. Po kështu në një version tjetër profetik Muhamedi (s.a.s) duke treguar me dorë zemrën ka thënë tri herë: “Devotshmëria qëndron

Devotshmëria është diçka shpirtërore (që i përket zemrës). Rruga për të arrirë tek ajo kalon nëpërmjet agjërimit si një prej adhurimeve që frenojnë zemrën dhe egon. Për këtë arsye adhurimet duhet të kryhen në unitet mes organeve të jashtme dhe të brendshme

e kryerjes së tij i interesojnë anës shpirtërore. Këtë na e qartëson edhe ky ajet “Kanë shpëtuar ata besimtarë që përqendrohen në namazet e tyre”¹ Në ajetet e Kur’anit që flasin për agjërimit dhe kurbanin theksohet se gjëja e cila e afron njeriun tek Allahu (xh. sh.) është devotshmëria (takva). Ashtu siç urdhërohet në lidhje me

dhe kurbanit theksojnë sa detyrimin e anës material aq dhe atë të anës shpirtërore. Veçanërisht ky ajet “Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të parët dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi”⁴ tregon se edhe zemra do të këtë përgjegjësinë e saj të ngjashme me organet e tjera.

këtu”. Devotshmëria është diçka shpirtërore (që i përket zemrës). Rruga për të arrirë tek ajo kalon nëpërmjet agjërimit si një prej adhurimeve që frenojnë zemrën dhe egon. Për këtë arsye adhurimet duhet të kryhen në unitet mes organeve të jashtme dhe të brendshme. Në ajetin e mësipërm “...kështu që të bëheni të devotshëm”, në një farë mënyrë tregohet rëndësia e agjërimit. Duke

1 El-Mu’minun 23/9

2 El-Haxh, 22/37

3 El-Bekare, 2/183

4 El-Isra, 17/36

***I Dërguari i
Allahut (s.a.s)
u rekomandon
atyre që janë të
vetëdijshtëm se
po agjërojnë që
të mos bëhen
pjesë e ndonjë
grindjeje me dikë.
Edhe nëse dikush
këmbëngul,
duke i thënë atij
dy herë “unë
agjëroj” është e
rëndësishme t’i
tregohet atij se
nuk ka dëshirë
të jetë pjesë e
kësaj grindjeje.
Ky është një
tjetër reflektim
që realizon
agjërimi në jetën
shoqërore.***

qenë agjërimi një mjet i devotshmërisë ai e lidh zemrën që të agjërojë. Në qoftë se do të shpreheshim ndryshe, agjërimi është një adhurim ku së bashku me organet e jashtme lehtësisht merr pjesë edhe zemra. Kështu që mundësia për të gjetur në të devotshmërinë, singëritetin dhe ihsanin është mjaft e lartë. Ihsani është adhurimi i Allahut (xh.sh.) sikur e shi-

kon Atë. Njeriu në momentin e agjëritimit, duke u frikësuar vetëm nga Allahu (xh.sh.) dhe duke menduar se Ai po e shikon, nuk e zgjat dorën për të ngrënë diçka. Duke menduar së Allahu po e shikon, kur e merr uria, ai duron. Kjo patjetër është sjellja më pranë ihsanit.

Agjërimi është edukimi i vullnetit që stërvit njeriun për të frenuar egon e tij. Në hadithet profetike në lidhje me agjërimin thuhet: “..gjysma e durimit...”⁵, kurse për durimin: “..gjysma e fesë..”. Kështu që agjërimi i bie të jetë një e katërta e fesë. Kjo gjë kuptohet më mirë nëse do të linim mënjane “fjalën e dëshmisë” (la ilahe illa Allah), agjërimin do ta gjenim si një prej katër kushteve të Islamit.

I Dërguari i Allahut (s.a.s) u rekomandon atyre që janë të vetëdijshtëm se po agjërojnë që të mos bëhen pjesë e ndonjë grindjeje me dikë. Edhe nëse dikush këmbëngul, duke i thënë atij dy herë “unë agjëroj” është e rëndësishme t’i tregohet atij se nuk ka dëshirë të jetë pjesë e kësaj grindjeje. Ky është një tjetër reflektim që realizon agjërimi në jetën shoqërore. Është realizimi i harmonisë brenda shoqërisë si dhe brenda njeriut. Po ashtu agjërimi ka edhe veçorinë për të thyer dhe pakësuar ndjenjën e epshit tek njeriu. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë: “Agjërimi ka efektin e Vixha-së”⁶. Vixha do të thotë

shtypja dhe heqja e gjëndrave seksuale të mashkullit. Edhe agjërimi ka të njëjtin ndikim, në këtë mënyrë pakëson dëshirën seksuale. Pakëson animin nga egoja dhe thyen epshin. Për këtë arsye I Dërguari i Allahut (s.a.s.) i ka këshilluar të rinjtë: “Kush ka mundësi nga ju le të mar-tohet. (kurse) ai që s’ka mundësi le të agjërojë”⁷. Në një hadith tjetër thuhet: “Shejtani lëviz nëpër damarët e birit të njeriut. Ngushtojani atij rrugën me agjërim”. Në këto hadithe tregohet se agjërimi është një mburojë kundër shejtanit dhe egos së njeriut.

Një tjetër ndikim i rëndësishëm që sjell agjërimi në jetën tonë shpirtërore është modestia dhe kujtesa ose rikujtimi (për të tjerët). Një person që edukon egon e tij me agjërim dhe arrin të mbi-zotërojë mbi epshet e tij, mëson të jetë edhe modest. Është konstatuar së vrazhdësia dhe egërsia tek njerëzit e pasur dhe të ngopur është më e lartë se tek njerëzit e uritur. Njerëzit që pakësojnë aktivitetet e tyre me uri i përballojnë më lehtë vështirësitë. Kurse në sjelljet me të tjerët tek ata sundon modestia. Njeriu duke ia thyer zemrës ndjenjën e mendjemadhësisë dhe duke qenë më i përlur ndaj Krijuesit të tij, njëkohësisht e ndien veten më pranë Allahut. Kuptimin e këtyre fjalëve e gjejmë të shprehur më bukur në hadithin Kudsij: “Allahu është së bashku me ata që e thyejnë zemrën e tyre (mendjemadhësinë e zemrës së tyre)”.

5 Tirmidhi, Dua 86
6 Buhari, Savm,10

7 Muslim, Nikah,1

Disa vendime të fikhut në lidhje me agjërimin

Agjërim i kryer me qëllim adhurimi është mosgrënia dhe mospirja e diçkaje, moskryerja e marrëdhënieve seksuale nga agimi e deri në perëndim të diellit.

1 - Qëllimi për të agjëruar

Qëllim (nijet) do të thotë marrja e një vendimi të brendshëm për kryerjen e diçkaje. Qëllimi konsiderohet farz për kryerjen e adhurimeve. Edhe për agjërimin mund të themi që një agjërim pa nijet është i pavlefshëm. Nijetet e bëra para kësaj kohe janë të pavlefshme. Një person i cili në një ditë ramazani nuk ka bërë ndonjë gjest që mund të prishë agjërimin por akoma nuk ka bërë nijetin, mund ta bëjë atë deri nga mesi i ditës, pra në mes imsakut dhe perëndimit të diellit. Ai person që e bën nijetin në këtë kohë agjëron me një qëllim të caktuar pothuajse gjysmën tjetër të ditës.

Nuk kërkohet që nijeti të thuhet me gojë pasi është dëshiruar me zemër nga personi. Ngritjen në syfyr mund ta marrim nijet të agjërimin të asaj dite.

Ato që nuk bëjnë nijetin e agjërimin.

Një person i cili në një ditë të zakonshme ramazani, nuk bën nijetin deri në kohën e drekës atëherë duhet ta bëjë kaza atë ditë (ta kompensojë) pas Ramazanit.

Është e ndaluar ngrënia dhe pirja e ndonjë gjëje deri në kohën e iftarit. Meqë ky person nuk ka bërë nijetin për të agjëruar atë ditë, atëherë nuk është e lejuar që të kryejë veprime të cilat e prishin agjërimin. Kjo për arsye se Allahu (xh.sh) u ka dhënë leje për të mos agjëruar vetëm disa personave si p.sh. të sëmurit, të moshuarit, udhëtarit etj. N.q.s ai person ha ose pi diçka duke mos marrë pjesë në asnjërin prej këtyre grupeve, quhet kundërshtar i Allahut. Si rrjedhojë asnjë mysliman nuk mund të hajë ose të pijë diçka duke thënë se nuk është agjërueshëm.

2 - Koha e agjërimin

Agjërimi fillon nga agimi i ditës deri në perëndimin e diellit në mbrëmje. Agim do të thotë shfaqja e vijës së parë të bardhë në horizont. Në atë kohë mbaron nata dhe hyn koha e namazit të sabahut. Edhe koha e agjërimin fillon me rrezet e para të dritës së agimit. Kjo kohë quhet ndryshe dhe imsak. Pra është fi-

llimi i kohës së ndalimit nga të gjitha gjërat e ndaluara të agjërimin si ngrënia, pirja etj. Rrezet e dritës fillojnë e shumohen dhe shpërndahen kudo.

Për të gjetur sa më saktë kohën e imsakut dhe të iftarit mund të ndiqni dhe kalendarët e nxjerrë nga Komuniteti Mysliman. Duhet të kemi parasysh se namazi i sabahut nuk falet menjëherë në kohën e imsakut.

3 - Gjërat që e prishin agjërimin

Agjëruesi e ka të ndaluar



të hajë, të pijë ose të kryejë marrëdhënie seksuale pas hyrjes së kohës së imsakut. Edhe n.q.s kryhen me qëllim, me dëshirë apo i detyruar ato e prishin agjërimin. Vetëm n.q.s bëhen në harresë nuk e prishin atë. Për këtë një hadith i Pejgamberit (s.a.s) thotë: “N.q.s agjëruesi ha ose pi diçka në harresë, le të vazhdojë agjërimin sepse Allahu i ka dhënë për të ngrënë”.

A - Kur prishja e agjëritit kërkon kazanë dhe kefaretin

Agjërimi quhet i prishur dhe kërkon kazanë dhe kefaretin n.q.s personi ha ose pi diçka qëllimisht ose me dëshirë për t'u ushqyer apo me qëllim kurimi, n.q.s kryen marrëdhënie seksuale qëllimisht me një person.

Prishja e agjëremeve tjera përveç Ramazanit, pavarësisht qëllimit, kërkojnë vetëm kompensimin e asaj dite dhe jo kefaretin. Kefareti është një dënim për ata të cilët e prishin agjërimin e ramazanit qëllimisht pa pasur asnjë lloj arsyeje siç e shpjeguem më lart.

Kefaret do të thotë agjërimi pa ndërprerje i dy muajve. Ato që nuk mund të agjërojnë, mund të ushqejnë gjash-tëdhjetë të varfër për një ditë ose të ushqejnë njërin prej tyre për gjash-tëdhjetë ditë.

Personi që do mbajë kefaretin mund të lirojë një rob, n.q.s nuk ka mundësi le të agjërojë gjash-tëdhjetë ditë, n.q.s përsëri nuk mundet,

atëherë le të ushqejë gjash-tëdhjetë të varfër.

Agjërimi i dy muajve konsiston në agjërimin e dy muajve hënorë. Agjërimi fillon në ditën e parë të muajit hënor dhe përfundon në ditën e fundit të muajit të dytë. Meqë muajt janë 29 ditësh personi në fjalë duhet të agjërojë 58 ditë. Ata të cilët nuk e kanë filluar agjërimin në këtë mënyrë në fillim të muajit, atëherë duhet të agjërojnë 60 ditë. Pas këtij agjërimi kompenson dhe ditët e Ramazanit.

B - Kur prishja e agjëritit kërkon vetëm kazanë

Agjërimi priset dhe kërkon vetëm kazanë n.q.s personi ha ose pi qëllimisht nga gjërat jo ushqyese ose më mire të themi të dëmshme dhe të neveritshme për trupin.

P.sh n.q.s agjëruesi ha miell, i priset agjërimi dhe kompenson vetëm atë ditë, sepse mielli nuk hahet. N.q.s personi nuk kryen marrëdhënie seksuale por nga afrimi trupor mund të ketë derdhje nga organi gjenital, atëherë agjërimi priset dhe bëhet kaza ajo ditë. P.sh. n.q.s nga puthja e bashkëshortit (bashkëshortes) burri mund të ketë derdhje dhe gruaja mund të ndiejë lagështirë, në këtë rast agjërimi u priset të dyve.

Ilaçi izordil dhe ai për azma:

Agjërimi priset edhe kur personat e sëmurë nga zem-

ra marrin ilaçin izordil apo të sëmurët me azma marrin ilaçin e tyre në trajtë pluhuri. Kjo për arsye se këto janë ilaçe dhe përdoren për kurim. Të sëmurët që duhet të marrin medoemos nga këto ilaçe e prishin agjërimin dhe e kompensojnë atë ditë më vonë. N.q.s. këto ilaçe merren nga njerëz jo të sëmurë atëherë kërkohet edhe kaza edhe kefareti i asaj dite.

Derdhja e pavetëdijshme, marrja e gjakut dhe vjellja:

Pejgamberi ynë (s.a.s) në një hadith të tij thotë : “ Tre gjëra nuk e prishin agjërimin. Këto janë vjellja, marrja e gjakut dhe derdhja e pavetëdijshme”.

Për derdhje të pavetëdijshme kemi parasysh derdhjen e një lëngu nga organi gjenital i mashkullit ose i femrës si pasojë e eksitimit në gjumë (nga shikimi i një ëndrre).

Lëngu që mund të vijë vetëm nga mendimi apo shikimi i diçkaje nuk e prish agjërimin.

Vjellja e cila nuk shkaktohet vetë, nuk e prish agjërimin, qoftë pak apo shumë. N.q.s. provokohet nga vetë personi dhe nuk vjell shumë nuk e prish agjërimin. Agjërimi priset në rastin kur personi qëllimisht vjell me gojë plot. Pejgamberi (a.s) thotë : “Ai që vjell qëllimisht duhet ta bëjë kaza atë ditë.”

4 - Gjërat që nuk e prishin agjërimin.

A - Gjërat e pamundura për t'u shmangur

Agjërimi nuk priset në ato raste kur njeriu e ka të pamundur mosmarrjen apo mosthithjen e gjërave të tilla. P.sh. kalimi në fyt i shijes së rrënjës së karafilit të vendosur në dhëmb kur ke dhimbje apo thithja e tymit nuk e prishin agjërimin. Edhe hyrja e një mize në gojë është e njëjta gjë.

Agjërimi nuk priset n.q.s kalojmë thërmija të mbeturra në mes dhëmbëve në madhësinë e një kokërr gruri. Moskalimi i tyre është i pamundur. Agjërimi priset n.q.s ne kalojmë ndonjë kokërr sa ajo e qiqrës sepse diçka e tillë nuk është e mundur të mbetet mes dhëmbëve. Kalimi i kësaj kokrrë mund të shmanget.

Marrja e diçkaje nuk e prish agjërimin. Agjërimi nuk priset edhe kur gjatë marrjes së abdesit apo gusulit ndihet në fyt lagështira e ujit.

B - Të bësh banjë dhe të lahesh në det

Agjëruesi nuk e ka të ndaluar larjen trupore pra bërjen e banjës.

Ndërsa kur flasim për larjen në det na vijnë në mendje ato plazhe ku femrat dhe meshkujt garojnë me njëritjetrin për të treguar vendet e turpshme. Një mysliman nuk mund të shkojë asnjëherë në vende të tilla, e ka të ndaluar. Ne flasim jo vetëm për larjen në det por edhe në

pishinë dhe kemi për qëllim futjen e gjithë trupit në ujë. N.q.s. agjëruesi nuk i hyn ujë nga goja apo nga hunda, nuk ka asnjë problem. Kalimi i ujit në vesh nuk e prish agjërimin. Por duke marrë parasysh faktin që gjatë notimit mundësia e hyrjes së ujit në hundë apo në gojë është e madhe mund të themi se një larje e tillë është mekruh (e papëlqyeshme).

***Nëqoftëse
agjëruesi ha
ose pi diçka
në harresë, le
të vazhdojë
agjërimin
sepse Allahu i
ka dhënë për
të ngrënë***

5 - Personat që nuk mund të agjërojnë**A - Gruaja me menstruacione dhe lehona**

N.q.s. një gruaje i vinë menstruacionet gjatë agjërimit apo mund të lindë agjërimi i saj quhet i prishur. Nuk është i lejuar agjërimi gjatë ditëve të menstruacioneve dhe lehonisë.

B - Të sëmurët

Një i sëmurë i cili frikësohet nga rëndesa e sëmundjes apo nga zgjatja e saj, mund të mos agjërojë ose të prishë agjërimin e filluar.

Ai i kompenson ato ditë pasi të shërohet. Mund të mos agjërojnë edhe personat të cilët gjatë agjërimit frikësohen nga humbja e kontrollit mendor dhe nga acarimi i sistemit nervor.

Në këtë pikë nuk merret parasysh vetëm frika. Kjo frikë duhet të jetë e bazuar në eksperiencën e të sëmurit dhe të jetë e provuar më parë. Një personi i cili është mëkatar i fshehur mund t'i mjaftojë dhe fjala e doktorit. Këtu nuk mund të merret parasysh fjala e doktorit kur kemi raste jo të rënda, pra raste që mund ta përballojnë agjërimin.

I sëmuri kompenson pas shërimit të tij po aq ditë sa ka lënë pa agjëruar.

N.q.s. i sëmuri vdes pa i kompensuar ditët e agjërimit për shkak të sëmundjes, nuk mban përgjegjësi për ato. Pas shërimit e ka farz agjërimin kaza të atyre ditëve. N.q.s. nuk mund t'i kompensojë atëherë mund të ushqejë nga një të varfër çdo ditë. Vlera e tij është e barabartë me sasinë e fitrave.

KOMENTI METAFIZIK I FESTES SE BAJRAMIT

Fjalët ose konceptet mund të kenë disa kuptime, por zakonisht njëri prej tyre është më kryesori. Koncepti që do trajtojmë në artikullin tonë është “bajrami”. Përshtypja e parë që lë ky koncept mbi njeriun, është gëzimi dhe hareja.

Gëzimi është shenjë e lumturisë dhe e kënaqësisë. Ai shpreh shpëtimin nga shqetësimet spirituale, arritjen në prehjen shpirtërore dhe në qetësinë e munguar. Ndërsa burimi i gëzimit që sjell festa e Bajramit, nga aspekti semantik, është një buzëqeshje e ëmbël në fytyrën e njeriut.

E kundërta e gëzimit është vuajtja, shqetësimi e dhimbja. Psikologjia frojdiste, sa do që e ka trajtuar nga disa prizma natyrën e gëzimit dhe të dhimbjes, pozicionin dhe metabolizmin e njeriut dhe simptomat që janë pasojë e subkoshiençës, ai nuk e ka zgjidhur çështjen se në cilën pjesë të trupit të njeriut ndodhet dhimbja. Duke u nisur nga mendimi se dualiteti gëzim-dhimbje është i lidhur në mënyrën direkte me shpirtin, pamundshmëria e njohjes së shpirtit mendojmë se është shkaku i vërtetë që kjo çështje është e pazgjidhshme. Do me thënë, shpirti, enigmaticitetin e tij ia ka veshur edhe dhimbjes të cilën e ka të lidhur direkt me veten, kështu edhe atë e ka misterizuar.

Nga pikëpamja transcendentale dhe imanenciale, Allahu nuk është as brenda

***Përshtypja
e parë që lë
koncepti i
bajramit mbi
njeriun, është
gëzimi dhe
hareja.***

e as jashtë gjithësisë. Thënë ndryshe, Allahu, nga aspekti *dhatî* është tej gjithësisë (transcendent, subhan) dhe nga aspekti i cilësive të Tij Ai është i lidhur me gjithësinë, kohën dhe vendin. Nëse mund ta krahasojmë, kështu edhe shpirti ka lidhje me trupin *corporalle*. Pra edhe shpirti ndodhet as jashtë e as brenda trupit. Ashtu siç e ka cekur edhe Xhelaleddin Rumi, “Allahu e ka lidhur trupin me shpirtin me një lidhëse (esprit anima, shpirt shtazor). Për shkak të kësaj pozite që ka shpirti në trup në gjendjen *etendue*, dualiteti gëzim-dhimbje i dhënë si një cilësi, në prizmin anatomik nuk është i përcaktuar sa të thuhet “ja ku është!”. Ndërkohë që shpojme dorën me një gjilpërë, mënyra e të per-

ceptuarit të kësaj ndjenje, megjithëse kjo gjë ndodh në mendje, dhimbjen nuk e jep mendja por dora.

Dy lloje dhimbjesh ka: 1. Dhimbje fizike, 2. Dhimbje metafizike. Si shembull i dhimbjes fizike mund të japim plagosjet ose plagët si pasojë e ndonjë goditjeje. Ndërsa, shqetësimi

shpirtëror qëndrihet si pasojë e kryerjes së ndonjë gjynahi apo karshi padrejtësive mund ta japim si shembull të dhimbjes metafizike.

Nëse e analizojmë nga këndvështrimi antropologjik, disa mendimtarë ekzistencialistë të mbe-tur nën ndikimin e filozofit pesimist gjerman A. Schopenhaur, botën e kanë vlerësuar si burim i të keqës, si pasojë edhe dhimbjen e kanë vlerësuar si pasojë e botës. Mendimtarë të ndikuar nga ekzistencializmi perëndimor i startuar me Kierkegard-in, si Jean Paul Sartre, Simon de Beauvoir dhe Albert Camus kanë analizuar me imtësi dhe me mjeshtri në veprat e tyre dhimbjen e “njeriut të shkretë të hedhur në këtë botë absurde”.

Aq sa është filozofuar rreth dhimbjes nuk është filozofuar rreth gëzimit. Mendojmë se ditët e lumtura dhe të gëzuara të njeriut për arsye se janë më pak se ditët me shqetësime me siguri filozofët i kanë nxitur të ndalen më shumë mbi dhimbjen. Mirëpo, disa filozofë perëndimor me natyrë optimiste, kanë lodhur trurin duke e trajtuar gëzimin si një problem antropologjik. Leibniz-i është një filozof që ka kontribuar në këtë fushë duke u nisur nga pika që bota është më e mira e mundshme. Filozofi intuitionist, Henri Bergson në librin e tij “An Essay on the Meaning of the Comic” ka trajtuar mjaft bukur problemin e gëzimit.

Si mund ta bëjmë shtjellimin e problemit të gëzimit nga aspekti Islam?

“Të Allahut jemi dhe vetëm Atij do t’i kthehemi” {Bakara, 156} **“...E kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë veprë të mirë...”** {Kehf, 110} **E kur ta përsosë atë** (në formën e njeriut) **dhe t’i japë atij shpirtin që është krijesë Imja...”** {Hixhr, 29} Duke u nisur nga këto dhe ver-sete të ngjashme duam t’i bëjmë një shpjegim të këtillë gëzimit:

Njëri dimension i njeriut është materie e tjetri është hyjnor. Në esencën dhe ndërëgjegjijen e njeriut ekziston një anim nga hyjnorja.

Në këtë kontekst, njeriu, para se t’i drejtohej trupit të tij, ishte i lumtur pranë Allahut. Aty nuk ekzistonte nevojat trupore, ekzistonte vetëm dashuria ndaj Allahut. Vetëm me vullnetin e Allahut është krijuar gjithësia dhe njeriu me përbërjen e tij materiale, shpirti që jetonte në një mënyrë absolute në botën shpirtërore, pastaj e braktisi atë dhe iu drejtua trupit *corporalle* që i ishte përcaktuar atij. Tashmë me ardhjen në këtë botë, ai e humbet rehatinë dhe lumturinë e mëparshme. Kur ishte tek Allahu, esencialisht e dinte madhësitinë e Tij, e dashuronte dhe ndiente gëzim. Më parë kishte unitet, ndërsa tashmë do përballej me një dualitet shpirt – trup, i larguar nga qetësia, nga uniteti, tashmë do ekzistojë


***Njeriu duke
e kthyer
në aksion
manifestin
hyjnor të
Kur'anit
Famëlartë
bëhet rob i
Allahut e jo
rob i zotëve të
tjerë (epshi,
dëshirat, etj.).
Një njeri që
është “abd”
i Allahut,
arrin në
lirinë, prehjen
shpirtërore
dhe lumturinë
absolute.***

dualiteti. Kërkesat trupore dashje pa dashje njeriun e shtyjnë të bëjë lidhje interesi. Ndërsa esenca e njeriut ndiente mallin e lumturisë kur ishte pranë Allahut. Dëshiron ta zotërojë sërish. E ndien dëshirën për të arritur vlerat e larta. Mirëpo qenia trupore është pengesa më e madhe për një gjë të tillë. Pikërisht kjo gjendje e dyfishtë e njeriut, e shtyn atë për në shqetësim, për në telashe, për në një luftë të brendshme. Kur njeriu thellohet në mendime lidhur me këtë temë, e gjen veten e tij në mesin e një oqeani të hiç-it. Sepse përveç Allahut, çdo gjë është e vdekshme. {Rahman, 26 – 27}

Njeriu duke e kthyer në aksion manifestin hyjnor të Kur'anit Famëlartë bëhet rob i Allahut e jo rob i zotëve të tjerë (epshi, dëshirat, etj.). Një njeri që është "abd" i Allahut, arrin në lirinë, prehjen shpirtërore dhe lumturinë absolute.

Lidhja me materien, ta duash atë aq sa ta bësh idhull, njeriun e bën rob të materies. Kjo lidhje, njeriun nuk e bën të arrijë lumturinë, gëzimin dhe qetësinë e vërtetë, sepse trupi që është i përkohshëm nuk mund ta kënaqë shpirtin që është i përhershëm; atë mund ta ngop vetëm një gjallesë e përhershme, Allahu.

Bota Perëndimore e cila lën përshtypje sikur ka pushtuar materien, sipas këndvështrimit sociomoral po e humbet qetësinë si një njeri që ka rënë në



moçal, gjithnjë e po fundoset në moçalin e materies e po mbytet. Një nga tre persona në SHBA ka nevojë për psikiatër. Kjo gjë tregon qartë se si njeriu i Perëndimit është në një udhë pa krye, ka humbur origjinën e tij ose nuk sillet në thelbin e tij. Ndërsa të jetosh Islamin sipas Kur'anit është receta e vetme për të shpëtuar, për t'iu sjellur në origjinë, për t'iu afruar më shumë përkryerjes. Nëse e analizojmë nga aspekti lingistik fjalën Islam do shihet se kjo fjalë përfshin prehjen shpirtërore, qetësinë, paqen, shpëtimin nga sëmundjet, etj. Në këtë kontekst, të përqafosh Islamin do të thotë të arrish prehjen shpirtërore, qetësinë dhe të arrish shëndetin shpirtëror.

Gëzimi i festës së Bajramit i manifeston individit qetësinë shpirtërore, lumturinë dhe ndjenjën e rehatisë që i ka dhënë udhëtimi i gjatë për në origjinën e tij. Besimtari që me agjërim ka edukuar shpirtin, me zeqatë është pastruar shpirtërisht, me kurban i është afruar Allahut duke u ngjitur në vlera të larta, me namaz ka bërë miraxh. Tashmë ai ka mundur të takohet me mëshirën e Allahut. Përfundimisht shpirti duke e kapërcyer pengesën materiale e cila quhet trup ka mbërritur në një lumturi duke bërë një kontakt me origjinën dhe feston Bajramin me një fytyrë të shndritur dhe të gëzuar ("vuxhuhun jevmeidhin nadirah").



Jeta e zotëriut tonë në muajin e Ramazanit

Pr. Dr. Jashar Kandemir

“Xhenneti ka tetë dyer. Njëra prej tyre quhet Rejjan. Nga ajo derë do të hyjnë vetëm agjëruesit. Kur të hyjë agjëruesi i fundit dera e Rejjanit do të mbyllet. Atyre që hyjnë në këtë derë do t’u serviret një pije; ai që e pi atë nuk do të ketë më etje.”

I nderuari i botës, zotëria ynë, e priste muajin e Ramazanit me mall...

Kur i arrinte tre muajt e shenjtë gëzohej e në muajin e Rexhepit agjëronte më shumë se në asnjë muaj tjetër. Ndërsa muajin e Shabanit, pothuajse të tërë kohën e kalonte agjërueshëm dhe thoshte : “Është e virtytshme të agjërohet në muajin e Shabanit për respekt të muajit të Ramazanit.” Por me qëllim që të priste Ramazanin, nuk e shikonte të drejtë të agjërohej vetëm një ose dy ditë përpara tij. Ashtu siç shikon i dashuri rrugën, ardhja e muajit të Ramazanit i jepte atij kënaqësinë më të madhe dhe me gëzim e pasion shpjegonte shkëlqimin e muajit të bekuar duke thënë : “ Kur vjen Ramazani dyert e xhennetit hapen plotësisht, dyert e xhehennemit mbyllen; shejtanët kthehen në një gjendje të padëmshme”.

“Xhenneti ka tetë dyer. Njëra prej tyre quhet Rejjan. Nga ajo derë do të hyjnë vetëm agjëruesit. Kur të hyjë agjëruesi i fundit dera e Rejjanit do të mbyllet. Atyre që hyjnë në këtë derë

do t’u serviret një pije; ai që e pi atë nuk do të ketë më etje.”

Zotëria ynë i dashur, me lajmet e mira që kanë vlerë sa kjo botë, thoshte se agjërimi duhet të mbahet me sinqeritet. Ky adhurim me vlerë që do i paraqitej Allahut të Lartësuar. Ai kërkonte që të jetë i plotë saqë të zbardhej fytyra e agjëruesit.

KOHA E SYFYRIT

Kohës së syfyrit i kushton-te një rëndësi të veçantë.

“Aman mos nënvlerësoni ngritjen në syfyr sepse ushqimi i syfyrit është një ushqim i bekuar”-thoshte.

Një të varfër nga sahabët i cili jetonte në mesxhidin Nebevi dhe që ishte nga fatmirët e parë që kishin hyrë në Islam (Irbaz b. Sarije), e thirri profeti (a.s) për syfyr e i tha: “Urdhëro nga ky ushqim i bekuar”

Ndërsa në një rast tjetër, rëndësinë e ngrënies së syfyrit e pat shpjeguar kështu: “Ushqimi i syfyrit është me bereqet. Mos u bëni nga ato që s’e hanë syfyryn. Qoftë edhe me pak ujë bëjeni syfyryn, sepse

All-llahu i Lartësuar dhe melekët e Tij, lëshojnë mëshirë mbi ata që bëjnë mëshirë, mbi ata që bëjnë syfyryn".

Lavdia e Botës, profeti (a.s), është e qartë se përse i ka dhënë kaq vlerë syfyrit, sepse koha e syfyrit është koha e seherit; është koha kur mëshira dhe bereqeti i All-llahut bien pa pushim; është një kohë e bekuar ku adhurimi, lutja dhe dhikri janë si një qëndisje që punohet nga ata të cilët i kanë dhënë zemrën Allahut xh.sh.

Vëllezër te dashur! Të paktën gjatë muajit të bekuar të Ramazanit edhe ne ta vlerësojmë këtë kohë me shumë vlerë.

Edhe ne duhet të mundenemi që të paraqesim gjendjen tonë të përlulur sikur ata që i luten Të Lartësuarit të Vërtetë me një pasion që vlon nga thellësitë e zemrës sepse në këtë kohë të ndritshme (syfyr), të jesh zgjuar ka një kuptim të madh.

Ata besimtarë që çohen në syfyr në përluljen e tyre sikur thonë kështu:

O Zoti im! Të qofshin shumë falënderime ngaqë unë jam njëri nga ata që të njeh Ty, të do Ty dhe që ka dhënë zemrën për Ty.

Për të paraqitur lidhjen time me Ty e ndërpreva gjumin dhe u zgjova.

Nesër për kënaqësinë Tënde do të agjëroj.

O Zoti im, ç' ndodh sikur të jesh i kënaqur nga unë?

KOHA E IFTARIT

Allahu i Lartësuar, gëzohet kur shikon lidhjen dhe respektin që robi ka me Të. Koha e iftarit, është koha më e mirë ku pasqyrohet kjo lidhje dhe ky respekt e për këtë arsye, zotëria ynë, më i madhi profet, Muhamedi (a.s) e ndiqte me seriozitet kohën e iftarit. Sapo hyn te koha e iftarit, kohë në të cilën duhet të prishte agjërimin, profeti (a.s) ngjasonte me një fëmijë të pamëkatshëm i cili shqetësohej për prishjen e agjërit dhe kjo shenjë tregonte se All-llahu Tea'la do të gëzohej me të, dhe këtë e konsideronte si një shenjë që jeta fetare do të mbahej gjallë.

Ngrënia me vonesë e iftarit tregon një lloj mos serioziteti dhe thoshte:

"Ummeti im nuk do të ndahet nga punët e mira dhe bereqeti për sa kohë që të tregojë përkushtim që ta çelin iftarin një çast e më parë".

Fjalët që profeti (a.s) tha për punët e mira dhe bereqetin janë aq të thella e të rëndësishme saqë bëjnë që njeriu të arrijë dashurinë e Allahut xh.sh. Këtë e mësojmë nga një hadith kuds ku thuhet : *"Ndër robërit e mi që dua më shumë janë ata që tregojnë përkushtim ndaj hapjes së iftarit një çast e më parë".*

Domethënë që rruga për të arritur dashurinë e pashoqe të Allahut xh.sh është bindja ndaj Pejgamberit dhe bërja e atyre punëve që ai ka bërë; e që kjo është e tillë a nuk na e thotë haptazi Kur'ani i Madhërueshëm?

Ushqimi i syfyrit

është me bereqet.

Mos u bëni nga

ato që s'e hanë

syfyryn. Qoftë

edhe me pak ujë

bëjeni syfyryn,

sepse All-llahu

i Lartësuar dhe

melekët e Tij,

lëshojnë mëshirë

mbi ata që bëjnë

mëshirë, mbi ata

që bëjnë syfyryn.

“ O Muhamed! Thuaj që:

Në qoftë se me të vërtetë e doni Allahun, m'u bindni mua që edhe All-llahu t'ju dojë ju”.

Po të mos i përmbahemi të dërguarit të Allahut dhe nëse nuk duam atë, nuk do të arrijmë dashurinë e Tij. Sa bukur na e përshkruan poeti kur thotë:

“Muhamedi u bë nga dashuria

Ç'mund të jetë dashuria pa Muhamedin”?

Zotëria ynë, i dërguari i nderuar, thoshte se dua ja që bëhet gjatë iftarit do të pranohet. Para se të fillonte iftarin ai (a.s), bënte dua; një e tillë ishte:

“ O Zoti im! Për kënaqësinë Tënde agjërova dhe po e hapi agjërimin me ushqimin që më ke dhënë Ti”.

Më pas e hapte agjërimin, me hurmë nëse kishte e nëse jo me ujë; këshillonte edhe të tjerët që kështu të bëhej.

ZOTI IM MUA MË USHQEN

Profeti (a.s), nga mbajtja e agjërimit ndjente një kënaqësi të veçantë e aq të thellë sa që nga dëshira që kjo kënaqësi të vazhdonte si dhe të vazhdonte thellësia shpirtërore e shkaktohet nga uria, agjëronte disa ditë pa ndërprerje. Ai donte që netët e muajit të Ramazanit dhe ditët t'i kalonte veç me adhurim. Sahabet kur e panë gjendjen e tij, u ngritën të agjërojnë



një lloj agjërimi që quhet *visal*, por pejgamberi (a.s) i ndaloi ata. E kur i thanë: *Ti vetë agjëron kësisoj, përse ne nuk na lejon?”* Ai u përgjigj: *“Unë nuk jam si ju. Zoti im më ushqen dhe më jep të pi”.*

Ne nuk e dimë sesi e ushqente All-llahu xh.sh pejgamberin e Tij të dashur; ky ushqim a ishte material apo një ngopje shpirtërore që vinte si rrjedhojë e të qenit afër me Allahun xh.sh; ne s'e kuptojmë dot por jemi të sigurt se pejgamberi ynë i dashur, ngaqë e donte shumë ummetin e tij, mendonte se ata nuk do t'i bënin ballë urisë dhe do të sëmureshin e dobësoheshin e ndoshta pas njëfarë kohe do të mërzhiteshin e do të hiqnin dorë për këtë arsye nga adhurimet e tjera apo nuk do t'i kryenin ashtu siç duhet.

TERAVIA

Gjatë muajit Ramazan, shihej një rritje e namazeve nafile nga i dërguari i Allahut dhe për këtë, gjëja më e qartë ishte namazi i Tera-

visë.

Një aksham në muajin e Ramazanit, në kohën e lumtur ku kishin mbetur edhe shtatë ditë nga mbarimi i muajit⁸, atë natë për së pari priu në namazin e teravisë. Teravia zgjati deri në një të tretën e natës. Të nesërmen, gojë më gojë, u përhap lajmi se profeti (a.s) kishte prirë në namazin e Teravisë. Priu edhe për dy ditë te tjera në Teravi e jo më. Pasi kishin mbetur tre ditë nga mbarimi i Ramazanit fali një namaz që zgjati gjatë gjithë natës. Këtë e bëri duke mos lejuar që teravia të kuptohej si farz si dhe këshilloi që çdokush ta falë atë në shtëpi. Tradita e të falurit të Teravisë me xhemat ka filluar që në kohën e hazreti Umerit.

LEXIMI I Kur'anIT

Në këtë muaj të adhurimit, duave dhe dhikrit Profeti ynë lexonte edhe më shumë Kur'an. Gjatë muajit të ramazanit Xhebraili

8 Dhjetëditëshi ku pritët që në netët teke të jetë edhe nata e Kadrit

vinte më shpesh tek profeti (a.s.) dhe së bashku lexonin ato ajete të Kur'anit që ishin shpallur deri atëherë dhe kështu i kontrollonin ato. Në ramazanin e fundit në dallim me herët e kaluara kjo përsëritje dhe kontrollim i mbamendjes së Kur'anit u bë dy herë radhazi.

Profeti ynë duke na tërhequr vëmendjen drejt mirësive dhe pasurive shpirtërore që leximi i Kur'anit do të na sjell në botën tonë të brendshme, tha:

"Agjërimi dhe leximi i Kur'anit në muajin e ramazanit do të bëhen ndërmjetës të njeriut.

Agjërimi do të thotë: "Zoti im! Unë robin tënd e mbajta larg ushqimit dhe nevojave materiale. Pranoje ndërmjetësimin tim të këtij robi!"

Gjithashtu edhe Kur'ani do thotë:

"Unë robin tënd e mbajta larg gjumit në një pjesë të natës. Pranoje ndërmje-

tësimin tim të këtij robi! "

Kështu që të dy këto vep-ra bëhen ndërmjetësues për njeriun tek Zoti i tij.

Bujaria e profetit bëhej edhe më e bollshme në muajin e ramazanit. Në tre muajt e shenjtë **"Ai ishte edhe më bujar se një erë që freskon krijesat e Zotit pa pushim"**. Ai ndante çdo gjë që i binte në dorë, nëse i kërkohej diçka e jepte menjëherë kur s'e kishte e siguronte nëpërmjet të tjerëve. Ai tha se lëmosha e dhënë në muajin e ramazanit është më e vlefshmeja.

DREJT DITËVE TË LAMTUMIRËS

Në ditët e fundit të ramazanit vërehej që profeti i shtonte adhurimet. Ai kujdesej që mos t'i kalonte nata e Kadrit e cila është njëra nga dhjetë netët e fundit të muajit të ramazani. (në mundësinë më të madhe për të qenë nata e 25, 27, 29-të).

"Kush fal namaz në këtë natë duke besuar në bega-

tinë e saj dhe duke pritur shpërblimin vetëm nga Allahu i falen të gjithë mëkatet e mëparshme"

Në dhjetë ditët e fundit të ramazanit profeti hyn-te në itikaf në Mesxhidi Nebevi. Kuptimi i këtyre përkushtimeve si namazi, duatë, dhikri dhe lloje të ndryshme të adhurimit sikur thonin: " Zoti im kam ardhur tek dera jote. Nëse ti nuk më fal unë nuk lëvizi prej këtu"

Në mënyrë të përmbledhur kjo ishte jeta që bënte profeti në muajin e ramazanit

I lutemi Zotit të na dhurojë aftësinë për ta vlerësuar këtë muaj me këtë kohë kaq të çmueshme e me këto mirësi kaq të shumta...

Amin

***Zoti im! Unë robin
tënd e mbajta
larg ushqimit
dhe nevojave
materiale. Pranoje
ndërmjetësimin
tim të këtij robi!***



Muaji i bekuar i Ramazanit dhe agjërimi

Ramazani i bekuar, gjatë të cilit mbahet agjërimi, është muaji i shpërblimeve hyjnore brenda së cilit përjetohet një jetë e pasur me begati dhe frymëzime hyjnore. Në këtë muaj, i cili na sjell ndër mend vlerat e begative të panumërta që posedojmë, mësojmë se me anë të begatisë së agjërimit, obligimit që na ka urdhëruar Allahu (xh.sh.), ne shtiem në dorë sekretin e largimit prej gjërave kalimtare dhe fitimin e shijeve të përhershme.

Agjërimi është lufta me pengesat e egos pasi jemi veshur me petkun e koshiençës së një adhurimi të vazhdueshëm dhe në këtë mënyrë të minimalizojmë ndikimin e egos duke i vënë fre asaj.

Agjërimi e perfeksionon shkallën tonë të etikës dhe moralit duke na mësuar edukatën e atyre gjendjeve aq të domosdoshme për luftën e jetës, siç janë “durimi, vullneti, largimi prej dëshirave epshore”. Po kështu ky adhurim është një barrierë për të mbrojtur nderin e njeriut përballë dëshirave që s’dinë të sosin të egos.

Gjithashtu, përveç hijeshisë që i dhuron agjëruarit me anë të kultivimit tek ai të sjelljeve të bukura siç janë përmbajtja, ngopja me atë që ka, pranimi i situatës në të cilën gjendet, rezistenca dhe durimi, agjërimi na përkujton me anë të mospasjes dhe urisë vlerën e begative që na rrethojnë duke na sjell ndër mend gjendjen

e mjeruar të të skamurve, na i laton zemrat tona me ndjenjat e delikatesës, dhembshurisë dhe keqardhjes. Ai na gjallëron në zemra ndjenjën e falënderimit. Me këto karakteristika agjërimi është kumti hyjnor më i vlefshëm për të shkatërruar negativitetet që në jetën shoqërore e zhysin masën në mosprehjen shpirtërore me anë të ndjesive të smirës, inatit, xhelozisë etj.

Shokët e profetit (sahabet) tregonin një dëshirë të madhe përballë agjërimit në përgjithësi. Madje pati nga ata që përpiqeshin që të agjëronin agjërimet vullnetare (nafile) edhe ditëve të nxehta, kur mbajtja e agjërimit është aq e rëndë. E kishte nga këta sahabë që nuk kishin rroba që të mbroheshin nga rrezet përvëluese të diellit. Ata përpiqeshin që të mbroheshin nga të nxehtët dhe rrezet e diellit duke i mbuluar me duart e tyre pjesët e pambuluara të trupit. E me gjithë këto vështirësi ata i vazhdonin agjërimet e tyre, edhe ato vullnetare (nafile), të përshkuar nga një ndjeshmëri e lartë gëzimi dhe ngazëllimi



shpirtëror.

Mistiku islam Shekik el-Belhi ka thënë:

Të përmbushësh një adhurim fetar siç i ka hije është një art në vete.

Është uria që përjetojmë gjatë agjërimit ajo e cila, edhe në mjekësinë bashkëkohore, konsiderohet ndër kushtet që këshillohen për të qenë të shëndetshëm, por me një emër tjetër, dieta. Është uria që përjetojmë gjatë agjërimit mospasja më e vështirë për t'u duruar. Rrëfëhet në një transmetim se egoja (nefsi) kur u krijua së pari pati guximin që t'i drejtohej Allahut me fjalët "Ti je ti, unë jam unë" për shkak të të cilave edhe u dënua me mënyra të ndryshme, por vetëm kur u detyrua që të mbes e uritur duke mos iu dhënë asgjë për të shtënë në gojë, atëherë ajo u pendua dhe tha "Allahu është Krijuesi, unë jam robi i Tij" duke pranuar kështu dobësinë që kishte si krijesë përballë Krijuesit të Lartë. Kjo është arsyeja se, nuk ka asnjë pikë tjetër më me efekt në kalitjen e vullnetit se sa të mund t'i bësh ballë urisë. Vullneti është një nga kushtet themelore për t'i rezistuar tendencave biologjike dhe atyre epshore.

Llukmani e këshillonte me këto fjalë të birin:

Kur të jesh ngopur pa masë mendimi të bie në gjumë, urtësia hesht, organet e trupit nisin të qëndrojnë larg adhurimeve.

Një njeri i mirë dhe i devot-

shëm (veli) ka thënë:

I lutem Allahut të më ruaj që të mos bëhem një asket që e dëmton stomakun e tij me lloj-lloj ushqimesh.

Kur njëherë prej herësh Aisheja (r.anha) u tha të pranishmëve:

Përpiquuni që të mund të çelni dyert e qiellit.

E pyetën:

***Me këto
karakteristika
agjërimit është kumti
hyjnor më i vlefshëm
për të shkatërruar
negativitetet që në
jetën shoqërore
e zhysin masën
në mosprehjen
shpirtërore me anë
të ndjesive të smirës,
inatit, xhelozisë etj***

-E si arrihet kjo?

Aisheja (r.anha) u përgjigj:

Duke mbetur të uritur dhe të etur.

Agjërimi, adhurimi që i ka ditët e përcaktuar dhe të numëruar, i fal delikatesë, thellësi dhe hijeshi jetës tonë që përbëhet nga ditë të numëruara, sepse ngopja pa masë i ndez dëshirat epshore, ndër-
sa uria (me kusht që të mos

tejkalohej edhe me të) e forcon aftësinë e meditimit dhe përsiatjes. Kjo është arsyeja që kurimi i parë që u jepet njerëzve me sëmundje mendore është pehrizi.

Megjithëkëtë agjërimi duhet të ekzekutohet me ndjesinë e pastër të adhurimit, pasi që ai është një detyrim fetar. Në qoftë se anët pozitive të tij shndërrohen në qëllim, atëherë agjërimi nuk konsiderohet më si një adhurim fetar. Pra nuk duhet të nisemi me synimin të parandalojmë shëndoshjen nga ushqimi apo të dobësohemi, sepse atëherë as që mund të mendohet për ndonjë përfitim nga kënaqësia hyjnore. Të ngjashëm janë me këtë situatë edhe namazet që falen duke pasur si synim anët e mira të namazit për të vënë në lëvizje trupin apo namazet e falura me një zemër indiferente.

Adhurimet duhen kryer vetëm me synimin që të gëzojmë kënaqësinë hyjnore, prandaj për ta realizuar këtë është e domosdoshme që zemrat të jenë të ngritura shpirtërisht dhe të shkojnë drejt perfeksionimit.

Jemi të detyruar që gjatë muajit të Ramazanit të tregojmë kujdes ndaj disa pikave të caktuara që përmenden në këshillat e Pejgamberit, Muhamed (a.s.) siç janë:

Thënia shpesh e fjalës së dëshmisë (kelimetu'sh-shehadeti)

Lutja për falje mëkatesh dhe dhikri

***I Dërguari i Allahut
(a.s.) ka thënë:***

***-Agjërimi është si një
mburojë për agjëruenin,
përderisa ai nuk e çon
dëm atë me gjëra që
nuk i kanë hije.***

E pyetën:

***-Me çfarë mund të
çohet dëm agjërimi?***

Pejgamberi (a.s.) tha:

***Me gënjeshtria dhe
përgojime...***

Sa më shumë vepra të mira në mënyrë që të fitojmë xhenetin

Ruajtja dhe qëndrimi sa më larg nga mëkatet dhe aktet e papëlqyera fetarisht në mënyrë që të shpëtojmë nga xehenemi

Me sa të kemi mundësi të përpiqemi të kryejmë akte bamirësie dhe t'u dhurojmë nevojtarëve, si dhe të fitojmë lutjen e mirë të zemrave të thyera dhe të brengosura

Të shtrojmë iftare për agjëruesit etj...

Ramazani i bekuar është një stinë hyjnore e mëshirës, në të cilën besimtari mund të kultivojë ne personin e tij hijeshinë dhe pjekurinë. Ashtu sikurse tregojmë kujdes që të mos shtimë gjë në gojë gjatë kohës së agjërit, po ashtu duhet të tregojmë kujdes rreth fjalëve që na dalin nga goja. Duhet të tregohemi kategorikisht të distancuar nga

thashethemet dhe fjalët fyese në mënyrë që të mos e pakësojmë vlerën e agjërit që po mbajmë.

I Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë:

-Agjërimi është si një mburojë për agjëruenin, përderisa ai nuk e çon dëm atë me gjëra që nuk i kanë hije.

E pyetën:

-Me çfarë mund të çohet dëm agjërimi?

Pejgamberi (a.s.) tha:

Me gënjeshtria dhe përgojime... (Nesai, Muxhemu'l-evsat)

Sepse ata që thonë gënjeshtria dhe përgojojnë mbajnë agjërim ditës duke e larguar vetveten nga ushqimet e lejuara për të, por numërohen metaforikisht se iftarin e kanë kryer me rrugë haram, pasi që Kur'ani përgojimin e ka konsideruar një akt aq të fëlliqur duke e barazuar me ngrënien e mishit të njeriut. Mbase duke e parë nga dritarja e devotshmërisë dhe me një gjuhë alegorike Sufjan Thevriu është shprehur se:

Agjërimi i personit që merr të tjerët nëpër gojë, është i pavlefshëm.

E njëjta pikëpamje raportohet edhe nga një dijetar tjetër i periudhës së hershme islame, Muxhahidi.

Me fjalë të tjera, ata që e cungojnë shpirtërisht agjërimin e tyre duke thënë gënjeshtria

dhe marrë të tjerët nëpër gojë nuk e fitojnë një pjesë të vlerave të larta që përbëjnë pjesën e dëshiruar nga mbajtja e agjërit.

Kjo është arsyeja që me një rast pejgamberi Muhamed (a.s.) u shpreh me këto fjalë rreth personave që namazet dhe agjërimet e tyre i përziejnë me qëllime të kësaj bote dhe i lerosin me dyfytirësi, prepotencë dhe diferencë shpirtërore:

Sa ka nga ata që agjërojnë që në fund të agjërit nuk përfitojnë gjë nga agjërimet e tyre përveçse mbeten të uritur. Sa ka nga ata që netët i kalojnë me namaze (teravi dhe tehexhud), por nga namazet e tyre nuk përfitojnë asgjë përveçse mbesin pa vënë gjumë në sy. (Taberani)

Namazet, në mënyrë të veçantë namazet e natës, tehexhudi dhe teravia, duhet t'i sjellin prehjen zemrave të besimtarëve. Në këtë muaj të bekuar duhet të tregohet më shumë kujdes ndaj namazeve, duhet lexuar Kur'ani duke menduar rreth asaj që lexojmë, shpirtat tanë duhen veshur me petkun e delikatesës nëpërmjet dhikrit, me zekatin dhe sadakatë që dhurojmë duhet të mbërrimë prehjen shpirtërore. Meqenëse Kur'ani është shpallur gjatë muajit të Ramazanit, ne duhet që gjatë këtij muaji të bekuar të kultivohemi sipas edukatës Kur'anore dhe në këtë drejtim t'i vlerësojmë edhe adhurimet tona.

Kur'ani lexohet në të vërtetë me zemër, sytë janë në

detyrën e syzeve për zemrat tona.

Një tjetër veçori e Ramazanit është se u ofron besimtarëve një mundësi që t'i jetojnë ditët e mbushura me frymëzim dhe begatinë që të dhuron të jetuarit sipas mësimave Kur'anore.

Ndërmjet Ramazanit, agjërimit dhe Kur'anit ekziston një lidhje delikate dhe afërsi e thellë. E nga cili shikim tjetër, përveç Kur'anit, mund të dëgjohen këshillat rreth jetës dhe vdekjes?!

I dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë:

-Agjërimi dhe Kur'ani do të bëjnë ndërmjetësi ditën e gjykimit për robin. Agjërimi është gjysma e durimit.

Shpërblimi i agjërimit është i siguruar vetëm në agorën e Allahut (xh.sh.) Në një hadith kudsí thuhet:

Çdo akt dhe vepër e njeriut i përket atij. Agjërimi nuk është i tillë, sepse ai më takon vetëm Mua. Prandaj Unë do t'ia dhurojë me bollëk shpërblimin që i takon për agjërimin e mbajtur.

Pas këtij hadithi kudsí i Dërguari i Allahut (a.s.) urdhëroi dhe tha:

"Dy janë gëzimet që e pushojnë agjëruesin:

Gëzon kur bën iftar (sepse ushqehet me begatitë që i ka dhuruar Allahu).

Gëzon për gradën e lartë të

cilën do të ketë kur të takojë Allahun, gradë që e ka fituar me anë të begatisë së agjërimit. (Buhari)

Sikurse shihet Allahu (xh. sh.), përkrah kumtit të kënaqësisë hyjnore ndaj agjërimit, e ka mbajtur të fshehtë shpërblimin që do të dhurojë për shkak të agjërimit me qëllim që tek njeriu të shtohet edhe më shumë dëshira për agjërimin. Kjo i ngjan një shpërblimi shumë të madh që mbahet i fshehtë në mënyrë që të rritet kërshëria e pjesëmarrësve në një garë.

Agjërimi është adhurimi që na mëson vlerën e begative, që ndez ndjenjën e falënderimit, që të vetëdijëson rreth situatës në të cilën jetojnë të skamurit dhe të ngratët, që shpartallon ndjesitë dhe tendencat epshore, që na ngre në virtytin aq të lartë moral që quhet "durim" duke na shpëtuar prej robërisë materiale.

Ramazani është një muaj shumë i rëndësishëm që përbëhet prej agjërimit, namazeve të teravisë, zgjimit herët nëpër syfyre. Në hadithin fisnik raportohet dhe thuhet:

Allahu (xh.sh.) u ka obliguar që të agjëroni në muajin e Ramazanit. Unë kam caktuar si traditë time profetike namazin e mbrëmjes, teravinë. Po qe se një person agjëron muajin e Ramazanit dhe i fal namazet e teravive me një zemër besimtare dhe duke shpresuar që të fitojë shpërblimin hyjnor (sevap) do të pastrohet nga mëkatet ashtu sikurse lind fëmija nga barku i nënës"

***Sa ka nga ata që
agjërojnë që në fund të
agjërimit nuk përfitojnë
gjë nga agjërimet e
tyre përveçse mbeten
të uritur. Sa ka nga
ata që netët i kalojnë
me namaze (teravi
dhe tehexhud), por
nga namazet e tyre
nuk përfitojnë asgjë
përveçse mbesin pa
vënë gjumë në sy.***

Për të mundur të mbërrimë në të vërtetën e Ramazanit është e domosdoshme që të përfitojmë nga shirat mëshirues që reshajnë vetëm gjatë asaj stine besimi. Nuk ka ndonjë të mirë prej shirave të prillit që bien mbi gurore apo në det. Vetëm me ngazëllimin e besimit mund të shijojmë këtë stinë falënderimi dhe mëshire.

I dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë:

Kur vjen muaji i Ramazanit çelen dyert e xhenetit, kyçen dyert e xhehenemit dhe lidhen në zinxhir shejtanët. (Buhari, Muslim)

Pra fajet njerëzore dhe mëkatet minimalizohen se s'bën për personin që agjëron një agjërimit të vërtetë.

Në një hadith profetik rrëfëhet se:

***Agjërim nuk do të thotë
vetëm të ndërpresësh
ushqimin, pirjen etj.
Agjërimi i plotë dhe
që do të shpërblehet
nga Zoti është ai që
na largon prej fjalët e
kota, nga koha e kaluar
bosh, nga thashethemet
dhe fjalët e ndyta. Nëse
dikush ju fyen apo sillet
si injorant ndaj jush
atëherë thuaj "Unë jam
agjërueshëm dhe bëj
durim***



Teksa stoliset nga viti në vit me ardhjen e Ramazanit xheneti thotë: "Zoti im! Bëj në mesin e njerëzve nga ata që do ta meritojnë të hyjnë tek unë për hir të muajit të Ramazanit" (Taberani)

I dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë:

-Agjëroni që të jini të shëndetshëm. (Taberani)

-Shpejtoni në ngrënien e iftarit, lëreni për në fund të kohës së tij syfyryn.

Duhet të ruhemi shumë nga pakujdesitë që do të shkaktonin që agjërimi ynë të saka-tohet. Në mënyrë të veçantë nga nxehja dhe zemërimi.

Në një traditë profetike thuhet:

Agjërim nuk do të thotë vetëm të ndërpresësh ushqimin, pirjen etj. Agjërimi i plotë dhe që do të shpërblehet nga Zoti është ai që na largon prej fjalët e kota, nga koha e kaluar bosh, nga thashethemet dhe fjalët e ndyta. Nëse dikush ju fyen apo sillet si injorant ndaj jush atëherë thuaj "Unë jam agjërueshëm dhe bëj durim" (Hakim, Bejhaki)

Për këtë arsye muaji i Ramazanit është quajtur edhe muaji i durimit.

Durimi është pika e rëndësës për një moral të bukur, gjysma e besimit, çelësi i prehjes e lumturisë dhe begatia e madhe që të fal begatitë e xhenetit.

Durim në çështje të fesë dhe

të moralit do të thotë që përballë situatave të papëlqyeshme dhe të dhimbshme të mund të mbështillesh në qetësi, pa e prishur ekuilibrin, dhe t'i dorëzohesh vendimit të Allahut. Edhe peygamberët dhe njerëzit e devotshëm (evlija) e kanë arritur ndihmën e Zotit pasi kanë treguar një durim të rrallë. Ata janë shembujt e lartë për ne.

Krahu i kësaj bote për durimin është e hidhur, por krahu i saj për botën tjetër është e shkëlqyer. Ata që groposin thellë në kraharrorët e tyre dhimbjet e durimit janë ata që fitojnë xhenetin, vatrën e përhershme dhe kënaqësinë e Allahut.

Të përsiatësh rreth begatisë, urtësisë dhe shpërblimit hyjnor së urdhëresave dhe ndalimeve të Allahut, cilado qoftë situatë në të cilën ndodhemi, e lehtëson më shumë kultivimin e ndjenjës së durimit.

Kushti i parë i durimit është shfaqja në kohë e tij kur përballemi me situatat e rënda.

Shfaqja më e bukur e cilësisë "Sabur" (Durimtari) që i takon Allahut qendrën e ka tek peygamberët dhe njerëzit e devotshëm të fesë (evlija). Durimi, i përcjellë më pas prej peygamberëve dhe njerëzve të devotshëm të fesë (evlija) tek ne robërit e thjeshtë, një nga huqet e lavdëruara më të bukura në kohë bollëku dhe skamjeje, pra, është shumë i rëndësishëm.

Për të mundur të mbajmë agjërim në agorën e Allahut (xh.sh.) na kushtëzon që të

shijojmë nga vlerat shpirtërore që mbartin me vete “syfyri, teravia, dhikri, Kur’ani dhe lutja”.

Koha e iftarit është momenti delikat në të cilin pranohen lutjet. Për këtë arsye përjetimi i këtyre momenteve emocionale në grup është një burim tjetër mëshire dhe prehjeje shpirtërore. Pejgamberi Muhamed (a.s.) ka thënë:

Kush i shtron iftarin një të agjëruari, do të marrë nga shpërblimi hyjnor i agjërimit ashtu sikurse merr edhe agjëruesi.” (Tirmidhi)

Sahabet e varfër që e dëgjuan këtë sihariq iu drejtuan të Dërguarit të Allahut (a.s.) duke i thënë se ata nuk kanë mundësi ashtu sikurse të pasurit që t’u shtrojnë iftare të agjëruarve, profeti Muhamed (a.s.) tha:

Kush i mundëson personit të agjëruar që të bëj iftar duke i dhënë një hurmë apo një gllënjë ujë a qumësht, Allahu do t’i dhurojë atij të njëjtin sevap agjërimi.

Një tjetër delikatesë del në pah tek agjërimet vullnetare (nafile), sepse themeli i aktit të robërve të veçantë është besnikëria, e cila varet nga shkalla e sinqeritetit të nijetit dhe purifikimit të egos.

Allahut i takon vlerësimi i veprave të kryera. Më e mira nga jetët është koha e kaluar pranë Tij dhe e shpenzuar për hir të Tij. Teksa të tjerët e zbresin brenda varrit të tij njeriu do të hyjë aty vetëm me kujtimet e tij. Varrezat

janë vendet ku nuk do të hyjë brenda asgjë tjetër përveçse veprave të mira.

Një jetë e shkuar në kundërshtim me atë që dëshiron Allahu i përngjan mirazheve që përjetohen në shkretëtira. Të destinuara të jenë vegime të pafate nga e vërteta.

Raportimi profetik në të cilin thuhet se: “Kur besimtari të vdesë namazi do të rrijë në krye, sadakaja në të djathtë dhe agjërimi në krahator” është shembulli më i bukur që mund të japim për ato që sapo thamë.

Me shpresë në fisnikërinë e pafund të Allahut, le të përpiqemi që duke vepruar sipas asaj që na ka urdhëruar profeti Muhamed (a.s.) ne të mund ta ndiejmë më shumë vlerën e muajit të bekuar të Ramazanit, të kryejmë sa më shumë vepra që do të na shpërblehen me sevape dhe të parandalojmë më shumë veten nga mëkatet e mëdha dhe të vogla.

Në një hadith profetik thuhet:

“Po qe se njerëzit do ta dinin siç duhet rëndësinë e muajit të Ramazanit, do të kërkonin që i gjithë viti të qe Ramazan për ta”

Bekuar qofshin ditët që jetojmë, pranuar qoftë nga Allahu agjërimi i muajit të Ramazanit!..

Besimtarëve u takon e ardhmja...



Kush i shtron iftarin një të agjëruari, do të marrë nga shpërblimi hyjnor i agjërimit ashtu sikurse merr edhe agjëruesi.

Kush i mundëson personit të agjëruar që të bëj iftar duke i dhënë një hurmë apo një gllënjë ujë a qumësht, Allahu do t’i dhurojë atij të njëjtin sevap agjërimi.

Itikafi në muajin e Ramazanit

Rexhepi, Shabani dhe Ramazani... Një jetë fetare e cila plotësohet dhe shtohet me Regaibin, Miraxhin dhe Beratin. "Rexhepi është muaji i Allahut, Shabani i të dërguarit të Tij ndërsa Ramazani është muaji i ummetit". Myslimani, në këto muaj frytshmërie dhe dritëdhënës përgatitet për një atmosferë robërie. Ai nisët nga ajo ngarkesë e madhe ditore në shijimin e një kënaqësie sikurse në krijimin e tij të parë. Ekzistenca e njeriut fillon me shpirtin që është një qenie delikate. Njeriu, duke u mbështjell me atë që ne e quajmë "trup", merr përsipër funksionin e tij në këtë botë. Pasi shpërndan ngarkesën e tij, me adhurim brenda një kohe të caktuar, përpigjet që të arrijë në botën e qetë të Islamit.

Koha më e shpejtë e kësaj ngritjeje shpirtërore janë tre muajt, stina që mbështjell të gjithë myslihanët me freskinë e pranverës.

Besimtari që pasuron botën e tij të adhurimit me ardhjen e tre muajve dhe që përpigjet të mundësojë ngritjen shpirtërore me agjërime dhe me adhurime të tjera shtesë në dhjetë ditët e fundit të muajit të ramazanit, arrin në një përqendrim të plotë me halvetin apo atë që ne e quajmë itikaf apo qëndrim në vetmi. Tre muajt në një aspekt janë përgatitje dhe pastërti shpirtërore, janë ditë të ngritjes shpirtërore për në natën e Kadrit që është edhe nata e Kur'anit dhe që me gjuhën e Kur'anit njihet "më e dobishme se një mijë muaj"

Ashtu sikurse përgatitja e të dërguarit të Allahut i cili e fillon detyrën e tij të Pejgamberllëkut me Kur'an, që tërhiqet në shpellën Hira për të kuptuar dhe konceptuar shpalljen hyjnore edhe besimtarët në dhjetë ditët e fundit të ramazanit hyjnë në itikaf me shembullin e synetit të Tij dhe jetojnë përsëri freskinë e shpalljes së Kur'anit.

Itikaf do të thotë të ndodhesh për një kohë të caktuar në një xhami ku falet namazi i xhumasë me qëllim adhurimi. Ka tre lloje itikafi: vaxhip, synet dhe mustehap. Vaxhip është ai që bëhet me rrugën e adakut. Syneti është ai që bëhet në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit në xhami, ndërsa mustehap është të gjendesh në xhami në kohë të papërcaktuara me qëllim itikafi më shumë se sa koha që merr për të thënë subhanallah.

Çështja në të cilën ne do të ndalemi është itikafi i bërë në ramazan dhe që pejgamberi nuk e braktisi gjatë gjithë jetës së tij në Medinë deri sa edhe vdiq. Gjykimi juridik i realizimit të tij është syneti muekked me rrugë kifaje. Personi që do të hyjë në itikaf duhet të jetë me mendje të shëndoshë dhe i pastër,



itikafi duhet të bëhet në mesxhid dhe në një vend me ato kushte. Kurse gratë mund të futen në itikaf në një dhomë apo pjesë të shtëpisë së tyre të cilat ato e kanë vënë në kushtet e mesxhidit.

Realizimi i itikafit në mesxhid, në xhami të mëdha e shton edhe më shumë vlerën e tij. Haremi apo xhamia më e madhe e zonës është vendi më i përshtatshëm për këtë punë.

Ai që hyn në itikaf në një farë mënyre i ka ndërprerë lidhjet me botën e jashtme duke iu përkushtuar adhurimit, leximit të rregullt të Kur'anit, dhikrit dhe mendimit. Ai që ndodhet në itikaf qëndron larg fjalëve boshe. Ai qëndron i ulur me rroba të pastra dhe i lyer me erëra të mira, nuk i afrohet gruas së vet nga ihtilafi me gratë, nuk del jashtë mesxhidit pa patur një arsye të fortë si marrja e abdesit, pasi dalja jashtë mesxhidit e një personi pa patur një arsye të fortë e prish itikafin. Ai që hyn në itikaf sjell me vete rroba që nuk zënë shumë vend dhe aty ha, pi dhe fle.

Një person i dhënë pas itikafit që e fillon jetën e tij në mesxhid i ngjan atij që pret në derën e një njeriu të madh deri sa t'i plotësohet nevoja e tij dhe që e përsërit me insistim kërkesën e tij, ai gjen mundësi për të qëndruar larg çdo lloj mashtrimi apo zbukurimi ndikues. Ai gjen mundësi për t'i kthyer sytë zemrës së vet dhe për të dëgjuar zërin e zemrës dhe të shpirtit të tij. Ai gjen terren

që të drejtojë trupin e tij që zvogëlohet bashkë me agjërimin, shpirtin e tij të papërzier dhe të fshehtë të krijimit të vet.

Tashmë nevojat e tij për fëmijë, dëshirat dhe kërkesat e panumërta të epshit nuk e preokupojnë atë qoftë edhe për këto dhjetë ditë. Puna e tij është të kërkojë shpirtin e tij në shtëpinë e Allahut. Ai pi një nga një pikat e mëshirës që zbresin bashkë me

***Ai që hyn në itikaf
në një farë mënyre i
ka ndërprerë lidhjet
me botën e jashtme
duke iu përkushtuar
adhurimit, leximit të
rregullt të Kur'anit,
dhikrit dhe mendimit.***

***Ai që ndodhet në
itikaf qëndron larg
fjalëve boshe.***

Kadrin. Ai gjen mundësi që të arrijë kënaqësinë e të kup-tuarit të natës së Kadrit. Në kalanë shpirtërore në të cilën qëndron ai kërkon rrugët për t'u takuar sa më shpejt me vdekjen që afrohet duke bërë plane për të mos u bërë ushtar i shejtanit.

Në sajë të Halvetit të ramazanit që quhet edhe itikaf, zemra ndriçohet ndërsa mendjandalet. Nefsi frenohet në një masë të caktuar. Në fy-

tyrën e atij që qëndron në itikaf vihen re qartë shndritjet e robërisë dhe të adhurimit.

Itikafi është një halvet, pra të qëndruarit vetëm për vetëm me të dashurin. Është një takim vetëm me Të. Është një mall për Të. Dijetarët e Tasavvufit duke marrë për bazë itikafin e ramazanit me halvetin e Pejgamberit dhe takimin për katërdhjetë ditë të Hz. Musait me Zotin e tij, kanë zhvilluar disa parime edukative të quajtura erbain dhe çile. Halvetet e bëra edhe jashtë mesxhidit dhe që zgjasin katërdhjetë ditë, në fakt nga aspekti i formës i ngjajnë itikafit. Por që këtu bazë është që halveti të bëhet nën kontrollin e murshidit.

Padyshim, nuk është kërkuar që çdokush të hyjë në itikaf në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit. Prandaj edhe përcaktimi juridik i itikafit është syneti kifaje pra nëse në një zonë gjendet qoftë edhe një njeri që hynë në itikaf të tjerët nuk mbajnë përgjegjësi për moszbatimin e këtij syneti me begatinë e tij. Por arritja e njeriut në kënaqësinë e të qëndruarit vetëm me Zotin e tij qoftë edhe një herë të vetme në jetë me siguri është një shije e paharruar, një kënaqësi e pashpjegueshme, një kënaqësi dhe dëshirë që kuptohet duke e jetuar.

SHI

Për vite me radhë rrufita ujë të turbullt
Tue kërkue një shërim si ma i zoti i të gjithëve
Me mërzinë e një pelikani kam ecur bregdetesh
O shi sikur të isha edhe unë një gur që priste për ty.

Në mue për një çast pikoi mall i zjarhtë
Ndryshoi gjithçka
Në syrin tim u shkatërrua kasollja prej andrre
Qielli me krahët mëndafshi u dallgëzue
Tue fantazue ndriçimin e hanës
Në mes të shtëpive një flamur jeshil ngulet
E kupa e tokës asht e shkretë, e vetmueme e thatë

Koha nën kambët e mia shuhet hap pas hapi
Fantazëm në rrjetë ushtritë e andrrave
Ah sikur të isha edhe unë një zog shkretëtire, mbushë me mall për ty

Ah sikur t'ia numëroja ditët e vetmisë kalendarit të harrimit
Një zbatice të pajetuar jetova
Ah sikur të isha një qëndisje e vogël që ti preke...

Shi, në dëgjofsha zanin e qiejve të mi
Pasi ti bie edhe gurët çelin filiza krejt jeshilë
Vetëtimat copëtojnë gjoksin e fëlliqësirave
Stuhia shkon tue ia hekun papastërtinë errësinës.
Shi, sikur të shkëputesha nga lidhjet e marra të këtij shekulli
E të mund të mërrja pavdekësinë nga buzët tueja

Mbas dëshirave të qytetërimit
Lule të kalbuna të një pamjeje të mykun
U dhashë për pak
Por, ah sikur të isha një andërr e pame për ty...

Ndarja asht një plagë që rritet në zemër
Një zemër që s'të ndien ty- një burg pa derë.
Pa ty e drejta - e shtrembër, e bardha — e zezë.
Ai që zanin s'ta ndien, mbytet në vorbull...
e...sytë i hap...hutisë

Pas orëve e orëve kam kërkue vazhdimisht vedin,
në zingjirin e trishtimit m'u kapen
Ah sikur të isha edhe unë njëri nga ato që të panë

Pa ty, horizontet i kaploi agimi i rremë
Pa ty, ra mëmëdheu që shtrihej kontinentesh
Pa ty, kalldrëmeve u rrëzuan ca shpirtëra të pambuktë

Je si hana, diejt në sytë e tuej shëndrisin,
Të dashuruem mbas teje si të marrë shëtisin...

Çdo pikë e jotja qiejt zbukuron... shi.....

Ah sikur dorën time ta gjeja në të tanden
Bukuria në fytyrën time do të buzëqeshte...
Ah sikur edhe unë të përjetoja lumturinë e të arriturit ty

Ah sikur larg teje vetëm sa një hije
Ta shikoja fytyrën pafundësisht
Ah sikur të isha një shikim i përvuejtun për ty
Shi e humbëm të gjithë thesarin e gjyshërve

Ah sikur të isha...

Do të pikturoja shëmbjen e çdo kulle

Në rrugët dehëse që në dashuri të çojnë

Ah sikur një shkëndijë e jotja të isha, plejadë e një zjarri

Të kisha muejt me t'i krehë balluket që ujë jete burojnë

Me vite do të trazoja hirin e oxhakut tand

Ngandonjëherë isha një stuhi dashuruar mbas vetvetes

Para fortunave një gjeth i thamë

Ah sikur të isha flijim në rrugën e qëllimeve të nalta

Në rrugicat e këtij qyteti, vajtimet në heshtje m'u shndërruan

Dyshimet e mia ma brejnë krenarinë

Ah sikur të isha një pikë loti që rrjedh ngadalë ngadalë

Në ma të bardhen shtrojë një pikë gjaku ra

U thye shpata e drejtësisë, mburojat ranë

Të pandehurit gjykojnë, e gjykatësit të pandehur janë

Në themelin e të drejtave a thue se ra një vullkan

U shëmb tavani i dashurisë kurse muret u zhveshën krejt

Në ritmin e ditës revoltës zani i ndihet

Po vijnë rënkime nga lindja e perëndimi

Nga mungesa jote, marrëzia u bë mbret

Lagështia e syve të mi dashurues është për ty

Në mue përflaken trishtueshëm meloditë e ndarjes

Brumi i pashterrshëm i mendimit që s'shuhet, je ti

Vështrimi yt si një shigjetë shpon errësitat

Universet me ty përbluhen, harmonia je ti

U gropos emri im në një qytet trishtimi
M'u mbyllen para syve dyert e hapuna
Ah sikur të isha edhe unë një nga kurejshët muhaxhirë

O shi, sëmundjes sime ilaç ju bane
Në qendrën e trurit pasi ranë urdhëra të ligj
U fshi nga imagjinata e gjithë jeta jote e magjishme
Në çastin ma të epërm më ra pak mëshirë...

Me frymen tande do të vizatohen tabllotë e jetës
Do të ndryshohen të gjitha çehret e njerëzisë
Me driten tande do të ndriçohen bodrumet
Të gjitha nanat do t'i japin fëmijëve ujë nga ky shi.
Shi, me ty do shohin fundin thatësirat e universit
Ty të besojnë qiejt, nevojtarë për ty

SHI, AH SIKUR TE ISHA NJE GUR QE PRET PER TY
NE MESIN E SHKRETINES NJE ZOG I PERMALLUEM PER TY
NJË QENDISJE E VOGEL QE TI PREKE
NJË SHIKIM I ETUN, I HEDHUN DREJT TEJE
NJË LOT QË RRESHQET VRULLSHEM PER TY
NJË ANDERR E PAME PER TY
NE KUPEN E TOKES NJERI QE TE SHIKOI TY
NJË NGA KUREJSHET MUHAXHIRE...

Nurullah Genç

Njohja dyanëshe e islamit dhe e krishtërimit

Islami dhe krishterimi, si dy forma religjioze, kanë të njëjtin burim shpirtëror përgjithësisht të drejtuar në kuptimin e traditës primordiale ibrahimiane, gjatë shekujve dhe deri në ditët e sotme, gjithnjë dyanësisht takohen dhe gërshetohen në aspektin kulturor, qytetar, gjeografik, popullor etj. Për shkak të universalitetit historik dhe doktrinar që padyshim e rekomandon çdo njëri formacion religjioz i lartpërmendur, nxit, mban për vete dhe mohon religjionin tjetër. Takimi i islamit me krishterimin më tepër ka folur në formë, sa të hapur,

sa të kamufluar, përplasjen, mohimin dhe armiqësinë. Lufta e kryqëzatave, kolonializmi dhe anatemizimi i ngultë që krishterimi e ngriti kundër botës islame, janë vetëm pikat nyjore më të dukshme të asaj ngarkese negative me të cilën bota e krishterë ka rrezatuar drejt botës islame. Pastaj ka filluar koha teorike e larjes së hesapeve të krishtërimit me islamin. Në distancën kohore prej shek. XII-XV është shkruar një literaturë e tërë, thelbin e së cilës e kanë përbërë sulme paragjyquese dhe propagandistike ndaj personalitetit të Pejgamberit të islamit dhe autenticitetit të librit të shenjtë të myslimanëve, Kur'anit. Një pjesë e madhe e titujve të asaj literature është shkruar me një gjuhë jo të përshtatshme dhe me një stil të çoroditshëm që çdo pasues i ndershëm i asaj kohe, cilës do kulturë, religjion apo qytetërim t'i takojë, patjetër të thithë ndjenjën e turpits dhe të mërziës. Mbasandaj pason

cës (shek. XV-XVI). Fryma e kësaj kohe në masë të njëjtë dëshmon shfrenimin dhe armiqësinë e botës së krishterë ndaj botës islame. Personifikimin e gjallë të asaj armiqësie e hasim te personi kardinal Nikole nga Cuse (1401-1464) dhe në formën e veprës së tij *De pace fidei*, pastaj në personalitetin e Guillaume Postela dhe vepra e tij *De orbis terrae concordia* (1543) dhe të Jean Bodina. Me qëllim të mohimit sa më thellësisht të ekzistimit të islamit të botës së myslimanit, në atë kohë është bërë edhe përkthimi i parë i Kur'anit në latinisht nga ana e Ludavic Maraccit. Ndërkaq, kjo është koha që ka kaluar, le të jetë e falënderuar providenca e përhershme, dhe pastaj ka pasuar periudha e iluminizmit (shek. XVIII dhe XIX). Ajo është koha kur lind një lloj tjetër i literaturës diçka me një theks më të butë dhe më paqësor ndaj islamit dhe myslimanëve. Dëshmitar më i mirë i saj është vepra e konstit francez Boulainvilliers *Vie de Mahomet* (1730), në të cilën pejgamberi i islamit paraqitet në formën e një mendimtari të lirë, e një krijuesi të një religjioni natyror dhe të mençur. Në atë kohë, po ashtu francezi Du Ryer (1647) publikon përkthimin e parë frëngjisht të Kur'anit, kurse shkrimtari Sale në veprën e tij *Preliminary Discourse* (1743), ofron



interpretimin e parë objektiv për islam. Në shek. XIX vetë Napoloni, si pasues i filozofisë iluministe, shumë më tepër e ka manifestuar disponimin ndaj islamit, ashtu që në letrat e tij dërguar Kleberit, pejmamberin islam e quan: “*Pejgamberi ynë Mahomet*”. Por, e gjithë kjo nuk e ka penguar kishën katolike, që gjatë kohës së atij kolonializmi që do të vijë papritmas, të jetë bashkëvepruese me zell në invazion në botën islame.

Periudha e shek. XIX do të nxis një numër dijetarësh, historianësh dhe orientalistësh të krishterë, të cilët, dikush më shumë e dikush më pak, në mënyrë objektive do të prezantohen në sistemin e hulumtimit të shpirtit dhe religjionit islam. Mjafton të përmendet Buhl, Blacher, Watt, Rodinson, Miguel Asin Palacios, të cilët, në të vërtetë, në veprat e tyre shumë shpesh kanë krishterizuar ndonjë mysliman (el-Gazaliu, Ibni

Arabi). Sidomos, të përmendim orientalistin francez Louis Massignon, i cili, me një stil të veçantë, me punën e tij voluminoze letrare dhe me një qetësi krejtësisht të re, ia ka zbuluar botën islame Evropës.

M e g j i t h a t ë , kthesa themeltare në marrëdhëniet mes islamit dhe krishterimit do të ndodhë me thirrjen e Koncilit të Dytë në Vatikan (1962-1964). Me

këtë ngjarje në masë të mirë nivelohet rruga, sidomos kur është fjala për marrjen e një qëndrimi më të volitshëm të kishës katolike ndaj islamit, për veprat dhe idetë e J. Monachin, J. Ledith, Y. Moubarrac, Masson Denis, Jacques Jamier, Michel Hayek, J. M. Abdeljalil, Luis Gardet, Michel Lelong etj. Me Koncilin e Dytë të Vatikanit kisha katolike ka pushuar me shqiptimin anatemic ndaj islamit dhe myslimanëve, kurse autorët e krishterë, kryesisht, kanë filluar të shkruajnë vepra për islam në dritën (frymën) e fjalëve të atij koncili: “Kisha i shikon me respekt edhe myslimanët, të cilët i luten një Zoti të vetëm, të gjallë dhe subzistent, të mëshirshëm dhe të gjithëfuqishëm, krijues i qiejve dhe i tokës, i cili i është folur njerëzimit”.⁹ Ata, madje, mundohen të nxisin shpresën në



ardhjen papritmas të ekumenizmit në botë ku stimulojnë fjalët e Koncilit të Dytë të Vatikanit: “Meqenëse, gjatë shekujve mes të krishterëve dhe myslimanëve ka ardhur deri te përleshja dhe armiqësia, Këshilli i Shenjtë bën thirrje që të gjithë, duke harruar atë çka ka ndodhur, singërisht të mundohen për të kuptuarit mes tyre dhe që bashkërisht të mbrojnë dhe të nxisin drejtësi sociale, mirësi morale dhe liri për të gjithë njerëzit”.

Myslimanët, sigurisht, nuk do të mund të harrojnë të gjithë armiqësinë dhe padrejtësinë që u është bërë dhe që sot e kësaj dite bëhet, por do të mundohet t’ua falin si shenjë e qëllimit të mirë dhe nxitjes fillestare për takim ekumenik të ri, frytdhënës, efikas, barazi për të gjithë popujt, kulturat, religjionet dhe traditat religjioze, sidomos për atë krishtere

Myslimanët, sigurisht, nuk do të mund të harrojnë të gjithë armiqësinë dhe padrejtësinë që u është bërë dhe që sot e kësaj dite bëhet, por do të mundohet t’ua falin si shenjë e qëllimit të mirë dhe nxitjes fillestare për takim ekumenik të ri, frytdhënës, efikas, barazi për të gjithë popujt, kulturat, religjionet dhe traditat religjioze, sidomos për atë krishtere

⁹ Nostra aetate, Concilio oecumenique Vatican II, p. 696.


nuk mund të jetë për derisa paraprakisht nuk plotësohet kushti themelor për një takim të llojit të tillë, kurse ai pasqyrohet pashmangshmërisht në barazinë e përfaqësuesve të këtyre dy traditave religjioze tek bisedat dhe takimet ndërreligjioze të tyre. Ajo barazi e plotë në aspektin doktrinar, është shumë vështirë që ndonjëherë të arrihet, pasi krishterimi nuk mundet që ta pranojë islamin si një religjion të shpallur, pejgamberin islam si një lajmëtar të vërtetë të Fjalës së Zotit dhe Kur'anin si libër të Shenjtë dhe autentik të zbritur nga qielli, e paraprakisht të mos e prish *raison d'être*-n personale. Mu për këtë dialogu ndërreligjioz tridhjetëvjeçar i të krishterëve dhe i myslimanëve në rrafshin e doktrinës themelore, ka diriguar në kotësi. Përveç njohjes më të thellë të dallimeve mes

Aspak ngushëlluese nuk ndikojnë fjalët e peshkopëve vendas të cilët i kanë larë duart nga, siç thonë ata, "krishterimzi i keq" i kryqtarëve dhe i fashistëve të tërbuar, të cilët kanë vrarë myslimanë vetëm pse kanë qenë myslimanë. Aq më tepër, myslimanët e Bosnjës, asnjëherë nuk do të munden t'ua falin fuqive më të mëdha të Evropës Perëndimore, qeveritë e të cilave qëllimisht dhe me vetëdije ua kanë lidhur duart boshnjakëve dhe vetëdijësisht i kanë bërë ata shqerra për therje

tyre dhe mosmposhtjes në besim, pjesëmarrësit në takimin në fjalë të dialogut ndërreligjioz asgjë tjetër nuk kanë arritur.

Megjithatë, për islamin nuk është aspak me rëndësi që krishterimi do ta dëshmojë vërtetësinë dhe universalizmit e tij. Por, gjithsesi, është me rëndësi, që krishterimi t'ua njoh myslimanëve vendin e tyre nën kupë të qiellit, ashtu që t'i trajtojë si popull i Zotit, gjeni fizik i të cilit sot vërshon shifrën prej mbi një miliardë të popullatës së përgjithshme botërore. Nuk është mirë që krishterimi edhe në të ardhmen, i udhëhequr nga ideja themelore biblike e periodizimit historik në qartësimin e vargjeve të Palit nga Ef 1, 9, t'i injorojë myslimanët sikur Zoti i dashur atyre nuk u ka dhënë të drejtë edhe të jetojnë në hartën e botës, dhe, sidomos, t'i përzër nga Evropa. Unë patjetër kam të drejtë të them, për fat të keq, se tragjedinë në Bosnjë (Kosovë-përkthyesi) dhe therjen që e kanë bërë mbi ta pasardhësit e qytetërimit të krishterë, në fakt vetveten e tyre ata e kanë komentuar në kuptimin e realizimit të asaj ideje të apostullit Pal për të a.q. paneklesianizëm dhe pankristocentrizëm. Dyqind mijë boshnjakë myslimanë të rraskapitur kanë vdekur nën frikën e krikëllimave të granatave në të cilën fishkëllimë çdo njëri ka dëgjuar vetëm ushtimën e vargjeve të lartpërmendura të Palit nga Përfaqësuesi i efesianëve (1, 9). Aspak ngushëlluese nuk ndikojnë fjalët e peshkopëve vendas të cilët

i kanë larë duart nga, siç thonë ata, "krishterimzi i keq" i kryqtarëve dhe i fashistëve të tërbuar, të cilët kanë vrarë myslimanë vetëm pse kanë qenë myslimanë. Aq më tepër, myslimanët e Bosnjës, asnjëherë nuk do të munden t'ua falin fuqive më të mëdha të Evropës Perëndimore, qeveritë e të cilave qëllimisht dhe me vetëdije ua kanë lidhur duart boshnjakëve dhe vetëdijësisht i kanë bërë ata shqerra për therje. Pasi që atyre gjatë agresionit të përgjakur u janë



ndërprerë të gjitha të drejtat elementare njerëzore, me të cilat Evropa krenohet dhe e cila ka menduar vetëm për veten e saj dhe për simpatizuesit e qytetërimit të krishterë, myslimanët boshnjakë njëjtë sikur të gjithë myslimanët e botës, nuk do të munden aq lehtë të besojnë në fjalët e Koncilit të Dytë të Vatikanit për nxitjen e "drejtësisë sociale, mirësisë morale dhe lirisë për të gjithë njerëzit". Të njëjtën në fakt e kërkojnë të gjithë myslimanët kudo në botë, kurse për au-

toritetin e tyre religjioz dhe shpirtëror, do të kujdeset vet Zoti. Ata për këtë nuk kërkojnë mbështetjen e asnjë autoriteti apo institucioni botëror.

Por, që të eliminohet qëndrimi për standarde të dyfishta kur është në pyetje realizimi dhe vënia në praktikë e të drejtës së njeriut brenda qytetërimit të krishterë dhe atij jo të krishterë, do të ishte e domosdoshme që qytetërimi i krishterë në rindërtimin e lidhjeve të mira me të tje-



rët, sidomos me qytetërimin islam, resurset natyrore të të cilit janë resurse të botë së mbetur, duhet që definitivisht të largohet nga dy ide të cilat deri më tash kanë qenë mirë të orkestruara në vënien në praktikë të strategjisë globale në botë, e që është ideja për paneklesianizmin që e nxit Augustini me veprën e tij *Civitas Dei*, dhe ideja për evrocentrizmin të cilën e stimulon shoqëria sekulariste e Evropës, e cila pretendon të masë për të gjitha gjërat në shtëpi dhe në botë. Kisha atë luftë

patjetër don ta shpie kundër dy ideve të lartpërmendura, për ndryshe të gjitha ato rreziqet tragjike të saj, në fund, do t'i dërmoheshin në kokë vet asaj. Para se ideja e paneklesianizmit nuk bëhet serioze e shpërndarë nëpër hapësirën gjeografike, ajo bëhet serioze në hapësirën e zemrës së njeriut me fuqinë e paparashikueshme të mëshirës së Zotit. Vënia në praktikë e idesë në fjalë me fuqi, gjithmonë do të përfundonte në kryqëzatë dhe në inkuizicion, e ajo është bumerang që rregullisht kthehet në fytyrë. E njëjta vlen edhe për idenë e evrocentrizmit. Në vend të procesit të bukur të akulturizmit dhe inkulturizimit nëpërmjet së cilës duhet stimuluar ideja në fjalë, ngarkimi i evrocentrizmit me fuqinë e ushtrisë, ekonomisë, politikës dhe të strategjisë luftarake gjithmonë përfundon në fashizëm, kurse kjo sipas natyrës gjithmonë bën vdekje në gjakun e vet personal. Duket se qytetërimi i krishterë sa më parë duhet të pastrojë punën me ato dy idetë e lartpërmendura, nëse do të kihet parasysh fakti se prej atyre dyjave në tokën e sotme të Evropës i është prerë koka me sharrë fantazmës dykrerëshe në kuptim të modernizmit dhe të sekularizmit, e cila, në makutërinë dhe pangopurinë e saj, përfundimisht, në fillim vetëm kishës mund t'ia shkëput kokën, meqenëse analizat themelore tregojnë se si në gjenet e fantazmës së përmendur në masë të madhe e pulsojnë gjenin ende të pavdekur të shpirtit pagan evropian, se sa që e qarkullojnë gjenin e gjakut të Krishtit.

***Shpirti pagan i Evropës,
i cili, i armatosur me
shkencën pa zot, me
teknikën pa shpirt
dhe me moralin
indiferent, mbjell
frikën e shkatërrimit
dhe humbjes së
gjithmbarshme
të rezervave të
grumbulluara me anë
të armëve më vrasëse,
të mjaftueshme që
vetëm për momentin të
shkatërrojë disa herë
planetin Tokë, shtëpinë
botërore të qytetërimit
njerëzor.***

Konstatimi i lartpërmendur edhe më tepër fiton rëndësi kur kemi në mendje prognozën futuriste aktuale për ardhjen e përleshjeve të përgjakshme që do të ndodhin në shek. XXI, të cilat do të lëvizin tegelin qytetërues, siç shkruan sociologu dhe analitiku-futurist amerikan, Samuel P. Huntington.¹⁰ Edhe pse bota e krishterë dhe bota islame sot janë të përcaktuara mirë me kulturën dhe qytetërimin personal në themel të dallueshëm, shtëpia e tyre e përbashkët shpirtërore, e njohur në gjeninë semite primordiale ose në trashëgiminë e përbashkët primordiale ibrahimiane, duhet të luaj rol vendimtar në afrimin dialogjik dhe në takimin ekume-

10 The Changing Security Environment and American National Interests, Foreign Affairs, volume 72, no 3, summer 1983.

nik të tyre, dhe nuk guxon të jetë i ndarjes dhe i largimit të tyre. Pasi, sa do që të jetë i thelluar hendeku mes myslimanëve dhe të krishterëve, po aq, në anën tjetër, do të forcohen lidhjet mes myslimanëve dhe qytetërimit taoistik-konfuçian, ashtu si e vëren profesori Huntington, e cila do të jetë komponentë shumë e rëndësishme në paraqitjen e konfrontimeve mes qytetërimeve në shekullin e ardhshëm. Prandaj, nuk do të jetë e rëndësishme që vetëm të nxitet dialogu ndërreligjioz dhe ekumenizmi ndërkishitar, për t'i ikur përplasjes së qytetërimeve dhe përplasjes ndërreligjioze, por do të jetë e domosdoshme, gjithashtu, ndërgjegjshëm të nxitet *religio perennis*, brenda së cilës çdo formë tradicionale religjioze të mund të njoh origjinalitetin e vet, burimin e përbashkët metafizik të të gjithë atyre, prej të cilit ka kaluar urtësia hyjnore universale e shkapër-

derdhur në konsideratën e tyre personale me anë të traditave të ndryshme religjioze.

Nxitja e plotë e *religio perennis*-it mund të arrihet në masë të madhe për derisa në të janë pjesëmarrës pjesëtarë të të gjitha religjioneve në atë që bota moderne e quan demokraci, e drejtë e njeriut, e drejtë sociale, mirësi dhe liri morale për të gjithë njerëzit. Nuk bëhet një gjë e tillë, për derisa zelli dhe orvatja për çdo lloj ekumenizmi me shumicë do t'i ngjante stenës guximtare të Sizifit jo të suksesshëm në majë të malit. Ndërsa brenda asaj kohe, bota do të gjuajë drejt kulturës, religjionit, qytetërimit, ideologjisë, politikës dhe tegelit nacional të tyre dhe do të përgatit terrenin për mbretërinë Antikrisht, të cilën sot shumë qartë e thërret shpirti pagan i Evropës, i cili, i armatosur me shkencën pa zot, me teknikën pa shpirt dhe me moralin indiferent, mbjell

frikën e shkatërrimit dhe humbjes së gjithmbarshme të rezervave të grumbulluara me anë të armëve më vrasëse, të mjaftueshme që vetëm për momentin të shkatërrojë disa herë planetin Tokë, shtëpinë botërore të qytetërimit njerëzor. Nëse tash i japim shans asaj mbretërie të dhimbshme, shijen e së cilës e ndjejmë edhe nëpërmjet të realizmit të së drejtës së njeriut në mënyrë jo të barabartë, sidomos në kontest të marrëdhënieve mes krishterëve dhe myslimanëve në tokën e Evropës Juglindore, atëherë nuk do të ishte me rëndësi kush dhe i kujt apostull është, kush e për cilën shkencë dogmatike kujdeset dhe çfarë shprese eskatologjike paraqet. Dhe grindja jo logjike, sidomos, mes njeriut të qytetërimit të krishterë dhe njeriut të qytetërimit islam, do të humbë çdo kuptim dhe qëllim.



Mirësitë e Kurbanit

Njeriu të cilin Allahu i Lartë e ka nderuar me cilësinë e "Të dërguarit të Vet" në sipërfaqen e tokës, është shpërblyer duke u pranuar si: "Thirrës i shpalljes hyjnore". Pikërisht për këtë për të udhëzuar njerëzit në rrugë të drejtë janë dërguar pejgamberë dhe libra. "Rruga më e drejtë" u është treguar atyre. Forma më e mrekullueshme dhe më e fundit e këtij zinxhiri udhëzimi e ardhur që nga njeriu dhe pejgamberi i parë e deri në ditët tona, padyshim që është Islami. Dhe kjo është në të gjitha principet e Islamit... Këtë e shohim edhe në prerjen e kurbanit.

-Ç' është kurban, pse pritet?

-Çfarë kërkohet të na shpjegohet me anë të ngjarjes së Hz. Ibrahimit që është edhe fillimi i kurbanit?

-Të përpiqemi t'u japim përgjigje pyetjeve.

Ndërkohë që të ndash mishin e kurbanit në tre pjesë dhe të japësh dy të tretat është synet. Pse është vaxhip të lësh të rrjedhë gjaku?

Kafsha që blihet me para hallall që myslimani ka i fituar dhe që pritet në emër të Allahut dhe për hir të Tij në ditë të caktuara, është kurban.

Disa nga mirësitë që qëndrojnë në thelb të kësaj çështjeje dhe dobitë që rrjedhin prej saj.

Është shumë kuptimplotë dhe me rëndësi të madhe sakrifica e Hz. Ibrahimit për të bërë kurban të birin e tij duke iu bindur urdhrit hyjnor. Kjo përbën bazën e çështjes së kurbanit, pasi fëmija është pjesë e prindit. Është vazhdim i qenieve materiale edhe i atyre shpirtërore. Pra, fëmija duke i mbledhur në vetvete të gjitha sakrificat e prindërve të tij, është bërë si një pjesë e pandarë e tyre. Për këtë arsye marrja e iniciativës për të bërë kurban të birin e tij, Ismailin, si një urdhër hyjnor, është një madhështi për të arritur për të këputur frytin më të mirë dhe pjesën më të vlefshme të jetës. Dhe kjo ngjarje ka qenë e mjaftueshme që babai dhe biri të bëhen shembuj të pashoq të durimit dhe të sakrificës për të bërë atë që u është urdhëruar.

Në ajetin Kur'anor që e transmeton këtë, Allahu i Lartë urdhëron e thotë: Në atë kohë që kur erdhi në moshën e pjekurisë atij i tha: "Biri im, ty të shoh në ëndrrën time se jam duke të bërë kurban. Tash më shih, si thua? (fëmija i tha): "Baba i dashur, si të jetë urdhëruar, ashtu vepro. Shpresoj me ndihmë të Zotit se unë do të jem prej të dureshmëve"¹¹

Ja pra kurban i vërshon nga një burim dashurie hyjnore dhe nga një ngjarje kaq madhore. Me begatinë e kësaj

dashurie ai u paraqet të gjithë besimtarëve të mirën, dashurinë dhe begatinë.

Kuptimi i mënyrës së prerjes së bagëtive për kurban

Prerja e kurbanit të blerë me para është si një pjesë nga jeta e njeriut. Kjo është si të pranosh të presësh fëmijën tënd që tashmë është si një pjesë e jotja pasi ke dhënë shumë për të. Ja pra, edhe kurbanin ynë pikërisht në këtë aspekt ka ngjashmëri me çështjen e Hz. Ibrahimit.

Edhe Hz. Ibrahim është nxitur nga dashuria për Allahun. Kjo vazhdon edhe tek ne si një edukatë drejt dashurisë hyjnore. Këtu iniciativa e Hz. Ibrahimit për të bërë kurban të birin dhe përpjekjet tona për të bërë kurban një dele e ka ndarë në shkallë dashurinë që kemi ne botës materiale. Ne përpiqemi që ta meritojmë dashurinë hyjnore të cilën Hz. Ibrahim e kishte merituar plotësisht duke sakrifikuar dashurinë tonë nga shkalla e parë dhe e dytë që janë paraja dhe malli. Kjo tregon që çdo lloj dashurie me mundime dhe sakrifica është e mundur të kthehet në dashuri hyjnore ideale.

Allahu nuk ka nevojë as për mishin dhe as për gjakun e kurbanit. Këta nuk kanë asnjë vlerë përpara dashurisë që kemi ne ndaj Tij.

Allahu i Lartë nëpërmjet ngjarjes së Hz. Ibrahimit na



kujton se: dashuria hyjnore është mbi çdo dashuri tjetër, të gjitha ato “dashuri kryesore” burojnë nga dashuria hyjnore, askush në asnjë mënyrë nuk do të pësojë ndonjë dëm nga kjo dashuri, kjo dashuri do të sjellë vetëm mirësi dhe dhembshuri dhe do të jetë shpëtimtare.

Qenia synet e shpërndarjes së mishit të kurbanit, qenia vaxhip e derdhjes së gjakut, qenia e dobishme e prerjes vetë të kurbanit, domosdoshmëria për të qëndruar në krye nëse s’mundesh vetë apo nëse je grua... Dhe vijueshmëria e kësaj etike çdo vit në mënyrë të rregullt u mëson myslimanëve se duhet të jetojnë si njerëz si në luftë ashtu edhe në paqe.

Allahu i Lartë në këtë ajet Kur’anor e thekson hapur se tek njeriu ekziston ajo ndjenja e brendshme për të derdhur gjak.

“(Përkujto o Muhammed) kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë po përcaktoj në tokë një zëvendës”! Ata thanë: “A do të vesh në të atë që bënë çrregullime dhe që derdh gjaket, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë”! Ai tha: “Unë

di atë që ju nuk e dini”!”¹²

Këtu mund të nxjerrim këto përfundime:

1- Derdhja e gjakut është në natyrën e njeriut.

2- Allahu i Lartë u ka thënë melekëve se këtë ndjenjë tek robërit besimtarë do ta kurojë me ilaçin e kurbanit në mënyrën më të bukur.

3- Popujt që nuk presin kurban do ta shijojnë këtë ndjesi me rrugë jo të lejuara duke derdhur gjak të tepërt në luftë, në paqe dhe në dëfrime.

Kurbani i afron myslimanët drejt Allahut. Edhe Allahu u afron atyre mirësi të shumta që vijnë nga kurbanit. Kështu që myslimani fiton cilësinë: “njeri i formuar dhe i pjekur që u jep vlerë të gjithë njerëzve pasi janë njerëz dhe ka mëshirë për të gjitha qeniet”

Në hadith thuhet: Allahu çdo gjë dhe çdo sjellje të mirë e shkruan për të mirë. Prandaj kur ta merrni hakun si zbatues ta merrni në mënyrën më të mirë të mundshme. Dhe kur të pritni një kafshë ta prisni sa më mirë. Mërrini thikën tuaj. Qetësojeni kafshën që do

të prisni”¹³

Nga këtu kuptojmë që në prerjen e kurbanit nuk është qëllimi të shpërndash mishin por të derdhësh gjak. Dhe “ta derdhësh gjakun në mënyrën më të mirë të mundshme” Kjo do të thotë ta kurosh këtë ndjenjë ekzistuese tek njeriu në mënyrë që të ketë dobi për njerëzit. Do të thotë të presësh që shërbimi të kthehet në një dashuri për njerëzit. Të kër-kosh rrugët për të arritur në dashurinë hyjnore me sakrificat e dashurive të vogla.

Detyrat që do të bëjmë me gjuhë në adhurime të tilla janë të kufizuara. Përbëhen nga tekbire dhe besmele. Kurse punët që do të bëjmë me trup përfshijnë një pjesë të kohës që zgjat me ditë të tëra, si: të fitosh para, të blesh kurbanin, ta sjellësh, ta shohësh, ta presësh, të ndash mishin. Me këtë feja jonë na ka këshilluar të jemi fjalë pak, të jemi thelbësor dhe për punë të dobishme.

Qetësia dhe begatia e pa-fundme që vjen nga kurbanit zgjat plot një vit. Dhe çdo vit ky lloj adhurimi përsëritet me shpresën dhe besimin e shen-jës më të mirë të dorëzimit. Kështu që myslimanët bëhen dëshmitarë vetë të të vërtetës: “E vërteta e vdekjes dhe kthimi i perkasin vetëm Atij”

Disa këshilla për ruajtjen e përmirësimin e kujtesës

Me këtë material dëshirojmë t'ju ndihmojmë ju nxënës në punën tuaj studimore. Mos nënvleftësoni aftësitë reale të kujtesës suaj, por përpikuni ta ktheni atë në një instrument efikas duke praktikuar këto metoda dhe ushtrime që do të paraqesim për shfrytëzimin optimal dhe për forcimin e kujtesës suaj.

-Një nga mënyrat më të mira për të përmirësuar kujtesën është të kujdesemi për gjendjen e përgjithshme fizike dhe mendore të organizmit, një shëndet i dobët, lodhja e tepërt, ushqimi i keq, stresi, abuzimi me alkoolin, duhani, drogat etj. cenojnë aftësitë e kujtesës. Një nga elementët më të domosdoshëm që duhet të përmbajë ushqimi për funksionimin e kujtesës, është kaliumi. Mungesa e tij rrit nervozizmin, sjell pagjumësi dhe rënie të kapacitetit të kujtesës. Ndër ushqimet më të pasura me kalium janë qumështi, djathi, veza (e verdha e saj), mishi, kokrrat e grurit, arra, lajthia. I domosdoshëm për kujtesën është gjithashtu magnezi. Ushqimet më të pasura me magnezium janë buka, perimet e gjelbra, frutat vajore e sidomos çokollata, që stimulon një aktivitet intelektual intensiv. Gjithashtu proteinat, karbohidratet, vitamina B1(buka, drithërat, pe-

rimet, frutat, peshku, mishi), vlerësohen si thelbësore në proceset kimike që ndodhin në atë pjesë të trurit ku ndodhen qendrat e kujtesës. Të pish një limonadë me sheqer ndihmon në punën e kujtesës. Kush merret me sport është më mirë me shëndet sesa të tjerët. Ushtrimi fizik e mban në formë sistemin e qarkullimit të gjakut, pakëson stresin, ju çliron nga depresioni, ju përmirëson tretjen dhe fjetjen, pra ju sjell në një gjendje optimale edhe për funksionimin e kujtesës. Produktet ushqimore që sjellin pengesë në funksionimin e mirë të kujtesës janë ato që përmbajnë shumë acide, apo janë shumë alkaline: mishi me dhjamë, sheqeri, lëngjet acide (uthulla e disa pije), frutat acide, perimet acide (patëllxhani). Përdorimi i tepërt i patateve sjell moshë të tretjes së kalciumit, pra është gjithashtu i dëmshëm për kujtesën. Gjithashtu s'këshillohet ngrënia e një sasive të madhe ushqimesh përpara ndonjë veprimtarie ku nevojitet përdorimi i kujtesës. Sa më shumë që zgjat tretja, aq më shumë bie vëmendja. Duhani e alkooli janë armiq të kujtesës. Alkooli shkatërron veshjet trunore, ai dëmton procesin e thithjes së informacionit, që nuk arrin në kujtesën afatgjatë. Kur qelizat e trurit shkatërrohen, edhe mjaft kujtime

humbin bashkë me to. Edhe lodhja është armik i kujtesës, por organizmi ynë ka një mjet paralajmërues e mënjatues të saj: gjumin. Gjumi jep sinjalin e sigurt që trupi ynë është lodhur dhe ka nevojë për pushim. Lodhja s'bën tjetër veçse acaron Sistemin Nervor e lejon të marrësh veç mbresa të turbullta, të dobëta. Vlen më shumë një orë mësimi e zhvilluar në kushte fizike, morale, intelektuale të mira se një ditë pune e zvarritur me një ndjenjë mërzie e lodhje. Ndërsa higjiena mendore lidhet drejtpërdrejtë me punën e trurit, duke pasur synim furnizimin e mjaftueshëm me gjak të tij, me oksigjen, gjumin e mjaftueshëm etj. Humori i keq e pengon kujtesën, sepse kur jeni pa humor, të nxehur vëmendja bie. Depresioni ndikon në proceset kimike të trurit, duke ngadalësuar thithjen e informacionit. Kush jeton me stres është më i gatshëm për harresë, p.sh. ankthi para provimit mund ta dëmtojë kujtesën tuaj.

-Çasti më i rëndësishëm në funksionimin e sistemit të kujtesës është vëmendja. Aftësia për të përqendruar vëmendjen mbi një objekt për aq kohë sa është e nevojshme për studimin e tij, lejon të kapet thelbësorja dhe të lihen mënjatë detajet e parëndësi-

shme. Shpërndarja e ideve, idetë “parazite” që shpërqendrojnë vëmendjen, janë të tilla që s’lejojnë fiksimin e mjaft detajeve të objektit dhe në disa raste madje as identifikimin e tij. Pra, nëse e rrisim vëmendjen tonë do të rrisim efikasitetin e kujtesës sonë.

-Një nga mjetet më të mira të ruajtjes së materialit në kujtesë i njohur ndoshta nga përvoja e shumëkujt, është transmetimi i tij nëpërmjet riformulimit me fjalët e veta, p.sh. të lexosh një libër apo të shohësh një film dhe të flasësh për të, t’i tregosh fëmijës një përrallë apo një ngjarje dhe t’i kërkesht pastaj ta riprodhojë, kjo d.m.th. të përdorësh transfertin e informacionit që do të “maganizosh” në kujtesë, domethënë ta transformosh e përpunosh atë, sjell një ruajtje më të mirë.

-Një metodë tjetër është mbajtja e shënimeve. Kjo lehtëson ngarkesën e madhe që duhet të përballojë kujtesa e njeriut. Me këtë mjet transferit, ai seleksionon materialin, merr prej tij më të vlefshmin,

thelbësorin dhe e transformon me fjalët e veta, me fjalët më të përdorshme e me të cilat është familjarizuar. Kështu për të mësuar një tekst duhet ta lexoni në fillim me vëmendje, të gjithë mësimin, për të realizuar një njohje të parë, një familjarizim qoftë edhe pa e kuptuar atë në të gjitha pikat e paragrafëve. Pas një periudhe të shkurtër pushimi, rilexoni dhe do të vini re se një pjesë e mirë e koncepteve që në fillim ju dukeshin konfuze e të pakuptueshme, do të qartësohen. Ky lloj procesi është përgatitor për procesin e mëvonshëm të analizës e të arsyetimit që do të sigurojë përvetësimin e informacionit. Pas një periudhe pushimi bëni një rilexim tjetër, ku duhet të kuptoni gjithçka, këtu mbani edhe shënime, sepse mbajtja e shënimeve forcon përqendrimin, ju detyron të organizoni informacionin. Tani mund ta shikoni “fluturimthi”, pa e lexuar të gjithë materialin. Pastaj pas disa ditësh kur është rasti për të gjithë librin, rishikoni shënimet për çdo kapitull dhe riprodhoni lëndën.

Ushtrime

Ky ushtrim për stërvitjen e kujtesës, përfshin një periudhë prej një muaji. Ky muaj gjimnastike intelektuale do t’ju shërbejë të rizgjoni e të fuqizoni energjitë e fshehura të kujtesës suaj e ta bëjë të aftë për t’u zhvilluar e për një përsosje të mëtejshme të saj. Nuk duhet të nxitoni, mos e humbisni durimin. Mos harroni se ngritjet e mëdha bëhen me hapa të ngadaltë, të matur, të qëndrueshëm. Këtë muaj e ndajmë në tre periudha, nga 10 ditë secila.

Periudha e parë – Zgjidhni një poemë, apo një libër, një vepër çfarëdo në fund të fundit, që ju intereson. Ditën e parë mësoni përmendësh një strofë apo një fjali që të mos i kalojë 4 vargje a rreshta. Por mësoni vërtet mirë e hyni me zell thellë në kuptimin e tyre, që ju të mund t’i përsëritni pa sforcim e t’i kuptoni me qartësi e thellësi. Përpikuni, të fiksoni në kokë pjesën e shtypur, në aspektin e saj grafik. Përsëritni me gojë këto katër vargje, rreshta në mbrëmje,



para se të flini. Ajo që ngulitet në kujtesë para se t'ju zërë gjumi, mund ta kujtoni me lehtësi në momentin e zgjimit. Ditën e dytë, përsëritni me zë të lartë strofën apo fjalinë e mësuar tashmë, e mësoni në të njëjtën mënyrë e me të njëjtin zell, edhe katër rreshta të tjerë. Bashkujini me të parat, i përsëritni të gjitha derisa ta ndjeni se i keni përvetësuar plotësisht. Ditën e tretë, mësoni edhe katër rreshta të tjerë, bashkujini me ato që keni mësuar ditët e mëparshme e recitoheni tërë pjesën, derisa të vini re se i përsëritni pa gabime e pa ngurrime. E kështu edhe në ditët e mëpasshme. Në të dhjetën, përveç dobisë që keni mësuar përmendësh 40 rreshta të një libri të rëndësishëm, do të keni arritur një rezultat tjetër shumë të konsiderueshëm: atë që keni shkathtësuar kujtesën e i keni dhënë një farë elasticiteti. Përsëritni shumë herë në ditë tekstin e mësuar. Është pikërisht ripërsëritja që e fuqizon kujtesën. Duke përsëritur atë që dini ju stërviteni për të kujtuar. Përfiton çdo moment të lirë të ditës, për të përsëritur pjesën e mësuar. Duke e këmbyer këtë ushtrim mendor me shqetësimet e zakonshme, do t'i jepni kujtesës një cilësi tjetër: gatishmërinë. Mos e lini ushtrimin as edhe për një ditë. Është shumë më mirë të mësoni 4 rreshta në ditë se 8 rreshta një herë në 2 ditë, apo 12 çdo tre ditë. Rregullsia është e domosdoshme.

Periodha e dytë – në këtë pikë kujtesa juaj do të jetë mëdoemos e forcuar e do të jetë e përshtatshme të kryhet një përpjekje më e madhe. Do të



dyfishosh materialin, pra do të mësoni 8 rreshta, që do t'i bashkoni me të 40 e mësuara tashmë. Ky fakt do të rris vullnetin dhe besimin në vetvete. Recitoje me zë të lartë, e mos e leni pas dore për ta thënë edhe një herë para se të flesh. Kështu vazhdoni 10 ditë, e do të jini në gjendje të përsëritni pa ngurrim e pa gabime 120 rreshta të një vëllimi.

Periodha e tretë – Tani duhet të mësoni 12 rreshta në ditë, mos kini frikë, ju mund ta arrini këtë. Në fund të stërvitjes mund të recitoni 240 rreshta të vëllimit të zgjedhur. Por rezultati i stërvitjes s'qëndron në këto 240 rreshta mësuar përmendësh. Rezultati i vërtetë, i mrekullueshëm qëndron në zhvillimin dhe në fuqizimin që kujtesa juaj do të ketë arritur gjatë këtyre 3 periudhave me gjimnastikë të përditshme, e intensive. Ju vetë do të jeni të habitur e do të vëreni me gëzim sa e lehtë është të marrësh nga vetvetja disa të ashtuquajtura "mrekulli". Kujtesa është një aftësi që kërkon ushtrime të vazhdueshme përndryshe vyshket, kështu përsëriteni atë që keni mësuar gjatë këtij muaji stërvitje.

-Një ushtrim tjetër elementar që mund ta kryeni duke ndenjur në tavolinë. Merrni një libër të mbyllur. Shqyrtojeni për 3 minuta kopërtinën e tij. Vëreni: dimensionet, në gjatësi e gjerësi, ngjyrën, cilësinë, titullin, format e germave, treguesit shtesë (shtypshkronjën, datën e botimit) etj. Me një fjalë përpikuni "të fotografoni" në ekranin e trurit tuaj komplet kapakun. Mbyllni sytë. Provoni "të shikoni" kapakun. Në fillim, shëmbëlltyra jote mendore s'do të jetë e plotësuar. Do të vini re se s'do "të shikoni" disa veçori të rëndësishme, do të lini jashtë një vizatim, një nëntitull, do të harroni një ngjyrë, formën e germave. Hapi sytë, shqyrto kapakun edhe për 3 min. të tjera. Përsërite provën. Përfytyrimi do të jetë tashmë më i plotë e besnik.

Pra, nxënës të dashur rifreskoni vazhdimisht kujtesën. Çdo rast është i mirë për ju për të rifreskuar kujtesën dhe vlen si një lloj gjimnastike mendore. Kjo kërkon, natyrisht edhe përpjekje e disiplinë.

Rregullat etike

Bajrami është një fryt i Ramazanit. Nga kjo pikëpamje ai është edhe një shkak për lumturinë e njeriut që buron nga Ramazani, nga atmosfera e Ramazanit. Bajrami është një dhunti e Allahut.

Njerëzit që agjërojnë e përjetojnë bajramin si një festë të gëzueshme dhe marrin prej tij dhunti të mjaftueshme. Kjo është edhe arsyeja që bajrami është një e drejtë e njerëzve që meditojnë më shumë përtej botës së agjërit Prandaj njerëzit që i afrohen Allahut duke agjëruar i afrohen Allahut edhe duke bërë bajram. Ata fitojnë pëlqimin e Tij edhe duke iu bindur urdhrat të Tij për të mos mbajtur agjërim në bajram.

***Bajrami është
një rast i mirë
për të forcuar
vëllazërinë mes
njerëzve, për
të shmangur
ftohtësinë
dhe për të
përmirësuar
grindjet***

Bajrami është një dhuratë hyjnore e cila plotësohet duke na lumturuar të gjithëve bashkërisht me rrethin tonë shoqëror. Njerëzit tanë që kanë ngrohur shpirtat e tyre me agjërim, përqafojnë njerëzjetrin në ditët e bajramit dhe kështu bëhen fryt i një lumturie që buron nga një besim i njëjtë. Edhe nëse kanë dhimbje, e përjetojnë si një hall të përbashkët që përziën lumturinë. Bajrami është një stinë agjërimi që plotëson shpirtat e njerëzve.

Si duhet të festohen bajramet? Fillimisht brenda vetes sonë duhet të mbajmë gjallë vazhdimisht besimin se bajrami është një dhuratë hyjnore për atë që agjëron dhe për këtë ne duhet ta jetojmë atë si një gjendje shpirtërore që sjell një lumturi të veçantë. Këtë lumturi që kemi brenda vetes sonë duhet ta përhapim jash-të tek fëmijët tanë, bashkëshortja, miqtë tanë të ngushtë, farefisi, komshinjtë tanë dhe tek i gjithë mjedisi që na rrethon deri atëherë sa bajrami të mbushet me shpirtin e agjërit dhe të bëhet një vend strehimi shpirtëror që ndien mallin e atyre që e kalojnë në mënyrë të pavetëdijshme stinën e agjërit.

Urimi është përhapja e lumturisë së bajramit. Duhet të fillojmë me rrugën e urimit të cilës i jemi futur që më parë. Ne duhet t'i kujtojmë edhe të afërmit dhe miqtë e ngushtë

të cilët nuk mund t'i vizitojmë gjatë bajramit duke u shkruar atyre urime të ndryshme për bajram. Ne duhet të ripërtërijmë edhe ato miqësi të prishura me një mesazh sado të vogël. Në urimet tona duhet të ndjehet që i japim shumë rëndësi miqësisë së tyre. Nëse ka mes nesh nga vëllezërit besimtarë që janë ftohur disi nga lidhjet e ngushta, me rastin e bajramit dhe me anë të një urimi duhet të përpiqemi t'i tërheqim pranë nesh duke u fituar zemrën.

Namazi i bajramit: Namazi i bajramit është sikurse një sofër festimi që shënon edhe fillimin e lumturisë së bajramit. Besimtari që hap agjërimin e fundit, fillon të jetojë emocionin që sjell namazi i bajramit. Çdo familje jeton emocionin që sjell pikërisht ky namaz. E aq më tepër fëmijët... Edhe ato ua kujtojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe me këmbëngulje prindërve të tyre që t'i zgjojnë në namaz. Ata nuk duhet t'i pengojmë dhe t'i lëmë jashtë kësaj kënaqësie festive. Ne duhet t'u veshim atyre rrobat e reja të bajramit dhe t'i përgatisim për namaz. Në bajramin e ramazanit është parë e pëlqyeshme që para se të shkohet në namaz të hahet diçka. Na është kujtuar gjithashtu si një rregull shumë i rëndësishëm edhe shkuarja në namaz me rroba shumë të pastra. Na është këshilluar që edhe rrugët e shkuarjes për në namaz dhe të kthimit të jenë

të ndryshme. Kjo është me-
nduar kështu se sjell mundësi
më të mëdha për t'u takuar
me më shumë njerëz dhe për
t'u uruar atyre bajramin.

Pas namazit duhet të bëjmë
bajram me xhematin në xhami
duke shtrënguar duart. Ësh-
të dhënë sihariqi që nëse dy
besimtarë shtrëngojnë duart
me njëri-tjetrin duke treguar
se e duan njëri-tjetrin për hir
të Zotit, do t'u falen të gjitha
gjynahet. Për këtë duhet t'i
kushtojmë kujdes të veçantë
xhematit të xhamisë.

Vizita në varre: Në disa
zona të vendit është tradita
e mirë që pasi të dalësh nga
xhamia pas namazit të bajra-
mit të shkosh si grup për vizi-
të në varreza. Sipas synetit të
Pejgamberit (a.s) kjo vizitë të
kujton vdekjen, prandaj është
një sjellje mjaft e mirë, por
kjo mund të shpreh dëshirën
e besimtarëve për të marrë
pjesë shpirtërisht në lumturi-
në dhe gëzimin e bajramit si
dhe atë të ahiretit. Edhe nëse
nuk është e mundur vizita në
varreza menjëherë pas nama-
zit të bajramit, gjatë bajramit
është e nevojshme dhe pa-
dyshim e mirë. Gjatë vizitës
të mos shkelet në varre. Në
këto vizita lexohen ajete nga
Kur'ani dhe bëhen dua për të
shkuarit.

Vizitat: Këto janë nga de-
tyrat më të rëndësishme të
bajramit. Me rastin e bajramit
duhet të përpiqemi që me sa
të jetë e mundur të zbatojmë
një program të gjerë vizitash.
Rregulli në vizita është që pi-
kësëpari i vogli viziton të ma-
dhin. Kjo ngjet edhe në vizitat
e farefisit, gjithashtu mbetet
një nga detyrat tona që të vi-
zitojmë të afërmit dhe miqtë
tanë dhe të marrim duatë e

tyre. Veçanërisht nëse në fa-
refis apo në komshinjtë tanë
ka të sëmure apo të moshuar
edhe ato duhet t'i vizitojmë
patjetër, t'i afrojmë pranë ve-
tes dhe t'u urojmë shërim sa
më të shpejtë.

Gjithashtu një rregull shu-
më i rëndësishëm në vizita
është edhe qerasja. Duke u ni-
sur edhe nga mënyrat e huaja
të të jetuarit, janë krijuar disa
tradita apo zakone të gabuara.
Padyshim që gostitjet janë të
nevojshme por nuk duhet të
kalohet kufiri. Cilat janë këto
kufij? Shmangia nga shpenzi-
mi i tepërt, përdorimi i pijeve
apo vendosja e disa gjërave të
ndaluara në tavolinë etj. Edhe
nëse i zoti i shtëpisë do t'i për-
shtatet një gjëje të tillë, pra e
vendos në tavolinë dhe mys-
firi e sheh atë, ai duhet që me
një gjuhë të përshtatshme ta
vërë në dukje gabimin dhe ta
paralajmërojë që të largohet
nga këto lloj sjelljesh.

Vlerat tona të besimit i
kanë përcaktuar në mënyrë
të qartë dhe haptazi masat e
fshehtësisë në marrëdhëniet
e gruas dhe të burrit. Qoftë
në puthjet e dorës apo edhe
në takime dhe biseda duhet
t'u kushtohet kujdes kufijve
të fshehtësisë. Nuk duhet ha-
rruar që çdo rregull është një
pasqyrim i një sistemi besimi.
Edhe kufijtë në marrëdhëniet
burrë – grua janë të tilla. Ajo
që është e turpshme, duhet
shmangur. Nëse do të bëhet
fjalë për një cenim të kufijve
të fshehtësisë atëherë në këtë
pikë është shumë normale që
në një mënyrë të duhur të kuj-
tohen kufijtë e Islamit në këtë
aspekt.

Në festat e bajramit një nga
rregullat etike bazë dhe the-
melore mbetet edhe parapër-

gatitja në familjet tona për çdo
lloj vizite. Prandaj nuk është e
hijshe që të flihet në bajram.
Dera e shtëpisë sonë duhet të
jetë e hapur për çdo lloj mys-
firi. Ndërsa t'i përgëzosh dhe
t'i afrosh me nga një dhuratë
të vogël fëmijët që trokasnin në
derë për urimin e bajramit,
është shumë e rëndësishme
pasi rrënjës në shpirtat e tyre
gëzimin e përhershëm të baj-
ramit.

Pajtimi i të ndarëve

Bajrami është një rast i mirë
për të forcuar vëllazërinë mes
njerëzve, për të shmangur
ftohtësinë dhe për të përmirë-
suar grindjet. Asnjëherë nuk
është e drejtë që njerëzit të rri-
në të ndarë më shumë se tre
ditë. Nëse grindjet kanë vazh-
duar deri ditën e bajramit,
atëherë me rastin e kësaj feste
duhet të pajtohemi. Ai që e
bën hapin e parë në këtë pikë,
është me fitim. Mos e mendo-
ni se si do të vlerësohet sjellja
juaj. Hapin e parë për paqe
hidheni pa frikë. Kështu që ju
do të përmirësoni një plagë në
shoqëri.

Për ata që nuk mund të bëj- në bajram

Një nga detyrat e bajrami
është të mendosh se ka edhe
prej atyre që nuk mund të bëj-
në bajram. Ka nga ato që nuk
mund të bëjnë bajram për
shkak të robërisë. Ka prej aty-
re që nuk e arrijnë këtë ditë
për shkak të sëmundjes apo
të varfërisë. Është një borxh
apo obligim i yni që edhe këto
t'i fusim brenda vetes sonë, të
paktën t'i kujtojmë me dua
duke përcjell edhe dëshirat
dhe kërkesat e tyre. Para dua-
së mund të bëhen edhe shu-
më gjëra të tjera.

Gëzuar bajramin.

MASHTRIMI ESHTË VETMASHTRIM

Të bëhesh një mysliman i drejtë... Të përvetësosh një jetë larg nga mashtrimi, tradhtia dhe gënjeshttrat e njerëzve. Kjo është ajo që kërkohet nga ne...

Allahu i Madhëruar dhe i dashuri ynë i nderuar, që të bëhemi myslimanë të mirë, na kanë mësuar sjelljet e mira një e nga një, na kanë informuar për sjelljet e këqija, të shëmtuara dhe na kanë këshilluar që të qëndrojmë larg tyre.

Një prej sjelljeve të shëmtuara që nuk i ka hije një mysliman është mosbesnikëria dhe mashtrimi i njerëzve duke mos i qëndruar marrëveshjes së bërë dhe premtimit të dhënë. Ata që betohen "vallahi bil-lahi" duke i dhënë fjalën dikujt, e më pas tërhiqen nga premtimi i dhënë, janë mu ata

të këqijtë që Allahu i Madhëruar në ditën e Kiametit as që do ua shikojë fytyrat.¹⁴

Ja pra, për këtë shkak, të mashtrosh është një sjellje e keqe të cilën myslimani kurrë nuk duhet ta bëjë.

Myslimani askënd nuk mashtron

Meleku i preferon gjithmonë sjelljet e bukura të njeriut, shejtani arrin që të ia tregojë gjërat e këqija dhe tërheqëse. Atyre të cilëve iu është mësuar veshi që të dëgjojnë fjalën e shejtanit mundohen, për gabimet e bëra që rrethit t'u tregojnë se janë të pafajshëm. Ja për këtë një shembull i ngjashëm:

Një ditë Pejgamberi a.s. kishte dalë në tregun e Medi-

nës për nevoja shtëpiake. Pa një grumbull me grurë. Gruri dukej mjaftë i bukur, u afrua, pyeti për çmimin. Në atë çast i erdhi shpallja që kërkoi nga Pejgamberi që ta fuste dorën brenda në grurë. Gjë e çuditshme! Gruri që nga jashtë dukej i tharë, brendësia ishte e lagur. Nga kjo u kuptua qartë se ishte një mashtrim. Pejgamberi i Allahut pyeti shitësin: *Përse gruri jashtë duket i terur kurse brendësia e tij është e lagur?* Njeriu që u mundua të mbroje veten tha: Pak më herët ra shi dhe u lag. Pejgamberi këtë arsyetim nuk e pa të drejtë dhe tha: *Pasi që është kështu, a nuk duhet që grurin e lagur ta qitni përmbi për ta parë të gjithë?* Njeriu nuk mundi që t'i përgjigjej pyetjes, e Pejgamberi i mësoi rregullin e pa vdekshëm:

"Nuk është prej nesh ai i cili na mashtron".¹⁵

Disa tregtarë (të pa ndershëm) të sëmurë nga veset, për të mos iu ikur blerësi mundohen ta mashtrojnë atë duke i thënë se mallin të cilin po e shesin, e kishin blerë shtrenjtë. Ndoshta sipas tregtarit kjo është një gënjeshtër e pafajshme dhe e arsyeshme.



15 Muslim, Iman, 164; Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 242

Por sipas asaj që ka urdhëruar Pejgamberi këto janë lloje të mashtrimesh. Allahu i Madhëruar as që to t'ia këqyre fytyrat në ditën e kiametit tregtarëve mashtrues.¹⁶

Pa shiko se çfarë do të të jap!

Të mashtrohet qoftë edhe një fëmijë, ky prapë se prapë është një mashtrim. Një mysliman nuk duhet që as fëmijën e vet ta mashtrojë, dhe atij nuk duhet t'i japë shanse që ta mësojë këtë sjellje të keqe. Një ditë Pejgamberi a. s. e ndjeu një grua duke e thirrur fëmijën e sajë:

Eja! Pa shikoje se çfarë do të të jap!

Ai e pyeti gruan:

"Çka do t'i japësh fëmijës?"

"Do t'i jap hurma" (tha gruaja).

I dashuri dhe i dërguari i Allahut asaj gruaje i tha kështu:

"Po të mos i jepje fëmijës diçka, kjo do t'u shënonte si gënjeshtër në llogarinë e fjalëve tua"¹⁷.

Duke menduar se është një mashtrim i pafajshëm dhe pasi që një sjellje e tillë po shënohet në llogarinë e librit tonë, rreptësisht nuk duhet ta mashtrojmë askënd. Dhe nuk i duhet dhënë askujt rasti që për ne të thotë: "Është i mirë por thotë

rrena të kulluara".

Nuk e mashtrohet as pabesimtarin (qafirin)!

Një mysliman nuk mund t'i mashtrojë as pjesëtarët e feve tjera. Nuk mund ta marrë për sipër mëkatin e rëndë për t'i mashtruar ata. Dhe për këtë Pejgamberi a.s kur i dërgonte trimat në luftë, u fliste për këtë çështje duke i këshilluar:

***Po qe se dikush ka
bërë marrëveshje
me një popull,
as mos ta prishë
marrëveshjen dhe
as të mos e rifillojë
gjër sa atyre t'ua
bëjnë të ditur se ajo
është prishur apo i
ka mbaruar koha!***

"Mos veproni kundra fjalës së dhënë dhe askënd mos e mashtroini".¹⁸

Kjo ngjarje tregon se edhe pjesëtarët e feve tjera nuk duhet t'i mashtrojmë:

Në kohën kur ishte në Hilafet Muavije, Ebu Sufjani kishte bërë një marrëveshje paqeje me Bizantinët. Kjo do të zgjashte edhe disa muaj. Ai kishte

menduar se si të përfitojë nga ky rast. Dhe së bashku me ushtrinë e tij morën rrugën drejtë Bizantinëve. Sipas planit që kishte bërë, i duhej të priste një farë kohe në një vend afër, në mënyrë që sa të përfundojë koha e marrëveshjes, t'i sulmonte ata. Duke qenë ushtria në rrugë drejt Bizantinëve, **Amër ibni Abese** nga sahabët, i zuri luftëtarët dhe iu bërtiti:

"Nuk ka kthim, duhet që t'i përmbahemi premtimit".

Halifja e thirri atë pranë dhe e pyeti se çfarë donte të thoshte me këtë. Amër ibni Abese e informoi për këtë hadith të Pejgamberit:

"Po qe se dikush ka bërë marrëveshje me një popull, as mos ta prishë marrëveshjen dhe as të mos e rifillojë gjër sa atyre t'ua bëjnë të ditur se ajo është prishur apo i ka mbaruar koha!"

Halifja i cili nuk kishte dëgjuar për këtë hadith të Pejgamberit a.s., u kthye mbrapa menjëherë së bashku me ushtrinë e tij.¹⁹

Të mashtrosh është një gjë e shëmtuar. Nuk ka dallim në se i mashtrohet mysliman apo qafir. Ata që mendojnë se mashtrimi i pjesëtarëve të feve tjera nuk është rrezik, janë mu ata injorantë të cilët nuk e dinë fenë dhe nuk e njohin Islamin.

Edhe kur ndonjërin e mashtrohet dhe me paratë që fiton, blen sende me ato të holla, këto janë haram. Në këtë çështje,

¹⁶ Muslim, Iman, 171, 173.

¹⁷ Ebu Davud, Edeb, 79; Ahmed b. Hanbel, Musned, II, 447.

¹⁸ Muslim, Xhihad, 3.

¹⁹ Ebu Davud, Xhihad, 152; Tirmidhi, Sijer, 27.



sjellja e Ebu Bekrit është shembull mjaftë edukativ.

Nëna jonë Aishja (r. anha) tregon: Babai im Ebu Bekri kishte një rob, ky një pjesë të caktuar nga fitimi ia jepte babait tim, e ai me këto të holla i blinte gjëra ushqimore dhe i hante. Një ditë robi solli diçka që kishte fituar e babai filloj ta hajë. Robi e pyeti babaintim:

“A e din se çfarë janë gjërat të cilat je duke ngrënë?” Babai im i tha: “pa thuaj çka janë!” Dhe robi i tha këto: “Ishte periudha e injorancës, duke shikuar në fallin e dikujt, mashtrova një njeri edhe pse nuk kuptoja asgjë nga falli, e sot u takuam me atë njeriun. Borxhin të cilin nuk e kishte paguar me kohë, tani e pagoi dhe unë me ato të holla bleva gjërat të cilat ti i han”

Babai sapo i dëgjoi këto fjalë, e kuptoi se nuk ishin hallall gjërat të cilat i kishte ngrënë,

futi gishtat në gojë dhe i volli.²⁰

Mashtrimi i Allahut dhe pejgamberit

Mënyrat e të mashtruarit janë të ndryshme. Më e shëmtuara është përpjekja të mash-

Të mashtrosh është një gjë e shëmtuar. Nuk ka dallim në se i mashtruarit është mysliman apo qafir. Ata që mendojnë se mashtrimi i pjesëtarëve të feve tjera nuk është rrezik, janë mu ata injorantë të cilët nuk e dinë fenë dhe nuk e njohin Islamin.

trosh Allahun dhe të dërguarin e Tij. Përhapja e islamit në katër anët e botës dhe dëshira e madhe e Pejgamberit a.s për t'i shpëtuar njerëzit nga humnera e injorancës, ka bërë që për shkak të këtij qëllimi të mirë kohë pas kohe të tradhtohet nga disa njerëz me besim të dobët. Një shembull i tillë është tragjedia e Bi'ri Maun. Ishte viti i katërt i shpërnguljes së myslimanëve (hixhretit), Disa fise arabe kishin ardhur te Pejgamberi dhe i thanë: “Ne do të bëhemi myslimanë, mirëpo ju na

dërgoni disa mësues për të na mësuar Islamin”. Pejgamberi a.s. atyre iu kishte dërguar 70 veta siç i kërkonin ata. Mirëpo qafirët e mashtruan Pejgamberin. Në Bi'ri Mâu'n, mësuesit i hodhën në pus dhe i mbytën. Pejgamberi a.s ishte mërzhitur shumë nga kjo tragjedi dhe plot dyzet mëngjese i kishte mallkuar këta tradhtarë të poshtër.²¹

Gjeneratat faqebardha të këtij ummeti janë tri. E para është gjenerata e *sahabeve* të cilët e kanë parë Pejgamberin a. s. e dyta janë *tabiinët* të cilët i kanë parë sahabët dhe e treta janë gjenerata e *tebei tabiinëve* të cilët i kanë parë tabiinët. Pejgamberi a. s. për këto tri gjenerata ka thënë se janë “**gjenerata e artë dhe më e mirë**”, pastaj thotë se gjeneratat të cilat do vijnë pas tyre, do jenë tradhtarë dhe të pabesë.²²

Ashtu edhe ndodhi. Duke u larguar nga ato periudha të ngrohta me dashuri dhe duke e harruar etikën islame, u shumuan mashtrimet dhe tradhtitë.

Ne nuk na ka mbetur rrugë tjetër përveçse ta përqafojmë me forcë fenë tonë të pastër e cila do të na kthejë në burimin apo rrënjën e atyre periudhave të ngrohta të cilat kanë mbetur shumë larg.

Allahu na ndihmoftë (Amin).

21 Buhari, Xhihad, 9, Megazi, 28; Muslim, Mesaxhid, 297, Imare, 147.

22 Muslim, Fedailu s' Sahabe, 214.

20 Buhari, Menakibul Ensar, 26.

Thirrje lirisë



Të gjithë ne kemi çelur sytë për herë të parë në një botë të panjohur, në një kohë që nuk e kemi ditur dhe aq më tepër që nuk e kemi zgjedhur vetë. Natyrisht që përballë një surprize të tillë nevojitet të mendonim gjatë e gjatë se ç' kërkonim në këtë botë, pse kishim ardhur dhe se si do ta vlerësonim kohën mes ardhjes dhe shkuarjes, por derisa të arrinim në atë kohë që të mendonim këto, ne nuk na u dha pothuajse aspak mundësia të mendonim për gjëra të tilla meqë tashmë kishim probleme të tjera jetësore. Edhe sikur t'i kemi pasur këto mundësi, nuk i kemi vënë re. Kur mendja jonë filloi të zhvillohej ne kemi qenë me kohë në një garë. Kjo është një garë konsumimi që rrjedh nga ngarkesa e madhe ditore që përfshin shumë fusha të jetës që nga provimet e deri

te puna, nga familja tek tregu. Përpara se të futeshim në këtë garë shpresonim se teknologjia do na jepte shumë mjete lehtësuese. Veçanërisht brenda këtyre dhjetë viteve të fundit teknologjia na ka dhuruar më shumë se ç' prisnim, por nga teknologjia ne prisnim që së bashku me këto mjete lehtësuese të na dhurohej qetësi dhe lumturi. Dhe pikërisht këtu ne nuk gjetëm atë që kërkonim, bile u habitëm. Ashtu sikurse nuk na dha atë që prisnim ashtu na mori nga duart edhe një pjesë të mirë të tyre. Lumturia që mendonim të arrinim, mbeti shumë larg nesh si një imagjinatë. Bashkë me qetësinë ne na braktisën edhe një pjesë e mirë e ndjenjave dhe vlerave të tjera njerëzore. Kështu që ne dalëngadalë u larguam nga të afërmit tanë, nga njerëzit e tjerë, nga natyra, nga

rrethi dhe nga jeta.

Civilizimi Perëndimor, i cili sa herë që merr burimet e kësaj bote i konsumon ato pa asnjë përgjegjësi dhe që në këtë aspekt ka kohë që i vështrirëson kufijtë e rezistencës së planetit tonë, edhe pse e ka mbushur prehrin e njeriut me shumë lodra, nuk ka arritur t'ia dhurojë atij lumturinë. Kurse pjesa tjetër e botës e mbetur mbrapa nuk arriti të merrte as edhe një pjesë të tillë nga ky civilizim. Ata në vend të një pjesë të lumturisë morën pjesë nga armët, bombat dhe raketat.

Që kur ka filluar t'i dëgjohej fjala civilizimit Perëndimor në sipërfaqen e tokës luftërat s'kanë munguar asnjëherë. Ndërsa mundësitë e kësaj lufte asnjëherë nuk kanë dalë nga anët e atyre që kanë luftuar. Këto luftëra i kanë fituar përherë ata që i kanë futur të tjerët në luftë. Perëndimi u shiti armë atyre që s'kishin bukë për të ngrënë dhe ujë për të pirë, vdekja u shpërnda gjithandej duke i shkatërruar vendet e tyre dhe duke i bërë rrafsh me tokën. Ai nuk u ngop me paratë e armëve që shiti dhe të vdekjeve që u përhapën, për t'i rimëkëmbur edhe njëherë vendet e shkatërruara, i zhveshi përsëri ato dhe përsëri nuk diti të ngopej.



Qytetërimi perëndimor e bëri konsumin një fe. Lënia në marramendje e kokave të njerëzve mbarte një rëndësi jetësore për të çuar në vend pa u hetuar urdhrat e “fesë konsumuese”

Kjo fe e re kishte dy urdhra të shenjtë, njëri është për njerëzit ndërsa tjetri për ekonominë

Ajo u tha njerëzve **“Do të konsumoni!”** Njerëzit e dëgjuan dhe u bindën. Për këtë arsye feja e re së pari i la të pakënaqur ndaj gjendjeve të tyre, më pas u vendosi përpara qëllime të reja. Njerëzit nuk duhet të mjaftoheshin me prodhimet e dorës, ata duhet t’u drejtoheshin mallrave të prodhuara në fabrika, të ambalazuara dhe që u ishte bërë reklama. Askush nuk duhej të mjaftohej me ato që kishte, duhet të nxirrreshin nevoja të reja dhe duhej t’u drejtohej ngopjes së tyre.

Në mes kishte një të vërtetë të natyrës së njeriut. Kjo e vërtetë ishte fakti që dëshirat thuajse ishin të pangopshme dhe se një dëshirë e plotësuar i hapte rrugë një tjetre. Si përfundim përpara nesh ka një hapësirë të pakufishme nga aspekti ekonomik; ka kërkesa të reja dhe sapo të plotësohen këto kërkesa do t’u hapin rrugë pafundësisht kërkesave të reja.

Feja e re edhe ekonomisë i tha **“Do të rritesh”** dhe ekonomia filloi të zhvillohej. Ajo u rrit dhe u zhvillua pa njohur pengesa dhe pa u ndalur.

Sipas kësaj feje të re as eko-

nomia dhe as njerëzit nuk do të thonin “mjaft”.

Shumë herë merremi me shkaqe që na fusin në mërzi të dhe kur i shmangim këto shkaqe, kujtojmë se kemi arritur në lumturi. Kurse në fakt një jetë e lumtur, e qetë dhe bindëse nuk është një jetë që nuk ka probleme; ky është një zog me fat që mund të kalojë në dorën e atyre që dinë pse jetojnë dhe që jetën e tyre e organizojnë sipas këtij qëllimi.

Ju mund të mendoni se që në fillim të punës ne kemi vendosur dërrasën e ngushtë në një lartësi të cilën nuk e mbërrin askush. Edhe të dish se pse jeton edhe ta drejtosh jetën sipas këtij qëllimi shihen si punë që mund t’i arrijnë shumë pak njerëz në botë. Edhe pamja e përgjithshme e popullit e nxjerr me të drejtë këtë mendim. Nëse e dini se ç’ duhet të bëni, kjo do të thotë se bëni pjesë në 5% të pjesës së njerëzve, nëse arrini ta drejtoni jetën tuaj në përshatje me këtë qëllim do të thotë se bëni pjesë në 2% të grupit. T’i realizosh që të dy këto punë përnjëherë dhe me sukses është diçka që e tejkalon forcën e 98% të njerëzve.

Kërkimi është fati i njeriut, ndërsa rezultati më i rëndësishëm është zbulimi i qëllimit të jetës. Pasi të zbulohet ajo që mbetet, vendosja e gurëve në vendin e duhur nuk merr shumë kohë.

Sidoqoftë një ditë do ta harxhojmë edhe pjesën e fundit të jetës. E gjithë çështja mbërthehet në faktin që kur të mbërrijë ai moment dhe të hedhim

shikimin mbrapa a do mbesim të kënaqur nga mënyra se si e kemi harxhuar jetën.

Për një njeri që mëson ta jetojë jetën me pasuritë shpirtërore, çdo ditë e re me diell do të thotë një pjesë e re dhe kurioze e një aventure kuptimplotë e cila vazhdon. Bukuritë që do të na sjellë ajo ditë duke



***Një jetë e lumtur,
e qetë dhe bindëse
nuk është një jetë që
nuk ka probleme; ky
është një zog me fat
që mund të kalojë
në dorën e atyre
që dinë pse jetojnë
dhe që jetën e tyre e
organizojnë sipas
këtij qëllimi***

na mbështjellur nga njëra anë shpirtin tonë me një emocion të ëmbël, nga ana tjetër përcaktojmë hapat që do të hidhen për të arritur qëllimin që duam.

Në përfundim të çdo dite të jetës sonë dhe të çdo moment të ditës ne do të arrijmë një mënyrë jetese tjetër, larg pasigurive, të sigurt në vetvete, të bindur që kemi bërë atë që na takon, një jetë që do të dallojë, do të zbulojë dhe do të jetojë bukuritë që jeta na paraqet, një jetë që ia vlen të jetohet.

Tani mund të përcaktojmë dy kushtet themelore të "Një jete të vetëdijshme": I pari: Të kesh një qëllim jete. I dyti: Të rregullosh harxhimet sipas qëllimit jetësor duke marrë në konsideratë faktin që çdo lloj harxhimi i bërë është një harxhim nga jeta jonë.

Civilizimi konsumues e nxit vazhdimisht njeriun të marrë, të kapërdijë, të bluajë, të konsumojë dhe ky civilizim na i paraqet këto para nesh si një qëllim jetësor.

Të dëgjosh thirrjen që na bën jeta, bota pjesë e së cilës jemi, të zgjidhësh mesazhet që na sjell dhe të dallosh bukuritë që na shfaqen çdo çast jemi të detyruar që fillimisht të pastrojmë parazitët dhe të shmagim zhurmën.

Le ta shpjegojmë me pak shembuj se ç' kemi humbur nga jeta dhe se ku e kemi futur veten:

Nëse nuk ke një makinë apo një shtëpi është një varfëri.

-A nuk është një mangësi të mos hasesh me pemët që çelin lule shumëgjyrëshe në behar?

-A nuk është një mangësi t'i qëndrosh larg bukurive të mahnitshme që mbushin qiellin e mbrëmjes me yje shumëgjyrëshe?

-A nuk është mangësi të mos arrish të shohësh lindjen dhe perëndimin e diellit, ose të mos të arrish ta mendosh një gjë të tillë kur ka mundësi?

-A nuk është një mangësi të mos arrish të dëgjosh koncertet e cicërimave të zogjve çdo ditë falas para se të lindë dielli dhe pasi të perëndoje edhe sikur t'i kemi dëgjuar mos t'ia vëmë veshin?

Disa mund të qeshin për këto që kemi numëruar. Por të gjitha këto janë gjëra që njeriu i ka përherë në dorë dhe që mund t'i arrijë pa ndonjë pagesë, ndërsa nga botëkuptimi i civilizimit të konsumit që na është dhuruar gjërat që s' paguhen dhe ato gjëra që ne na paraqesin të ndryshëm nga të tjerët, nuk njihen si mirësi.

Për fat të keq as që ia kemi idenë e një principi shumë të bukur:

"Të jetosh jetën me të gjitha dimensionet e saj"

Një njeri që arrin t'i shpëtojë sulmeve epshore, e gjen veten para përgjegjësive që fillojnë që nga rrethi i tij i afërt e deri në qoshen më të largët të botës.

Ndoshta një vetëdije e tillë

Për një njeri që

mëson ta jetojë

jetën me pasuritë

shpirtërore, çdo ditë e

re me diell do të thotë

një pjesë e re dhe

kurioze e një aventure

kuptimplote e cila

vazhdon

mund të jetë në natyrën e njeriut. Kur të shmangen pengesa të tilla si egoizmi, ambicia, zilia, përfitimi etj, kjo qenie fillon të tregojë menjëherë efektin e saj. Dhe njeriu sapo hedh hapin e tij në jetën e pastër njihet përsëri me ndjenjat e dhembshurisë dhe dashurisë duke e gjetur vetveten në mes të një familjeje sa bota.

Njeriu modern me të vërtetë është lënë inorant në aspektin e jetës. Ai s'njeh as lulen në tokë dhe as yllin në qiell, ndërsa jeta ka aq vlerë sa ia vlen ta presësh që në hyrje, është e bukur dhe nazet më tërheqëse të bukurisë së saj janë të fshehura në paqartësinë e saj.

Njeriu modern duke mos e gjetur atë që kërkon në çmendurinë e konsumit, më në fund patjetër do ta kuptojë. Shpresojmë të mos mbesë shumë vonë.

Koncepti Islam për zgjidhjen e krizës ekologjike

Ai, i cili për ju bëri tokën shtrat, (vendbanim) e qiellin kulm, e prej qiellit ju lëshoi shi me të cilin ju siguroi lloje të frutave si ushqim për ju, pra mos i përshkruani All-llahut shokë, duke qenë se ju e dini (që Ai nuk ka shokë).

Bekare 22



"Muslimanit që mbjell drithë apo mbjell fidan dhe nga frutat e tyre ushqehen shpezët, njeriu apo ndonjë shtazë, kjo do t'i llogaritet atij sikurse sadaka."

Muhammedi (a.s.)

Titulli i këtij shkrimi një pjesë të lexuesve në shikim të parw do ta dëshpërojë. Ky grup do të mendojë se fjala është për një nga shkrimet e shumta të natyrës pamfletiste, propaganduese, që jemi mësuar të lexojmë gjatë shekullit XX, e sidomos gjatë disa dekadave të fundit. Kjo periudhë karakterizohet me 'vër-

shimin' e këtij lloji shkrimesh, të natyrës inferiore, të shkruajtura nga entuziastët muslimanë, me qëllim identifikimin e Islamit me arritjet shkencore, shpesh të dyshimta.

Pjesa tjetër e lexuesve, sigurisht e zënë në zgrips, do ta befasohet, e papërgatitur për një shkrim të tillë, meqë dimë se ekologjia është shkencë e re, aktuale, e kohëve të fundit, kurse Islami, siç e lexojmë e dëgjojmë shpesh, është fe e Mesjetës, arkaike, prapanike.

Pjesa e tretë e lexuesve as do të dëshpërohet, as do të

befasohet, por do të përforcohet në rrugën e besimit të tyre. Ky grup lexuesish, pak a shumë, posedon njohuri për Islamin dhe për përmasat e tij dhe këtë titull e pret thujse normalisht, madje të vonuar.

Por, përse, nga buron dëshpërimi, befasia apo edheskeptika ndaj këtij shkrimi? Ka shumë shpjegime dhe shumë faktorë për një përgjigje përkatëse përse një pjesë e lexuesve, së paku në shikim të parë, do të dëshpërohet ose të paku do të befasohet.

Ata mendojnë se ruajtja e mjedisit, ekologjia, vetëdija ekologjike, ekosistemi, ekuivalenti ekologjik, valenca ekologjike e shprehje të ngjashme me këto janë shpikje të kohëve të fundit të Perëndimit. Dhe vërtetë, disa nga shprehjet e përmendura janë shpikje e Perëndimit përballë sfidave, rrezikut dhe kërcënimit nga zhvillimi bashkëkohor që kanos natyrën dhe mjedisin që na rrethon.

Sidoqoftë, deri sot është

bërë pak në studimin e mirë-filltë të shkaqeve të lindjes së krizës së mjedisit jetësor. Aksesit aktual është parcial dhe evropcentrist. Kryesisht vepimet janë të tipit të fushatave, e jo sistematike dhe profesionale. Po ashtu, aksesit aktual orientohet kah pasojat e jo shkaqet e krizës, aksesit që nuk premtori lumturi të plotë. Megjithatë, dalja në skenë e shumë partive të gjelbra, të shumë fondacioneve, shoqatave e individëve, që ofrojnë ndihmën e tyre, jep shpresa për një të ardhme më të mirë. Kontributi ynë le të jetë në mesin e atyre që nxisin të gjitha palët për trajtim të gjithanshëm dhe konstruktiv: ku të gjitha fetë, kulturat, qytetërimet duhet ta japin angazhimin e tyre.

Për të trajtuar krizën ekologjike para së gjithash duhet ta njohim ç'është ekologjia. Ndaj, *ekologjia* është shkencë e cila më mënyrë interdisiplinare merret me humltimin e raporteve të njeriut por edhe të qenieve të tjera ndaj natyrës. Disa ekologjinë e përkufizojnë si "ekonomi të natyrës së gjallë, shkencë mbi prodhimin dhe shpërndarjen e materies organike në natyrë dhe mbi ekzistencën e botës së gjallë përgjithsisht. Ndërgjegjia ekologjike e njeriut dhe ekologjia, në kuptimin figurativ, janë të pranishme në jetën e njeriut në këtë botë qysh nga fillimi i historisë.

Në kulturat arkaike njeriun e gjejmë në bashkëpunim të plotë me natyrën si një organizëm të madh. Në kulturat e larta qëndrimi

i njeriut ndaj natyrës sillet në bazë të diturisë dhe teknikës, që, megjithatë, i ngjasojnë natyrës. Në traditat shpirtërore lindore natyra përjetohet në vertikalen metafizike të manifestimit hyjnor. Në qytetërimin modern, të mbështetur mbi bazat e shkencës moderne e teknikës, që nuk ngjason më as me njeriun as me natyrën, njeriu sillet ndaj natyrës si ndaj objektit të thjeshtë, në mënyrë rrënuese.

Sot në botë kriza ekologjike konsiderohet si një prej problemeve më të mëdha para së cilës ndodhen njerëzia, natyra dhe jeta. Ndër karakteristikat më të rëndësishme të krizës ekologjike para së cilës gjendet njeriu është ajo e natyrës planetare. Ajo i përket jetës së tërë njerëzisë dhe tërë planetit. Mirëpo, për kërcënimet e tmerrshme

të krizës ekologjike di vetëm numër i kufizuar njerëzish. Këtë gjendje e shkaktojnë vendet më të fuqishme dhe më të pasura në botë. Shpesh njeriu, i ballafaquar me seriozitetin e krizës ekologjike, qëndron para dilemës se a ka fare rrugëdalje!

Disa thonë se paradigma ekonomike e shekullit XX do të zëvendësohet me paradigmën ekologjike në jetën ekologjike të shekullit XXI.

Shumica e faktorëve relevantë krizën ekologjike e shohin në krizën morale të botes. Dalja nga kriza sipas tyre qëndron në kthimin jetës së moralshme kundrejt vetë njeriut, mjedisit ku jeton etj. Kështu, Simons, në Konferencën e OKB-së për ruajtjen e mjedisit jetësor, më 1972, ndër të tjera pohoi: "Ka ardhur koha kur do të duhej





të bashkohen morali dhe shkenca që të sigurojnë udhëzim përkatës për veprim dhe sjellje të individëve dhe grupeve, d.m.th. udhëzim që nuk është i bazuar ekskluzivisht në prodhimin e sa më shumë të mirave në vendet e zhvilluara”.

Disa krizën ekologjike e shohin në: shkatërrimin dhe zhdukjen e mijëra llojeve biologjike, në urbanizim dhe stërpopullim, në ngrohjen globale, në vrimat e ozonit, në shkatërrimin e pyejeve, ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit, në mungesën e ujit të pijshëm, të teknologjinë rrezikuese, kontaminimin radioaktiv, dioksidin e karbonit etj. Qysh në vitin 1970, nga tubimi në Mentoni, 2200 shkencëtarë me famë botërore i bënë apel njerëzisë: “Edhe pse gjeografikisht jemi gjerësisht të ndarë, me kultura, gjuhë, pikëpamje, me përkatësi politike dhe religjioze mjaft diversitive, ne jemi të bashkuar në kohën tonë për shkak të rrezikut të përbashkët, deri tash joekzistues. Ky rrezik, çfarë njeriu nuk ka takuar, ka lindur me takimin e shumë dukurive të

ndryshme. Secila prej tyre na vë para problemeve të pazgjidhshme, kurse marrë së bashku, ato nuk do të thotë sigurisht vetëm rritje të gjerë të vuajtjeve njerëzore në ardhmërinë e drejtpërdrejtë, por mundësinë e zhdukjes, ose zhdukjes virtuale të jetës njerëzore në tokë.”

Pra, burimet e krizës ekologjike janë të ndryshme, por ato para së gjithash duhet kërkuar në zhvillimin e diturisë moderne të privuar nga

***Sot në botë
kriza ekologjike
konsiderohet si një
prej problemeve
më të mëdha para
së cilës ndodhen
njerëzia, natyra
dhe jeta. Ndër
karakteristikat më
të rëndësishme të
krizës ekologjike
para së cilës gjendet
njeriu është ajo e
natyrës planetare***

kuptimi dhe nga vlera. Mbi baza të diturisë së këtillë, të liruar nga përgjegjësia morale dhe nga ideali i urtësisë, merr hov rritja e tmerrshme e fuqisë teknologjike të njeriut. Kjo fuqi përplaset në mënyrë të pakontrollueshme në natyrë në shoqërinë industriale të ngritur në dituri, teknikë dhe ekonominë kapitaliste.

Historikisht, njeriu i është dashur t'i përshtatet mjedisit ku jeton, të ndryshojë sjelljen e tij, të ruhet nga rreziqet, por edhe të ndryshojë mjedisin për ta bërë atë më të përshtatshëm për ekzistencën e tij. Pikërisht në këtë proces të ndërsjellë ndryshimet njeri dhe mjedis linden problemet ekologjike. Revolucioni industrial, progresi i vrullshëm i shkencës dhe teknikës, prodhimi dhe konsumi në përjesëtime të mëdha, prish ekuilibrin në biosferë, ndryshon ekuilibrin natyror ndërmjet njeriut dhe mjedisit.

Meqenëse kriza ekologjike në botë është pasojë e shumë faktorëve, për zgjidhjen e saj duhet të marrin pjesë të gjithë: filozofët, politikanët, shkencëtarët, poetët, teologët, lindorët dhe perëndimorët, të zhvilluarit dhe të pazhvilluarit dhe të gjithë të tjerët të cilët këtë tokë e konsiderojnë shtëpi të tyre.

Ofrimi i konceptit islam për kontribut në zgjidhjen e krizës ekologjike në botë duhet të përfillet dhe seriozisht të punohet në të.

Leximi me kujdes i Kur'anit dhe Hadithit dhe i literaturës relevante islame, përkundër

ofensivës dhe atakut agresiv të Perëndimit, tregon se Islami megjithatë vazhdon të jetojë si forcë e fuqishme religjioze dhe shpirtërore në mendjen dhe shpirtin e pjesëtarëve të tij. Islami ndihmon të kuptojmë se këto mësimë në mënyrë aktive e mbrojnë mjedisin e njeriut, duke ruajtur harmoninë e krijesave në natyrë, duke ruajtur harmoninë ndërmjet njeriut dhe natyrës dhe njeriut dhe resurseve në natyrë, Islami ndihmon që muslimani i përkushtuar t'i kundërvihet diktatit të makinës. Nga Kur'ani dhe Hadithi shohim se kujdes i meritueshëm i bëhet vetë njeriut, pastaj faunës dhe florës sikur edhe katër elementeve shumë të rëndësishme: tokës, ujit, zjarrit dhe ajrit.

Për ekologjinë islame me rëndësi të madhe është perceptimi islam i Natyrës. Sipas burimeve islame Natyra është vend i manifestimit dhe veprimit të emrave dhe attributeve hyjnore. Natyra është libër i Zotit i hapur njeriut në mënyrë analitike. Në faqet e saj Zoti i shkruan shenjat (ajetet) e veta. Në traditën islame jeton mendimi për Natyrën si Kur'an që hesht dhe për Kur'anin si Natyrë që flet. Natyra është gjithnjë e gjallë. Ajo e lavdëron krijesin e saj:

"... po secili noton në një galaktikë." (Jasin, 40).

Për etikën ekologjike islame është me rëndësi vitale fakti se në islam nuk ekziston ndarja në botën sakrale dhe profane. E tërë bota është



e përshkruar me Shenjtëri. Shenjtërinë e botës, të natyrës e përshkruan në mënyrë të shkëlqyeshme, mendimtari islam Friçof Shuon duke pohuar:

"Natyra e virgjër e paprekur posedon veteotiu dinjitetit e vendit të shenjtë dhe të këtyllë e konsideron shumica e popujve nomadë dhe gjysmë nomadë, e sidomos Indianët e kuq ... Për Indianët pyelli është vendqëndrim natyror i urtakëve, kurse respekt të ngjashëm të pozitës së


shenjtëruar të natyrës ndeshim në të gjitha traditat që kanë, madje edhe tërthorazi, katrakter primordial apo mitologjik."

Këto përgjegjësi, këto detyrime ndaj natyrës Islami i rregullon me ligj; nëpërmjet fikhut detyrimet morale sanksionohen dhe bëhen të shenjta. Kjo nënkupton edhe angazhimin politik. Lufta politike për vetëdije ekologjike dhe për politikë ekologjike legjitimizohet.

Muhammedi a.s. edhe nga kundërshtarët edhe nga përkrahësit është konsideruar si respektues i madh i përdorimit të arsyeshëm të tokës, të ajrit, të ujit, i trajtim-it të kafshëve, shpezëve dhe bimëve. Është tejet interesant konceptimi bashkëkohor i mjedisit nga ana e Muhammedit (a.s.), udhëzime këto që janë aktuale deri sot dhe do të jenë deri në Ditën e fundit.

Filozofia Islame (ajo e Kur'anit dhe e Hadithit) para së gjithash është holistike, që do të thotë se nënkupton lidhshmërinë bazore dhe ndërvlarshmërinë e të gjitha

***Në traditën islame
jeton mendimi për
Natyren si Kur'an
që hesht dhe për
Kur'anin si Natyrë
që flet. Natyra
është gjithnjë e
gjallë***



elementeve natyrore dhe doktrinën e vet e mbështet mbi premisën se nëse njeriu abuzon apo eksagjeron një element natyror, bota si tërësi pëson pasoja të drejtpërdrejta. Njeriu në vend që ta nënshtrojë dhe dominojë natyrën, ai duhet të miratojë normat dhe ritmet e saj. Për natyrën nuk duhet biseduar nga pozicioni i dobisë së njeriut, i gllabërimit të natyrës, i eksploatimit të saj të vrazhdë, por me natyrën duhet sjellur dhe vepruar sikur prindi i mirë me fëmijën e tij.

Sipas Islamit Toka ka rëndësi të veçantë. Kjo shprehje është ndër të të frekuentuarat në Kur'an në raporte të ndryshme, materiale dhe fizike, të dukshme dhe të padukshme. Miratimi i faktit se Allahu është Fillimi dhe Fundi, dmth. se për njohjen e botës nevojitet t'i drejtohem Atij. Është vështirë të numërohen të gjitha rendësitë e tokës, por

pacenueshmëria e dheut dhe tokës si vend i pastër, vend i namazit dhe dheu si mjet i pastrimit, që është rast me tejemumin, këtë më së miri e dëshmojnë. Muhammedi a. s. tokën e konsideronte të nënshtroar për njeriun, por konsideronte se toka nuk duhet eksploatuar pa masë. Edhe bimët edhe toka kanë të drejtat e tyre, të cilat njeriu duhet t'i respektojë sipas masës së tyre e jo sipas masës së vetë njeriut. Për këtë qëllim, Muhammedi a.s. ka mbrojtur territore të caktuara, pyej dhe botën e egër, duke formuar zona të mbrojtura si hima apo si harem (ndalesë), në të cilat begatitë nuk bënë të preken. Këto zona të ndaluara kanë qenë kryesisht afër puseve dhe burimeve të ujit. Hima janë ato vende të egëra dhe male, ku prerja e drunjve, kullotat dhe gjahu është i kufizuar në kohë dhe në lloje. Muhammedi a.s. jo vetëm që ka nxitur shfrytëzimin e

matur të tokës pjellore, por pasuesve të tij u ka urdhëruar edhe kultivimin e tokës jopjellore, mbjelljen e drunjve, mbjelljen e drithrave dhe pemëve dhe ujitjen e tokës së thatë. Të gjitha këto janë konsideruar sadakë. Me një rast Muhammedi a. s. ka thënë: *"Kush e gjallëron një tokë të vdekur (të papunuar), ky njeri do të shpërblehet për të"*, kurse me një rast tjetër e bën pronar të saj.

Në rrethanat shkretinore, në të cilën ka jetuar edhe Muhammedi a. s., uji ka qenë sinonim i jetës. Imam El-Gazali shpreh habi se si njerëzit e caktuar kur është fjala për ujin "janë neglizhentë kundrejt kësaj kësaj begatie."

Edhe sipas Kur'anit, uji është dhuratë e Zotit dhe burim i jetës në Tokë:

"...dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi ..." (el-En-

bija, 30)

Muhammedi (a.s.) gjithnjë kishte për prioritet mbrojtjen e ujit. Për këtë arsye, buri- met e ujit dhe ambientin e tij në shumë vende i bëri zota të pacenueshme (haram). Madje, edhe kur uji është me bollëk, kursimi i ujit është domosdoshmëri. Kursimi i ujit është edhe në çështjet më elementare, si pastrimi, ab- desti etj.

Po ashtu, është detyrim fe- tar të ruhet pastërtia e ujit. Për këtë arsye ndalohet ndot- ja e ujit, hedhja e fekalieve në ujë, urinimi në ujë të mbled- hur etj.

Pajtueshmëria e njeriut me mjedisin e tij është nevojë dhe domosdoshmëri. Kjo pajtueshmëri, harmoni në të cilën insiston Islami, e të cilën

Imam El-Gazaliu “si lidhje të pakushtëzuar ekzisten- ciale ndërmjet Shpalljes dhe krijimit apo ndërmjet Fjalës dhe Aktit, apo ndërmjet Dijes dhe Sajimit (krijimit) apo ndërmjet Fjalës dhe Natyrës e sheh brenda perspektivave shpirtërore të emrave të bu- kur të Allahut” gjatë historisë është përdhosur, thyer. Për pasojë kemi degjenerimin dhe bastardimin e natyrës, të njeriut, të faunës dhe florës. Është e qartë së mësimi Islam krijon lidhjet e nevojshme për bashkëpunim, vendos rregullat për qëndrim të drejtë të njeriut kundrejt Tokës, ndërmjet botës shtazore dhe bimore, dhe me këtë për qëndrim të drejtë kundrejt Krijuesit dhe botës së paduk- shme: engjëjve, xhinëve dhe djajve. Kjo gjendje e shpre- hur me gjuhë të metafizikës do të thoshte se “natyra e cila pakusht është reduktuar në kuantitet, kurse mikrokoz- mosi njerëzor ka humbur strukturën e tij treveprues të frymës (ruh / spiritus), të shpirtit (nefs / anima) dhe të trupit (xhism / cor- pus)”, duhet kthyer në një substancë të afruar dhe të bashkuar, në natyrën e tyre origjinale.

Kriza ekologjike është me karakter global dhe musli- manët duhet të inkuadrohen në këtë çështje seriozisht. Por, në këtë aksion duhet të inkuadrohen edhe judaistët, kristianët, budistët, konfu- qionistët etj., nga një anë dhe shekullaristët, laicistët, nga ana tjetër. Kriza ekologjike e natyrës kërkon kujdes glob- al dhe mësimet islame do të

ndihmonin dhe udhëzonin në zgjidhjen e krizës së mjedisit. Përëndimi po ashtu, duhet ta kuptojë se kulturat e lindjes, sidomos ajo islame, mund të ofrojë “çelësin” për zgjid- hjen e problemit. Përëndimi, duke iu falënderuar fesë pri- mordiale ibrahimiane, ndër të cilat gjendet edhe Islami, këtë çelës e ka poseduar, por tashmë një kohë të gjatë e ka humbur. Kur’ani pohon: “Dhe thuaj: ‘Erdhi e vërteta dhe u zhduk gënjeshtria’. Vërtet gënjeshtria gjithnjë ka qenë e zh- dukur.” (El-Isra, 81).

Ligji i Allahut (sheriati) qa- rtë ka përcaktuar detyrat dhe obligimet e njerëzve kundre- jt sistemit dhe mjedisit naty- ror. Njeriu është i obliguar t’i ndhmojë njertëzitet tjerë dhe t’i zgjidh problemet e të varfërve por edhe mos ta ndotë ajrin, ujin, token. Njeriu ka obli- gime edhe ndaj botës së xhi- nëve dhe engjëjve, shtazëve dhe shpezëve, bimëve dhe çdo gjëje që e rrethon. Fakti se të gjitha këto janë krijuar për njeriun nuk i jep të drejtë atij t’i eksploatojë këto të mira në mënyrë joracionale. Njeriu drejton me të gjitha krijesat sipas udhëzimeve të Kur’anit kurse sipas shem- bullit të Muhammedit a.s.. Ai duhet të bëhet rob (abd) i Allahut dhe vullnetin e tij (ibadet) t’ia dorëzojë Alla- hut, me Tokën dhe qiejtë dhe mjedisin natyror të jetojë në paqë, rehati dhe harmoni të plotë.

***Mësimi Islam
krijon lidhjet e
nevojshme për
bashkëpunim,
vendos rregullat
për qëndrim të
drejtë të njeriut
kundrejt Tokës,
ndërmjet botës
shtazore dhe
bimore, dhe me
këtë për qëndrim
të drejtë kundrejt
Krijuesit dhe botës
së padukshme:
engjëjve, xhinëve
dhe djajve***

Pashai i fundit i Budapestit: Arnavut Abdurrahman Abdi Pasha



Kronistët nuk kanë regjistruar ndonjë datë rreth lindjes së Abdurrahman Abdi Pashës, i cili përkujtohet nga historia si bejlerbeu i fundit i Budapestit, apo siç quhej gjatë sundimit osman Budini. Ndërsa data e vdekjes së tij 2 Shtatori 1686 është njëkohësisht edhe data kur merr fund sundimi otoman mbi këto toka. Komandanti i fundit i ushtrisë otomane qe shqiptari Abdurrahman Abdi Pasha.

Ashtu sikurse shumë shqiptarë të tjerë Abdurrahman Abdiu e filloi karrierën e tij ushtarake duke u regjistruar në shkollën e jeniçerëve, nga e cila do të dilte në vitin 1669 me detyrën aga i repartit të jeniçerëve. Trimëria dhe heroizmi që tregoi gjatë rrethimit të Kretës, e drejtuar nga një personalitet tjetër me origjinë shqiptare Fazëll Ahmet Pashë Qyprilliu, bëri që të ngrihej në gradën e vezirit, ofiq që do të hapte rrugën në karrierën e tij administrative të perandorisë duke u emëruar me radhë si vali në Bagdat, Egjipt, Bosnjë dhe së fundi në Budapestin e

sotëm. Budapesti hyri nën sundimin otoman në vitin 1541 gjatë ekspeditës së madhe ushtarake të drejtuar nga vetë sulltan Sulejmani.

Në detyrën e valiut Abdurrahman Abdi Pasha qëndroi me trimëri së bashku me repartin e vogël kundrejt ushtrisë austriake prej 90 mijë ushtarësh që rrethuan Budapestin. Për tre muaj e gjysmë rrethim arriti të zmbrapste me trimëri 18 mësymje të mëdha duke refuzuar përherë kërkesën për dorëzim që i bënte armiku. Kur ushtarët kryqtarë arritën të shtien në dorë kodrat që lartësoheshin në pikat strategjike të qytetit dhe ende nuk shiheshin të vinin në ndihmë forca të freskëta nga ana e osmanëve, atëherë Abdurrahman Abdi Pasha u fut edhe ai në mesin e ushtarëve që luftonin në vijën e parë të ushtrisë. Ditën e 2 shtatorit 1686 njësitë ushtarake të Lidhjes së Shenjtë Kryqtare u hodhën në sulm të përgjithshëm në të gjashtë frontet duke i shkaktuar mbrojtëse osmanë të kështjellës një disfatë të pashmangshme. Abdurrahman Abdi Pasha u therorizua në portën e Pecit në moshën 70 vjeçare.

Por rumunët kishin mbetur të mahnitur nga guximi dhe trimëria e komandantit me origjinë shqiptare që luftonte në krah të osmanëve. Bëmat e

tija gjatë luftimeve do të skaliteshin në kujtimet e tyre dhe në shenjë respekti ndaj komandantit trim do të ngrinin mbi varrin e tij një mauzoleum mbi të cilin do të gdhendnin këto fjalë:

Valiu i fundit i sundimit 145 vjeçar otoman në Budin, pashai shqiptar Abdurrahman Abdiu, u vra në moshën 70 vjeçare në kohën e pasdrekës së datës 2 shtator 1686 në afërsi të këtij vendi. Qe kundërshtar në luftë, por trim, u prehtë në paqe

Pas fitores mbi osmanët përpara portave të Vjenës në vitin 1683 një ushtri e madhe austriake e përbërë prej 90 mijë vetësh iu drejtua Budapestit, njërës nga pikat kryesore të sundimit otoman në Evropë nga ku drejtoheshin inkursionet e ushtrisë otomane drejt Austrisë dhe Gjermanisë. Pushtimi i Budapestit, i një pike aq strategjike, do të thoshte humbja e të gjitha viseve të banuara nga rumunët. Qe kjo arsyeja përse vali i fundit i Budapestit Abdurrahman Abdi pasha luftoi me vetëmohim në mbrojtjen e qytetit derisa edhe ra i vdekur në fushë të betejës. Pasi e pushtuan qytetin Austriakët nuk lanë këmbë myslimani në Budapest. Edhe vetë popullsia rumune nuk mundi të vendosej në qytet për një kohë të gjatë.

SIDA,

SEMUNDJA QE VRET

Ky akronim me katër germa, trondit njerëzimin në katër anët e botës. Katër gerrat përfaqësojnë inicialet në gjuhën frënge të një sëmundjeje të tmerrshme që do të thotë: "Sindromi i imunodeficiencës së fituar".

HIV (Human Immunodeficiency Virus) është shkaktari i kësaj sindrome. HIV- Biri i zinasë, mesa duhet është virusi i denjë për shkatërrimin e atyre që kanë harruar Krijuesin duke mohuar apo praktikuar Kur'anin dhe hadithin dhe që me vrap rendin pas imoralitetit.

Me të vërtetë njerëzimi u paralajmërua për këtë katastrofë si në Kur'an dhe në hadith: "Allahu i lartmadhëruar në Kur'an thotë: "E mos iu afroni imoralitetit, sepse ai është një vepër e turpshme dhe një e keqe që hap rrugën (për shumë të këqija të tjera)" (17-32)

"I fshikulloni me 100 goditje mashkullin dhe femrën që fajësohen për imoralitet; mos kini dhembshuri në të tilla raste për një urdhër që jepet nga Zoti, nëse i besoni Zotit dhe ditës së fundit. Dhe kur të ndëshkoni le të jenë dëshmitarë disa besimtarë." (24-2)

Ndërsa Muahmedi (a.s.) thotë: "Kurdo që të përhapen

marrëdhëniet seksuale jashtë martese, do të shfaqen infeksione dhe sëmundje vdekjeprurëse ndër njerëz si dhe sëmundje të panjohura nga paraardhësit e tyre" Ibn Maxishe, El-Bejhaki

Megjithatë dhe vetë njerëzit shprehin përhapjen dhe vërejtjet e për përhapësit e kësaj fatkeqësie.

Në një proverb thuhet: "Së-



mundja ngjitetë është si farat në tokë, ato nuk rriten në gurë por lulëzojnë në plehra."

Biznesmenia Edëina Currie thoshte në një fjalim rreth siddës në Afrikë: Mesazhi im për biznesmenët e këtij vendi kur ato udhëtojnë jashtë shtetit për punë është se, për të parandaluar infektimin nga sida, ka një gjë mbi gjithë të tjerat

që ato duhet të marrin me vete, dhe kjo është gruaja. E ashtuquajtura SIDA është sëmundja më e frikshme vdekjeprurëse në botë.

Mjeku Ashua Lederberg, Laureat i çmimit Nobel ka thënë: SIDA do të jetë sëmundja e tretë vdekjeprurëse në botë ku deri më 2010 do të vdesin 10 % e popullsisë nga kjo sëmundje. Për disa kombe kjo shifër do jetë 50 %. Vendet me të prekura në botë janë ShBA, Brazili, ndërsa Franca ka përqindjen më të lartë në Evropë.

Nga vjen ky virus?

Mendohet se HIV-i human e ka prejardhjen nga një rezervuar shtazor, ndonëse nuk është përcaktuar momenti kur është bërë ky kalim. Si virus mendohet të jetë gjetur i pranishëm që në 1961.

Në disa pjesë të Afrikës ku infeksioni është më i lartë (deri 35 % e popullatës) transmetimi është kryesisht me rrugë heteroseksuale, ndërsa në vendet e tjera të botës, shumica e rasteve janë shfaqur në meshkuj homoseksualë. Përdorues të drogave intravenozë, fëmijë të lindur nga gra të infektuara, të politransfuzionit etj...

Pra SIDA është, thjeshtë

produkti i të këqijave që lidhen me homoseksualizmin dhe prostitucionin. Më e keqja është që këto fëlliqësira janë pjesë e burimeve "të majmë" stilin modern të jetesës atje"!!!

Ç'është HIV-i

HIV-i është virusi shkaktar i sindromit "SIDA." HIV ndahet në HIV1, dhe HIV2. Bën pjesë në nënfamiljen e Lentiviruesve të Retrociruesve. Lenticirusit janë shkaktarë të infeksioneve virale të ngadalshme, por gjithmonë vdekjepurëse. Virusi shkatërron qelizat që infekton. Si një Retrovirus HIV është në formë pak a shumë rrumbullakët dhe madhësi afro 100 nm, që përmban dy molekula të lidhura me transkriptozë reversë (RT) në një kanë cilindrike apo nukleoid të rrethuar me një cipë mbështjellëse të vendosur në sipërfaqe të virusit në receptorët e tij qelizorë.

Si infekton trupin tonë?

Virusi i HIV-it transmetohet

*Kurdo që të
përhapen
marrëdhëniet
seksuale jashtë
martese, do të
shfaqen infeksione
dhe sëmundje
vdekjepurëse
ndër njerëz si
dhe sëmundje të
panjohura nga
paraardhësit e tyre*



nëpërmjet lëngjeve të trupit si gjaku dhe sperma, por jo nga lotët dhe pështyma. Periudha e latentes, pra koha e nevojshme që duhet për shfaqjen e shenjave klinike që nga momenti i infektimit, mund të zgjasë nga disa muaj deri në shumë vite. Duke shkatërruar qelizat që infektojnë ato i shpëtojnë sistemit imunitar të organizmit tonë. Gp. 120 lidhet me limfocitet TcD4t, të cilat përbëjnë qel. Përgjegjëse për mbrojtjen e trupit tonë nga të gjithë agjentët infektivë si Baktere, Viruse, Protozoare etj...

HIV integrohet me anë të konvertimit të ARN-së së tij në ADN (material qelizor bërthamor) në qelizat bujtëse të trupit tonë. Qeliza e infektuar lejon shumëzimin e këtij virusi duke bërë të mundur infektimin e mëtejshëm të trupit tonë.

Çfarë ndodh më tej?

Shenjat fillestare të sëmundjes janë dobësi, anoreksi, rënie në peshë, subfebrilitet, djersë, por këto simptoma janë të përgjithshme dhe jo specifike. Ndërkaq elementi patologjik më kryesor është një limfoadenopati e gjeneralizuar (gjëndra) e shoqëruar me rënie të rruazave të bardha, (limfopeni T). Rruazat e bardha (leukocitet) janë qeliza përgjegjëse për mbrojtjen e

trupit tonë dhe janë pikërisht këto qelizat shenjë të veprimit të HIV. Duke i shkatërruar këto qeliza, trupi jonë mbetet pa armë. Ai bëhet pre e shumë infeksioneve oportuniste, që për njerëzit e shëndoshë prania e tyre s'do përbente rrezik. Paradoksi i kësaj sindrome është sepse këto pacientë nuk vdesin asnjëherë nga vetë virusi HIV, por nga infektimet e tjera që tashmë i kanë dyert e hapura për organet tona vitale. Më të shpeshta janë infeksionet nga pneumocystis carinii, cytomegalogirus, EBV, Herpes Simplex, Candida, Parazitit, Sarkoma e Kaposit, etj...

Këto mikrobe prekin në masë të gjerë mushkërinë, trurin, mëlçinë, shpretkën etj..., duke bërë një shkatërrim difuzion organizmin tonë.

Si diagnostikohet?

Teknika diagnostike bazohet në zbulimin e antikorpeve anti-HIV në serumit e gjakut të personave të infektuar. Përdoren reaksione enzimatike ELISA në teste të thjeshta. Në rast pozitiviteti bëhen teste plotësuese më specifike.

Si mjekohet?!

Virusi i HIV-it është i pamundur të parandalohet e të frenohet shfaqja e SIDA-s. Kjo sepse HIV-i ndryshon vazhdimisht. Antigenet bërthamore nëpërmjet mutacioneve. Madje ndryshon përbërjen dhe tek i njëjtë individ, është si dhe në individë të ndryshëm. Antiviralet ekzistues janë të pafuqishëm për eliminimin e kësaj mostre që quhet HIV.

Samerra




Qyteti i Samerrës klasifikohet për nga aspekti historik në vargun e qyteteve që megjithëse u krijuan si qendra për dislokimin e trupave ushtarake gjatë fushatave të hershme ushtarake të ndërmarra nga ana e Omajadëve dhe Abbasidëve, shumë shpejt u shndërruan në qytetet e kulturës, artit dhe djep i shkencave të tjera të asaj kohe, duke dalë përjashta kornizave të para për të cilat u krijuan. Në këtë varg mund të përmendim qytetet e tjera siç qenë Kufe, Kajrevani etj. Të krijuara që në kohën e fushatave ushtarake të ndërmarra nga ana e halifeve, tradita e krijimit të qyteteve për arsye ushtarake vazhdoi më pas edhe në dinasti-

në e Omajadëve dhe atë të Abbasidëve. Shumë shpejt qytetet në fjalë u populluan dhe kështu përjetuan një zhvillim urbanistik që solli më vete edhe vendosjen dhe akumulimin e dijetarëve të fushave të ndryshme. Sado që krijimi i këtyre qyteteve është shpjeguar me nevojat e ekspansionit të kalifatit, i cili kërkonte të mbështetej në baza ushtarake të fuqishme dhe të shpejta për të ndërhyrë në rast nevoje, myslimanët me shumë gjasa u mbështetën edhe në të dhënat e kulturës së hershme që i kishin populluar më parë këto treva.

Një nga këto qytete është edhe Samerra. Arkeologët e ndryshëm kanë parashtruar pikëpamje të ndryshme mbi origjinën e toponimisë së qytetit Samerra duke argumentuar për një fjalë me origjinë greke Souma, me origjinë latine Sumere, apo nga gjuha siriane Sumra, e përshkruar si një fshat i vogël. Nga ana e tyre historiografët e hershëm arabë janë munduar të shohin në emrin e

Samerrës, një shprehje të thjeshtë arabe surre men rea, që do të thotë u ngazëllua ai që e pa. Një shpjegim i dyshimtë etimologjik.

Themelimi i qytetit të Samerrës gjatë sundimit abasid, lidhet me problemin e forcës ushtarake që duhej të mbante pranë tij kalifi i asaj kohe, Mutasimi. Ushtarët ishin me origjinë turkmene ose nomadë nga Egjipti dhe përveç kësaj ata kërkonin hapësirë që të ushtroheshin për luftë. Një tjetër arsye qenë edhe mosmarrëveshjet dhe trazirat që shkaktroheshin herë pas here midis popullsisë civile të Bagdatit, asaj kohe kryeqyteti i kalifatit abasid, dhe ushtarëve mercenarë. Për



këtë arsye në vitin 836 kalifi abasid Mutasimi, vendosi që ta shpërngulte oborrin e tij perandorak së bashku me ushtrinë mercenare nga Bagdati drejt Samerrës, një qytet i njohur deri atëherë për gjueti, por i varfër për burimet e tija natyrore.

Me vdekjen e kalifit Mutasim në vitin 842 në mendjet e të gjithëve ngrihej pyetja: a do të braktisej menjëherë Samerra pas vdekjes së themeluesit të saj, ashtu siç kishte ngjarë me shumë koloni të tjera, apo do të shndërrohej në një pikë qëndrimi permanent për kalifatin abasid? Kalifi abasid Vathiki (842-847) preferoi të qëndronte aty në Samerra dhe njerëzit reaguan duke e shndërruar atë që quhej kampi ushtarak i Mutasimit në një qytet të vërtetë. Sipas historiografit arab Jakubit, Vathiki bëri disa rregullime në sistemin ushtarak, por më shumë ai u përqendrua mbi zhvillimin ekonomik të qytetit. Ai ndërtoi një pallat perandorak që u quajt Haruni, i cili qe njëkohësisht edhe selia e kalifit tjetër abasid Mutevekkilit derisa u zaptua në vitin 860 nga repartet e mercenarëve turq.

Sundimi i Mutevekkilit (847-861) u shpreh me një

ndikim të madh mbi pamjen e jashtme të qytetit. Kalifi qe një dashamirës i vërtetë i arkitekturës. Në një listë të projekteve të tija të ndërtimeve, që na kanë ardhur në versione të ndryshme, Xhamia e Madhe dhe 20 pallate përmenden, ndërsa burimet historike të shkruara kanë regjistruar vlerën totale të këtyre shpenzimeve që varion nga 258 në 294 milion dirhemë. Xhamia e re, e cila veçohet në arkitek-



turën islame me minaren e saj në formë spirale më shumë nga forma e saj arkitektonike, u ndërtua ndërmjet viteve 849 dhe 851. Dy pallate të reja së bashku me parqet e tyre të mëdha për gjueti u ndërtuan në lindje të qytetit të ri. Gjatë sundimit të Mutevekkilit qendra e qytetit arriti shtrirjen e saj më të gjerë, shtrirje të cilën e përshkroi historiani arab Jakubi, në veprën e tij Futuhu'l-Buldan.

Xhamia e njohur për minaren e saj karakteristike, u ndërtua mbi bazën e xhamisë që ishte ndërtuar aty më parë në vitin 836, por që me kalimin e kohës qe shndërruar në ngrehinë. Në vitet 849-852 u ndërtua xhamia në një shkallë më të gjerë, e cila për një kohë të gjatë u konsiderua edhe xhamia me sipërfaqe më të madhe në botën islame.

Xhamia vetë ka përmasat 239 me 156 metër dhe posedon një portik të trifishtë për qark oborrit. Pjesët e mureve ndërmjet dritareve janë ndërtuar në formë tetëkëndëshi (oktagonale) me shtylla prej mermeri nëpër qoshe. Mihrabi i xhamisë ka pasqenë zbukuruar me mozaikë prej qelqi, nga i cili vetëm një copëz na ka mbërritur.

Minarja karakteristike e kësaj xhamie, krijimi i vetëm arkitektonik i këtij lloji në botën islame, është 52 metër e lartë, me një bazë katrore dhe shkallë të jashtme në formë spiraleje. Në majë ekzistojnë gjurmët e një ndërtimi në dru, i cili shërbente për të mbrojtur myezinin.

Shqipëria: Pasuritë kulturore



Që Shqipëria është një nga vendet më të pasura dhe të virgjëra për nga studimet dhe kërkimet arkeologjike dhe kulturore këtë e tregoi më së miri zbulimi i kohëve të fundit i realizuar në qytetin e Elbasanit ku teksa zhvilloheshin kërkimet tek vendi i quajtur Rrapi i Bezistanit i një mozaiku që mendohet se është i periudhës romake.

Një tjetër fushë e rëndësishme dhe jo e paeksploruar në mbarë botën janë edhe fundet e deteve, mbi të cilat që nga lashtësia dhe deri në mesin e shekullit të njëzetë kanë lundruar anije të llojeve dhe tonazheve të ndryshme, por që jot ë gjitha kanë patur fatin e mirë që të mbërrijnë për në destinacionet e tyre, duke u kthyer kështu në fatkeqe për fatin e udhëtarëve të tyre në njërën anë, dhe duke fshehur kështu edhe shumë objekte historike, e pse jo shuma të mëdha të arit dhe gjërave me vlerë që mund të kenë pasur.

Të paktët qenë qytetarët shqiptarë, të paktën ata që u interesuan rreth këtij problemi, që besuan se anija amerikane kërkimore "Herkules", e cila si një sipërmarrje e fondacionit amerikan të kërkimeve të nënujit RPM, lëshoi nga bordi i saj robotin elektronik për të fokusuar thellësitë e detit Jon, aty ku fshihen pasuritë arkeologjike dhe reliket e luftërave nga ilirët, deri tek anijet luftarake të Luftës së Dytë Botërore, po e ndërmerre këtë veprimtari në kuadrin e zhvillimit të turizmit ujqor. Jo se nuk e pëlqejnë një gjë të tillë, por për faktin e thjeshtë se në Shqipëri nuk janë bërë ndërmarrje të mëdha për të zhvilluar turizmin "mbi ujqor". Aq më mosbesuese bëhet fotografia e ekipit shqiptaro-amerikan të cilët dilnin të filmonin përpara kamerash duke nxjerrë në pah amforat, që kërkonin të konsideroheshin si "trofetë" e vërteta të ekspeditës së madhe.

Greqia "gjunjëzohet" përpara zjarreve



Kjo verë dhe temperaturat e larta e kanë gjetur të papërgatitur shtetin grek përballë një fatkeqësie të madhe natyrore, e cila mbi të gjitha ka shkaktuar edhe një numër të madh viktimash, rreth 51 persona, fundi i të cilëve qe tepër tragjik, të digjeshin nga flakët masive të zjarreve që pushtuan pyjet e Greqisë. Ndërkohë qeveria greke i cilësoi këto zjarre si të qëllimshme dhe kryeministri grek Karamanlis, nuk hezitoi aspak të pohonte përpara shtypit se këto mund të ishin akte të mirëfillta terroriste të përgatitur nga autorë shqiptarë. Disa nga zjarret më të mëdhenj u ndezën në perëndim të bregdetit të Peloponezit deri në Mani, në jug të gadishullit.

Autoritetet në vend kanë bërë të ditur se bëhet fjalë për më shumë se 170 zjarre që kanë shpërthyer gjatë 48 orëve të fundit dhe duket se e kanë "gjunjëzuar" vendin.

Zjarret kanë avancuar deri në periferitë e kryeqytetit, por në orët e darkës janë vënë pjesërisht nën kontroll. Brigadat e zjarrfikësve po luftojnë për të shuar mbi 170 zjarre në të gjithë vendin, në Greqinë perëndimore, Peloponez, Ilias, Mesinia, ishujt Evia si dhe

Atikë", - tha zëdhënësi i departamentit të zjarrfikësve Ioannis Stamoulis

Abdullah Gyl: ***Rruga e gjatë drejt pallatit presidencial***



Do të kujtohet si një nga çështjet më komplekse dhe më delikate të historisë moderne turke. Dje, Parlamenti u mbledh edhe një herë tjetër në përpjekje për të zgjedhur Presidentin e 11-të të Turqisë, pas krizës së prillit. Dhe më në fund, gjithçka u zgjidh. Ja një përmbledhje e etapave që kanë çuar deri te votimi.

- 24 prill: Konsultimet zgjasin për muaj të tërë dhe Erdogan prezanton si kandidat për president bashkëpunëtorin e tij më të ngushtë me të cilin ka themeluar partinë, personin që kryente me aq kujdes detyrën e ministrit të jashtëm Abdullah Gyl. Opozita lajmëron se nuk do të jetë prezente në sallën e Parlamentit gjatë votimit, në mënyrë që të mos arrihet kuorumi i kërkuar.

- 27 prill: Gyl hidhet poshtë në raundin e parë. Në seancë, marrin pjesë vetëm 361 deputetë. Merr 357 vota pro, tre kundër dhe një abstenim. Po atë ditë, opozita bën apel në Gjykatën Kushtetuese për të anuluar votimin.

- 1 maj: Vjen vendimi i Gjykatës Kushtetuese: pas katër orësh konsulta pranohet padia e opozitës. Partia Drejtësi dhe Zhvillim ka thyer nenin 102 të Kushtetutës, sipas të cilit, në dy raundet e para të votimit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, nevojiten në sallë 367 deputetë, pra një mazhorancë prej dy të tretash. Erdogan shfaqet në televizion dhe tregohet i gatshëm për zgjedhje të parakohshme.

- 22 korrik: Me një përqindje plebishitare, Drejtësi dhe Zhvillim fiton zgjedhjet. Hyn në Parlament edhe partia nacionaliste e Devlet Bahçelit. Opozita laike, pavarësisht marshimeve popullore në mbrojtje të laicizmit, arrin një 20 për qindësh të varfër.

- 25 korrik: Në një konferencë për shtyp të lajmëruar 24 orë më herët, ministri i Jashtëm, Abdullah Gyl, vendos hipotekën mbi Presidencën e Republikës. «Duke parë mendimin e popullit dhe rezultatet zgjedhore, nuk mund të them që nuk do të kandidoj më».

- 10 gusht: fillon zyrtarisht procesi për zgjedhjen e Presidentit të ri. 10 ditë konsultime dhe 20 për të votuar.

- 13 gusht: me një deklaratë për shtyp, Gyl rikandidon për President të Republikës. Të gjithë vënë re heshtjen e Recep Tayyip Erdogan që dy ditë më pas mban një tjetër konferencë për shtyp dhe mbron zgjedhjen e tij.

- 20 gusht: raundi i parë i votimit në Parlament. Gyl merr 341 vota. Në sallë arrihet kuorumi për shkak të pranisë së nacionalistëve.

100 milionë yje dhe 200 milionë galaksi mund të vrojtohen me anë të Google Sky


Google ka publikuar lajmin se shërbimi i ri që ai do të ofrojë me anë të programit që do të luaj rolin e një “teleskopi imagjinar”, do të jetë si një fushë lojërash drejtuar informacionit që duan të marrin njerëzit rreth gjithësisë.



Pas programit të titulluar Earth, i cili mundëson vrojtimin e botës duke krijuar mundësinë që të shkohet deri te rrugicat e banesave tona, këtë herë, gjiganti i internetit, Google, dëshiron që të na kthejë vëmendjen drejt yjeve nëpërmjet programit të ri që e ka emërtuar Sky.

Kështu përdoruesit e internetit do të mund të shohin me anë të programit Sky rreth 100 milionë yje dhe 200 milionë galaksi, duke konkretizuar kështu interesin që kanë rreth njohurive teorike të astronomisë.

Sipas vetë përfaqësuesve të Googlit më shumë se 250 milionë shkarkime janë kryer nga muaji qershor i vitit 2005 për programin Earth, versionin e fundit të të cilit duhet ta zotërojnë të gjithë ata që dëshirojnë të kenë shërbimin Sky, i cili do të jetë në 13 gjuhë të ndryshme.



Konkurrenca në rrjetin e internetit

Teknologjia e re netëork që parashikohet t'i zër vendin internetit thuhet se do të hidhet në treg në vitin 2020.

Ministri Japonëz i Komunikacionit, Yoshihide Suga, bëri të ditur përpara publikut se në një kohë sa më të shpejtë në Japoni do të nisin punimet për një teknologji të re të hulumtimit dhe zhvillimit të netëork-ëve të brezit të ri që do të zëvendësojnë internetin, hedhja në treg e të cilëve është parashikuar për në vitin 2020.

Ministri japonez Suga, i cili bëri të ditur se më e shumta deri në këtë vjeshtë, do të thirret një komision i nivelit të lartë për të diskutuar rreth teknologjisë së re të netëork-ut, komision në të cilin do të marrin pjesë akademikë, ambientalistë dhe përfaqësues së qeverisë.

Mësohet se Ministria e Brendshme dhe ajo e Komunikacionit ka kërkuar që në lidhje me këtë projekt t'u caktohet në buxhetin e vitit 2008 një fond prej rreth 70 milionë dollarësh.

Burimet të cilat pretendojnë se me këtë teknologji të re do të ulet shkalla e sulmeve me virus në internet dhe do të minimizohen problemet e defekteve dhe ngrirjeve në program, gjithashtu pohojnë se teknologjia e re do të jetë më e shpejtë dhe më e sigurtë sesa ajo e internetit të tanishëm.

Nga ana e saj Ministria Japoneze e Komunikacionit pohon se me këtë risi teknologjike synojnë ta shndërrojnë Japoninë në liderin botëror të zhvillimit të teknologjive post-internet duke bërë kështu që të përcaktojnë edhe standardet globale të teknologjisë në fjalë.

Vrima e madhe në gjithësi



Astronomët bëjnë të ditur se kanë zbuluar një zbrazësi të madhe në gjithësi në të cilën nuk gjendet asnjë galaksi apo yll.

Një ekip studiuesish të universitetit Minnesota, kanë nënvizuar faktin se ata nuk kanë asnjë ide se përse gjendet zbrazësia në fjalë në një pikë të llogaritur në një largësi prej 1 miliard vit-drite larg nga toka.

Prof. Laërence Rudnik, një nga pjesëtarët e grupit të astronomëve që bënë zbulimin, është shprehur kështu në artikullin e tij që shkroi

për revistën shkencore "Astrophysical Journal": "Fakti që askush deri tani nuk ka zbuluar një zbrazësi kaq të madhe, na ka çuditur pa masë kur ne u gjetëm përballë këtij zbulim".

Studiuesit Shea Brown dhe Liliya Williams, bënë të ditur se zbrazësinë gjigante e kanë zbuluar teksa po kryenin hulumtimet me anë të antenës Wilkinson për Hulumtim Anisotropi të Mikrovalëve mbi një pikë të ftohtë të gjithësisë.

Williams është shprehur se "Ajo që zbuluam nuk është normale as sipas vërtetimeve të kryera deri më tani dhe as sipas simulacioneve me përmasa të mëdha të kryera me kompjuter rreth evoluimit të gjithësisë."

Astronomët që kanë kryer hulumtimin tërheqin vëmendjen për faktin se asnjë shenjë prej lëndës së zezë që nuk shihet, por që përcaktohet me anë të matjeve të forcave gravitacionale, nuk është gjetur në zbrazësinë gjigante, e përcaktuar në zonën ku gjenden yjet Eridanus, që janë të lokalizuara në jugperëndim të yjeve Orion.